



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 22

Tiranë – E mërkurë, 28 janar 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 21.1.2026	Për miratimin e marrëveshjes ekzekutive, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për realizimin e nismës “Forcimi i kapaciteteve të mbrojtjes civile në Shqipëri”..... 1951
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 44, datë 21.1.2026	Për miratimin e planit të veprimit <i>Schengen</i> 2026–2030..... 1968
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 61, datë 19.1.2026	Për delegim kompetence..... 2008
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 62, datë 19.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës..... 2008
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 63, datë 20.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë..... 2009
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 64, datë 20.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 2011
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 68, datë 21.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës..... 2013
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 69, datë 21.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Letonisë..... 2014

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 67, datë 5.11.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 867-128, datë 5.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; nr. 218, datë 14.5.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-1782, datë 5.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	2017
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 82, datë 18.12.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4040, datë 22.10.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.....	2029



VENDIM

Nr. 25, datë 21.1.2026

VENDOSI:

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
EKZEKUTIVE, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS ITALIANE, PËR
REALIZIMIN E NISMËS “FORCIMI I
KAPACITETEVE TË MBROJTJES
CIVILE NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

Miratimin e marrëveshjes ekzekutive, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për realizimin e nismës “Forcimi i kapaciteteve të mbrojtjes civile në Shqipëri”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

MARRËVESHJE EKZEKUTIVE

MIDIS

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE

**PËR REALIZIMIN E NISMËS
“FORCIMI I KAPACITETEVE TË MBROJTJES CIVILE NË
SHQIPËRI”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes, në vijim “Shqipëria” dhe Qeveria e Republikës Italiane, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim (MAECI - DGCS), në vijim “Italia”, referuar bashkërisht si “Palët”, dhe individualisht si “Pala”.

NË BAZË TË Marrëveshjes Kuadër për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, nënshkruar në Tiranë më 2 dhjetor 2008;

DUKE MARRË PARASYSH se nisma bën pjesë në prioritetet e Shqipërisë dhe duke marrë parasysh letrën e kërkesës së Ministrit Shqiptar të Mbrojtjes dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të Shqipërisë, datë 20 dhjetor 2023;

DUKE MARRË PARASYSH se në datën 9 prill 2024 Komiteti i Përbashkët për Bashkëpunimin Zhvillimor të Republikës Italiane miratoi me Rezolutën nr. 30 nismën e bashkëpunimit e quajtur “Forcimi i kapaciteteve të Mbrojtjes Civile në Shqipëri”, për një shumë totale donacioni prej 5,000,000.00 (pesë milionë) Euro;

Bien dakord si më poshtë vijon:

**Neni 1
PËRKUFIZIME**

Në këtë Marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm me kuptimet e tyre përkatëse krah secilit:

Projekti	Nisma “Përforcimi i kapaciteteve të Mbrojtjes Civile në Shqipëri”;
MAECI - DGCS	Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit



AICS
MF
MD
ANPC
PIU
SISTAFE

Ndërkombëtar e Republikës Italiane - Drejtoria e
Përgjithshme për Bashkëpunim Zhvillimor;
Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor;
Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë;
Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë;
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile Shqiptare;
Njësia e Zbatimit të Projektit;
Sistemi Shqiptar i Administrimit Financiar
Shtetëror.

Neni 2

STRUKTURA E MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje përbëhet nga 19 Nene dhe dy Shtojca:
 - Shtojca 1 - Dokumenti i Projektit.
 - Shtojca 2 - Klauzola etike dhe parime themelore për lidhjen dhe zbatimin e kontratave.
2. Shtojcat e sipërpërmendura konsiderohen si pjesë përbërëse e Marrëveshjes. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, kjo Marrëveshje do të mbizotërojë mbi Shtojcat.

Neni 3

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

1. Projekti synon të kontribuojë në funksionimin e plotë të sistemit të mbrojtjes civile në Shqipëri nëpërmjet përforcimit të aftësive teknike dhe operacionale të sistemit shqiptar të mbrojtjes civile, me qëllim parandalimin dhe trajtimin në mënyrë më efektive të llojeve të ndryshme të emergjencave në territorin shqiptar.
2. Objektivat që duhen ndjekur, rezultatet që pritet të arrihen, si dhe aktivitetet që do të kryhen dhe kostot përkatëse që do të përballohen janë të detajuara në Shtojcën 1.

Neni 4

KONTRIBUTI FINANCIAR I ITALISË

Kontributi i përgjithshëm financiar për realizimin e projektit do të jetë i barabartë me 5,000,000.00 (pesë milionë) euro, financuar nga Italia sipas mënyrave të mëposhtme:

- a) 4,850,000.00 (katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) euro do të paguhet në një llogari euro dedikuar projektit, e cila do të hapet në Thesarin e Shtetit të MF-së, siç rregullohet nga kjo Marrëveshje;
- b) 150,000.00 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro do të menaxhohen drejtpërdrejt nga AICS me seli në Tiranë dhe do të përdoren për veprime të pavarura të auditimit financiar.



Neni 5

METODAT E LËVRIMIT DHE PËRDORIMIT TË FINANCIMIT ITALIAN

1. Financimi italian i referuar në Nenin 4 gërma a), do të depozitohet në një llogari në Euro, dedikuar Projektit, e hapur në Thesarin e Shtetit të MF-së.
2. Llogaria e dedikuar për Projektin do të përdoret vetëm për financimin e aktiviteteve të parashikuara në Shtojcën 1. Procedurat e kontabilitetit duhet të ndjekin Ligjin e SISTAFE shqiptar.
3. Blerja e mallrave dhe shërbimeve dhe për zbatimin e projektit do të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në zbatim të Rregullores së Bashkimit Evropian për Procedurat e Dhënies së Kontratës – (PRAG) – dhe Shtojcës 2 (“Klauzolat etike dhe parimet themelore për përcaktimin dhe ekzekutimin e kontratave”), pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Në rast të ndonjë konflikti ndërmjet dispozitave të Shtojcës 2 dhe rregullave të PRAG, do të mbizotërojnë Shtojca 2.
4. Për dhënien e kontratave për blerjen e shërbimeve me vlerë më të madhe se 100,000.00 (njëqind mijë) euro dhe për blerjen e shërbimeve dhe kryerjen e punëve civile, në shumën mbi 300,000.00 (treqind mijë) euro, dokumentacioni i tenderit mund të publikohet pas lëshimit të Autorizimit nga AICS. Pasi të përfundojë procedura e vlerësimit, kontratat përkatëse mund të nënshkruhen me autorizimin nga AICS. Nëse kontratat individuale të përcaktuara brenda Projektit kanë një shumë më të ulët se kufijtë maksimalë të treguar, nuk do të jetë e nevojshme të lëshohet Autorizimi i sipërpërmendur. Të gjitha kontratat për blerjen e mallrave, shërbimeve, realizimit të punimeve dhe veprave, si dhe procedurat përkatëse të përzgjedhjes do t'i nënshtrohen auditimit të përmendur në këtë Marrëveshje.
5. Lëvrimi i kontributit financiar italian për Shqipërinë, i përmendur në Nenin 4, do të bëhet në mënyrat e mëposhtme:
 - a) Një kësht i parë i barabartë me 1,879,000.00 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) euro do të lëvrohet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe miratimit të Planit të parë Operativ të Projektit nga Komiteti Drejtues (KD), sipas Nenit 11.
 - b) Një kësht i dytë i barabartë me 1,763,750.00 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, do të lëvrohet pas miratimit nga Komiteti Drejtues (KD) i Planit Operativ të Projektit për periudhën e referencës dhe të raportit mbi ecurinë tekniko-financiare të projektit, (të vërtetuar nga shoqëria audituese e përmendur në Nenin 6 vijues) dhe pas shpenzimit të paktën 70% të shumës së kështit të parë të lëvruar;
 - c) Një kësht i tretë i barabartë me 1,207,250.00 (një milion e dyqind e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro do të lëvrohet pas raportit mbi ecurinë tekniko-financiare të Projektit (të vërtetuar nga shoqëria audituese e përmendur në Nenin 6 vijues) dhe pas shpenzimit të paktën 70% të shumës së kështit të dytë të lëvruar.

**Neni 6****RAPORTET PËR ECURINË TEKNIKO-FINANCIARE**

1. Selia e AICS në Tiranë do të përzgjedhë kompaninë e auditimit midis atyre me përvojën më të madhe në aktivitete të ngjashme dhe që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, të miratuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) dhe Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Eprorë të Auditimit (INTOSAI).
2. Termat e referencës së detyrës do të përcaktohen së bashku nga Palët dhe do të vendosen duke marrë parasysh atë që përcaktohet në Shtojcën 1 dhe duhet të parashikojnë kontrollin e përgjithshëm të aktiviteteve të prokurimit. Përzgjedhja do të bëhet në zbatim të rregulloreve të përcaktuara në paragrafin e mëparshëm. Rezultatet e përzgjedhjes do t'i transmetohen AICS për marrjen e Autorizimit paraprak për shpalljen e fituesit. ANPC-ja do të jetë përgjegjëse për të siguruar arkivimin e duhur dhe të plotë të të gjithë dokumentacionit në lidhje me proceset individuale të prokurimit dhe vënien e tyre në dispozicion për aktivitetet e auditimit.
3. Shumat e pa raportuara duhet të kthehen në Itali.

Neni 7**PËRDORIMI I FONDEVE**

1. Fondet, objekt i financimit, do të përdoren ekskluzivisht për:
 - a) pagesën e shërbimeve, furnizime, punime dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për realizimin e Projektit dhe në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara në Shtojcën 1;
 - b) pagesën për aktivitetet që kanë të bëjnë me auditimin.
2. Fondet e Projektit nuk mund të përdoren për pagimin e tatimeve, taksave, detyrimeve doganore dhe tarifave të tjera.
3. Në rast interesash të përlllogaritur, ata duhet të raportohen dhe mund të përdoren për të financuar aktivitete të mëtejshme brenda Projektit, me pëlqimin paraprak të Palëve.

Neni 8**DETYRIMET E PALËS SHQIPTARE**

1. Shqipëria do t'i komunikojë Italisë, nëpërmjet ANPC-së, të dhënat bankare të llogarisë rrjedhëse të dedikuara të hapur nga ANPC.
2. Shqipëria, nëpërmjet ANPC-së, do t'i paraqesë në AICS raportet e përmendura në Nenin 11.3.
3. Shqipëria është garantuese për zbatimin e Projektit, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe do të jetë përgjegjëse për të kërkuar përjashtimin nga pagesa e taksave dhe tarifave të tjera doganore.



4. Shqipëria do të duhet të sigurojë që fondet të regjistrohen rregullisht në Buxhetin e Shtetit për vitin e referencës.
5. Shqipëria do të sigurojë që fondet të përdoren për qëllime dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe Shtojcave të saj, që ato të mos përdoren, qoftë edhe në mënyrë indirekte, për veprimtari ushtarake dhe që mallrat dhe veprat e realizuara ose të fituara të mos përdoren për qëllime ushtarake, as pas përfundimit të programit. Kjo dispozitë do të mbetet në fuqi edhe pas përfundimit, për çfarëdo arsye, të kësaj Marrëveshjeje.
6. Shqipëria do të lejojë Italinë të kryejë aktivitete të mbikëqyrjes, kontrollit dhe verifikimit të zbatimit të Projektit, duke lejuar, ndër të tjera, aksesin në zonat e Projektit dhe në dokumentacionin teknik dhe financiar përkatës.
7. Shqipëria do t'i kthejë Italisë fondet e disbursuara sipas kësaj Marrëveshjeje, të cilat janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në Marrëveshjen dhe Shtojcat e saj, si dhe fondet e disbursuara por të pashfrytëzuara në fund të zbatimit të Projektit ose në rastet e përfundimit të parakohshëm të Marrëveshjes.

Neni 9

DETYRIMET E PALËS ITALIANE

Italia merr përsipër të lëvrojë shumën totale të financimit dhuratë të barabartë me 4,850,000.00 (katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) euro sipas mënyrave të përcaktuara në Nenin 5.

Neni 10

LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin italian dhe shqiptar, si dhe me të drejtën ndërkombëtare në fuqi dhe, për sa i përket Palës Italiane, me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian.

Neni 11

MËNYRA E MENAXHIMIT DHE E ZBATIMIT

1. Projekti do të zhvillohet në përputhje me Shtojcën 1 dhe Planet Operative gjashtëmujore të Projektit të miratuara nga Komiteti Drejtues (KD).
2. Komiteti Drejtues (KD) do të përbëhet nga:
 - një përfaqësues i selisë AICS në Tiranë;
 - një përfaqësues i Ambasadës Italiane në Tiranë;
 - një përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (ANPC);
 - një përfaqësues i Njësisë së Zbatimit të Projektit (PIU).



Në seancat e KD-së mund të ftohen edhe përfaqësues të subjekteve të tjera të përfshira. Palët do të takohen, të paktën dy herë në vit, për të verifikuar ecurinë e aktiviteteve të planifikuara - siç përcaktohet nga Planet Operative të Projektit – dhe për të bërë, nëse është e nevojshme, ndryshime në to, si dhe për çdo gjë tjetër që është e nevojshme për funksionimin me korrektësi të Projektit.

3. Menaxhimi i Projektit do të sigurohet nga Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU) e përbërë nga anëtarë teknikë të përzgjedhur në përputhje me dispozitat e Rregullores së Bashkimit Evropian për Procedurat e Dhënies së Kontratës – (PRAG) –. Ajo do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e Planeve Operative të Projektit, të Raporteve Teknike-Financiare gjashtëmujore, Raporteve mbi ecurinë tekniko-financiare të kërkuar për lëvrimin e kështit të dytë dhe të tretë dhe për Raportin Përfundimtar të Mbylljes së projektit, - përfshirë zhvillimin e Termave të Referencës për kontraktimin e shërbimeve, punëve dhe mallrave - dhe për zbatimin e vendimeve të marra nga KD.
4. Rishpërndarjet dhe rregullimet ndërmjet zërave individualë, brenda kapitujve të shpenzimeve, mund të kryhen gjatë përgatitjes së Planeve Operative të Projektit dhe të miratuara nga KD.
5. Ndryshimet, rritjet ose zvogëlimet ndërmjet kapitujve të shpenzimeve (përbërësit e Projektit), që tejkalojnë 20% për kapitull, mund të bëhen në Projekt pas përgatitjes, nga ANPC, të një propozimi të arsyetuar dhe marrjes të Autorizimit teknik përkatës nga AICS.
6. Për çdo gjë që nuk parashikohet shprehimisht, do t'i bëhet referim tekstit të Shtojcës 1.

Neni 12

SHKAQE PENGUESE DHE FORCA MADHORE

1. Në rast të konfliktit të armatosur, fatkeqësive natyrore, grevave ose cenimeve të rendit publik që e bëjnë të pamundur zbatimin e Projektit dhe/ose që përbëjnë shkaqe rreziku për sigurinë dhe paprekshmërinë e personelit të huaj dhe vendas të përfshirë në zbatimin e tij, do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:
 - a) Në rast se kohëzgjatja e pengesës për realizimin e projektit është më pak se (6) gjashtë muaj, lëvrimi i fondeve për kryerjen e aktiviteteve të planifikuara do të pezullohet dhe fondet e mbetura do të ngrijnë deri në përfundimin e shkaqeve penguese dhe kur AICS të ketë autorizuar rifillimin e aktiviteteve të Projektit;
 - b) Në rast se kohëzgjatja e pengesës për realizimin e projektit është më e madhe se (6) gjashtë muaj dhe më pak se (12) dymbëdhjetë muaj, projekti do të pezullohet dhe fondet e mbetura - me përjashtim të atyre që lidhen me aktivitetet e përmendura në paragrafin 2 vijues - do të mbahen deri në zhdukjen e shkaqeve penguese. Pasi të jenë zhdukur shkaqet penguese për kryerjen normale të aktiviteteve të Projektit, ANPC do t'i paraqesë AICS një plan të ri aktiviteti, i cili do të miratohet nga KD dhe sipas të cilit do të rifillojë zbatimi i Projektit;
 - c) Nëse shkaqet penguese vazhdojnë për një periudhë më të madhe se dymbëdhjetë (12) muaj, secila Palë mund ta anulojë këtë Marrëveshje nëpërmjet kanaleve diplomatike duke e njoftuar Palën tjetër tre (3) muaj përpara.



2. Veprimtaritë që kryhen në vende që nuk preken nga shkaqet penguese të përmendura në pikën e mëparshme të këtij neni, do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre.

Neni 13

PARANDALIMI I PËRDORIMIT TË PALIGJSHËM TË FONDEVE

1. Palët angazhohen në mënyrë të vendosur për të parandaluar dhe identifikuar praktikën mashtruese dhe korruptive. Palët garantojnë që përdorimi i Kontributit Italian është në përputhje me standardet më të larta të sjelljes etike dhe se çdo organ dhe institucion i përfshirë në zbatimin e projektit respekton standardet më të larta të etikës dhe integritetit.
2. Palët, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare përkatëse, do të garantojnë që çdo pretendim për mashtrim dhe korrupsion në lidhje me zbatimin e Projektit t'u raportohet menjëherë autoriteteve kombëtare përkatëse. Pretendimet e besueshme do të hetohen nga autoritetet kompetente të Palëve në përputhje me ligjet, rregulloret, rregullat, politikat, procedurat dhe praktikën e mira të tyre përkatëse kombëtare. Palët do të informojnë njëra-tjetrën, në kohën e duhur dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare përkatëse, për rezultatin e pretendimeve të vërtetuara për mashtrim dhe korrupsion dhe detajet e veprimeve të ndërmarra.
3. Pas përfundimit të çdo hetimi që identifikon mashtrimin ose korrupsionin në lidhje me çdo aktivitet të financuar tërësisht ose pjesërisht me Kontributin Italian të parashikuar në këtë Marrëveshje, është rënë dakord që:
 - (a) Palët do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të rikuperuar çdo pjesë të Kontributit që Autoriteti Kombëtar përkatës përcakton se është devijuar nëpërmjet mashtrimit ose korrupsionit;
 - (b) Në lidhje me pikën (a) më sipër, Palët do t'i referojnë çështjen Autoriteteve kompetente të shtetit ku besohet se ka ndodhur mashtrimi ose korrupsioni; dhe
 - (c) me kërkesë të Italisë dhe pas konsultimeve ndërmjet Palëve, Shqipëria do të rimbursojë Palën Italiane për çdo pjesë të Kontributit të mësipërm, ose do ta kreditojë atë në një aktivitet të rënë dakord ndërmjet Palëve.

Neni 14

PEZULLIMI I LËVRIMIT TË KREDISË NGA ITALIA

1. Italia rezervon të drejtën të pezullojë lëvrimin e financimit në rastet e mëposhtme:
 - a) Në rast se Pala Shqiptare kryen mospërbushje të rëndë;
 - b) Nëse verifikohen fakte që e bëjnë të pamundur realizimin e projektit të parashikuar në nenin 12.
2. Përbëjnë shkelje të rëndë:
 - a) mosfillimi i aktivitetëve brenda gjashtë (6) muajve nga lëvrimi i financimit të përmendur në Nenin 4;
 - b) vonesa të zgjatura dhe të pajustificuara në përdorimin e financimit italian, që



- mund të rrezikojë kryerjen e aktiviteteve të planifikuara;
- c) përdorimi i financimit italian për aktivitete të ndryshme nga ato të përcaktuara nga Projekti;
- d) parregullsi të rënda në menaxhimin e financimit italian, të vërtetuara nga auditimi i përmendur në Nenin 6 si më sipër.
3. Italia do të njoftojë Shqipërinë me një Notë Verbale për pezullimin e financimit. Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi, kjo e fundit nuk e ka hequr pengesën për vazhdimin e Projektit, Palët do të konsultohen për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme. Në mungesë të një zgjidhjeje, Pala Italiane mund të anulojë këtë Marrëveshje.

Neni 15 **ANULIMI I MARRËVESHJES**

Të dyja palët munden, në çdo kohë, të anulojnë këtë Marrëveshje, me një njoftim paraprak prej tre (3) muajsh. Synimi për të anuluar Marrëveshjen do t'i njoftohet palës tjetër me anë të një Note Verbale, duke treguar arsyet që justifikojnë faktin se nuk mund të vazhdohet me zbatimin e Projektit. Në rast të përfundimit të parakohshëm të Marrëveshjes, në lidhje me kthimin e fondeve të papërdorura Palës Italiane do të zbatohet Neni 8.7.

Neni 16 **AMENDAMENTET**

Të dyja palët mund të bëjnë në çdo kohë ndryshime në këtë Marrëveshje dhe Shtojcat e saj duke shkëmbyer Nota Verbale, të cilat do të hyjnë në fuqi në datën e marrjes së Notës Verbale si përgjigje.

Neni 17 **MOSMARRËVESHJET**

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve që lind nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, duhet të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve dhe/ose negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve.

Neni 18 **NJOFTIMET**

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, janë specifikuar adresat e mëposhtme:

- për Ministrinë e Mbrojtjes: informimi_mm@mod.gov.al, anisa.hoxha@mbrojtja.gov.al;
- për ANPC – Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile: info@akmc.gov.al, klajdi.nikolla@akmc.gov.al, Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”;
- për MAECI-DGCS - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit



ANEKSI 2

KLAUZOLAT ETIKE DHE PARIMET THEMELORE PËR LIDHJEN DHE EKZEKUTIMIN E KONTRATAVE

Ky aneks përcakton klauzolat etike dhe parimet themelore të cilave u përmbahet lidhja dhe ekzekutimi i kontratave të furnizimit, shërbimit dhe punimeve të parashikuara nga Marrëveshja. Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë aneks, zbatohet legjislacioni referues i përcaktuar nga Marrëveshja.

1. KËRKESAT E KONTRAKTORIT

1.1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në Marrëveshje, procedurat për zgjedhjen e kontraktorit janë të hapura për operatorët ekonomikë nga Bashkimi Evropian, për ata të përmendur në nenin 25 të Direktivës 2014/24/BE dhe për ata që zotërojnë kërkesat dhe autorizimet e kërkuara nga legjislacioni vendas.

1.2. Autoriteti kontraktor mund të vendosë një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme të pjesëmarrjes për operatorët ekonomikë, me kusht që ato të jenë të lidhura dhe në proporcion me objektin e kontratës:

1.2.1. *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*: autoriteti kontraktor mund të vendosë kërkesa për të siguruar që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për të realizuar kontratën. Për këtë qëllim, autoriteti kontraktor mund të kërkojë veçanërisht që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro të caktuar minimale vjetore, duke përfshirë një xhiro minimale të caktuar në sektorin e veprimtarisë që mbulon kontrata. Qarkullimi minimal vjetor që operatorët ekonomikë duhet të kenë nuk e kalon dyfishin e vlerës së parashikuar të tenderit, me përjashtim të rrethanave të justifikuara siç duhet në lidhje me rreziqe specifike që lidhen me natyrën e punimeve, shërbimeve ose furnizimeve. Për kontratat e ndara në lote, ky paragraf zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti kontraktor mund të përcaktojë xhiron minimale vjetore që duhet të kenë operatorët ekonomikë në lidhje me grupet e loteve në rast se fituesit i jepen më shumë lote për t'u kryer njëkohësisht.

1.2.2. *Kapaciteti teknik dhe profesional*: autoriteti kontraktor mund të vendosë kërkesa për të siguruar që operatorët ekonomikë të zotërojnë burimet njerëzore dhe teknike dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me një standard të përshtatshëm cilësie. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë, në veçanti, që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm eksperience të provuar nga referenca të përshtatshme në lidhje me kontrata të ekzekutuara më parë, duke përfshirë këtu edhe privatët. Në procedurat e tenderit për furnizime që kërkojnë punë, shërbime ose punime për vendosje ose instalim, aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të kryer këto shërbime mund të vlerësohet duke iu referuar kompetencës, efikasitetit, përvojës dhe besueshmërisë së tyre.



1.2.3. *Kualifikimi për të kryer veprimtari profesionale*: autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të jenë regjistruar në një regjistër profesional ose tregtar, të mbajtur në shtetin në të cilin ata janë të stabilizuar ose të inkorporuar.

1.3. Dokumentet e tenderit tregojnë kushtet e kërkuara të pjesëmarrjes, të cilat mund të shprehen si nivele minimale të kapacitetit, dhe mjetet e duhura provuese.

1.4. Nëse një operator ekonomik mbështetet në aftësitë e subjekteve të tjera përsa u përket kritereve që lidhen me kapacitetin ekonomik dhe financiar, autoriteti kontraktor kërkon që operatori ekonomik dhe subjektet e mësipërme të jenë bashkërisht përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

1.5. Në rastin e tenderave për punime, për shërbime dhe operacionetë vendosjes, ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti kontraktor tregon në dokumentet e tenderit detyrat thelbësore që duhet të kryhen drejtpërdrejt nga vetë ofertuesi ose, në rastin e një oferte të paraqitur nga një grupim operatorësh ekonomikë, nga një pjesëtar i grupimit.

1.6. Janë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e tenderit dhe nuk mund të fitojnë, ose të lidhin kontratat përkatëse konkurrentët të cilët:

1.6.1. janë dënuar me vendim të formës së prerë për një nga arsyet e mëposhtme, siç përcaktohet në nenin 57 paragrafi 1 të Direktivës 2014/24/BE: pjesëmarrje në një organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, vepra terroriste ose vepra që lidhen me aktivitete terroriste, pastrim parash, të cilat vijnë nga veprimtaria kriminale, ose financimi i terrorizmit, shfrytëzimi i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikut njerëzor;

1.6.2. janë dënuar me një dënim të formës së prerë për çdo krim tjetër që rezulton, si një dënim plotësues, në pamundësinë për të lidhur kontratë me administratën publike të njëjës prej Palëve në këtë Marrëveshje ose të Shtetit në të cilin ato janë vendosur, ose inkorporuar;

1.6.3. kanë kryer shkelje të rënda të vërtetuara përfundimisht të detyrimeve në lidhje me pagesën e tatimeve, ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, nëse kjo është vëndosur me një vendim gjyqësor, ose administrativ me efekt përfundimtar dhe detyrues në njërën nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në shtetin në të cilin ato janë vendosur, ose inkorporuar;

1.6.4. kanë kryer shkelje serioze dhe të vërtetuara përfundimisht të detyrimeve në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë, ligjin mjedisor, social dhe të punës në njërën nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në shtetin në të cilin janë vendosur, ose inkorporuar;

1.6.5. janë në një nga situatat e mëposhtme ose janë objekt procedimi për verifikim falimentimi, likuidim administrativ të detyrueshëm, likuidim të përkohshëm, pranim në vendosjen e masave të përkohshme të falimentit me vazhdimësi biznesi, ose ndodhen në një situatë të ngjashme;

1.6.6. janë gjetur fajtorë për shkelje të rënda profesionale, të cilat autoriteti kontraktues është në gjendje t'i vërtetojë me mjetet e duhura, të tilla që të vënë në dyshim integritetin ose profesionalizmin e tyre;

1.6.7. janë, ata ose subjektet që i përkasin të njëjtit grup ligjor, anëtarë të konsorciumeve, shoqatave të përkohshme dhe nënkontraktorëve, në konflikt interesi lidhur me pjesëmarrjen e tyre në procedurën e tenderit, për shkak se kanë



dhënë këshilla për autoritetin kontraktor, subjektin kontraktor, ose ndryshe kanë marrë pjesë në përgatitjen e procedurës së dhënies së tenderit;

1.6.8. kanë bërë deklaratat të rreme pranë autoriteteve të një prej Shteteve Palë në këtë Marrëveshje në procedurën në vazhdim dhe në dhënien e nënkontraktimeve në dhënien e informacionit të kërkuar për të verifikuar mungesën e arsyeve për përjashtimin ose përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, kanë fshehur një informacion të tillë, ose janë regjistruar në regjistrin e mbajtur nga Observatori i Autoritetit Qendror Antikorrupsion i Republikës Italiane për deklarata të rreme, ose dokumenta të falsifikuara me qëllim lëshimin e certifikatës së kualifikimit.

1.6.9. janë prekur nga një shkak mosushtimi i një të drejte, pezullimi ose ndalimi i parashikuar nga legjislacioni i dy Palëve Kontraktuese në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit;

1.6.10. i janë nënshtruar, për kundërvajtje administrative që rrjedhin nga krime të konstatuara me efekt përfundimtar dhe detyrues në njërin nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në shtetin ku janë vendosur, ose inkorporuar, një sanksioni që përfshin ndalimin e kontraktimit me administratën publike,

1.6.11. kanë shkelur ndalimet e kontratës së mirëbesimit të parashikuara nga legjislacioni i njëres prej dy Palëve Kontraktuese në lidhje me kontrollin e regjistrimeve ndaj palëve të treta në shoqëritë e besimit;

1.6.12. nuk janë në përputhje me rregullat që rregullojnë të drejtën për punë të personave me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit të vendit të cilit autoriteti kontraktor i përket;

1.6.13. janë në lidhje me një pjesëmarrës tjetër në të njëjtën procedurë dhënieje kontrate, në një situatë kontrolli ose në çdo marrëdhënie, edhe faktike, nëse situata e kontrollit ose marrëdhënia nënkupton që ofertat i atribuohen një qendre të vetme vendimmarrëse;

1.6.14. kanë lidhur kontrata pune në varësi, ose të vetëpunësuar dhe, në çdo rast, u kanë ngarkuar detyra ish punonjësve të autoritetit kontraktor, të cilët kanë ndërprerë marrëdhënien e tyre të punës më pak se tre vjet më parë dhe që në tre vitet e fundit të shërbimit kanë ushtruar kompetenca autoritative ose negociuese në emër të të njëjtit autoritet kontraktor ndaj të njëjtit operator ekonomik.

1.7. Një operator ekonomik duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e tenderit edhe nëse arsyet e përjashtimit të parashikuara në paragrafin 1.6 kanë të bëjnë me një anëtar të bordit administrativ, drejtues, ose mbikëqyrës të atij operatori ekonomik, ose një person që ka kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje, ose kontrolli në të.

2. PROCEDURAT E ZGJEDHJES SË KONTRAKTORIT

2.1. Dhënia dhe ekzekutimi i tenderave për punë, shërbime, furnizime dhe koncesione garantojnë cilësinë e shërbimeve dhe kryhen në përputhje me parimet e rezultatit, besimit, aksesit në treg, mirëbesimit dhe mbrojtjes së besimit, autonomisë kontraktuale, ruajtjes së ekuilibrit kontraktual, rreptësisë së shkaqeve të përjashtimit dhe pjesëmarrjes maksimale. Në dhënien e tenderave dhe koncesioneve, autoritetet kontraktore respektojnë edhe parimet e ekonomisë, efektivitetit, afatit dhe korrektësisë, konkurrencës së lirë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, si dhe reklamës. Parimi i ekonomisë mund t'u nënshtrohet, brenda kufijve që lejohet shprehimisht nga ligjet në fuqi, kriterëve të parashikuara në tender, të frymëzuara nga



nevojat sociale, si dhe mbrojtjes së shëndetit, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm, edhe nga pikëpamja energjetike.

2.2. Konceptimi i procedurës së tenderit ose koncesionit nuk mund të ketë synimin e kufizimit artificial të konkurrencës, me qëllim favorizimin ose mosfavorizimin e parregullt të operatorëve të caktuar ekonomikë ose të disapunimeve, furnizimeve ose shërbimeve të caktuara.

2.3. Kriteret për pjesëmarrje në tendera duhet të jenë të tilla që të mos përjashtojnë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

2.4. Dokumentacioni i tenderit specifikon shumën e përdorur si bazë për tenderin për kontratën që do të jepet. Ofertat për shuma më të larta përjashtohen automatikisht.

2.5. Procedura e përzgjedhjes së kontraktorit anulohet nëse dorëzohen më pak se tre aplikime/oferta të përshtatshme. Nëse kushtet objektive të tregut e bëjnë shumë të pamundur paraqitjen e tre ofertave të përshtatshme, njoftimi i tenderit mund të lejojë dhënien e kontratës edhe me një ose dy oferta të vlefshme.

2.6. Çdo konkurrent nuk mund të paraqesë më shumë se një ofertë. Në paraqitjen e ofertës së tyre në tender, konkurrentët deklarojnë se nuk kanë ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe se nuk kanë ndonjë lidhje specifike me konkurrentë të tjerë ose me palë të tjera të përfshira në cilësi të ndryshme në projekt.

2.7. Në mungesë të autorizimit të shprehur në dokumentacionin e tenderit, nuk autorizohen variante të ofertës. Variantet janë të lidhura me objektin e tenderit.

2.8. Për pjesëmarrjen në procedurat e përzgjedhjes që i nënshtrohen miratimit të AICS, autoriteti kontraktor u kërkon ofertuesve të japin një garanci për një shumë të barabartë me 2% të shumës së tenderit. Garancitë mund të jenë bankare ose sigurimesh, duhet të parashikojnë heqjen dorë të shprehur të përfuturit të zbatimit paraprak të debitorit kryesor dhe të jenë funksionale me kërkesë të thjeshtë me shkrim nga autoriteti kontraktor. Garancia zbatohet në rast mosnënshkrimi të kontratës që i atribuohet fituesit të tenderit. Autoriteti kontraktor mund të zvogëlojë në mënyrë të arsyetuar shumën deri në 1%, ose ta rrisë atë deri në 4% për ta bërë shumën e garancisë proporcionale dhe të përshtatshme me natyrën e shërbimeve objekt caktimi dhe shkallën e rrezikut që lidhet me të.

3. EKZEKUTIMI I KONTRATAVE

3.1. Ekzekutimi i kontratave për kontratat që do të nënshkruhen pas një procedure përzgjedhjeje që i nënshtrohet miratimit nga AICS është e garantuar me një garanci normalisht të barabartë me 10% të shumës së kontratës. Garancitë mund të jenë bankare ose sigurimesh, duhet të parashikojnë heqjen dorë të shprehur të përfuturit të zbatimit paraprak të debitorit kryesor dhe të jenë funksionale me kërkesë të thjeshtë me shkrim nga autoriteti kontraktor. Garancitë për ekzekutimin e kontratës duhet të parashikojnë, në dokumentacionin e tenderit, zbatimin në rast mashtrimi ose mospërbushjeje të rëndë nga ekzekutuesi. Garancitë e ekzekutimit lirohen në mënyrë progresive në bazë



të ecurisë së ekzekutimit dhe në çdo rast deri në maksimum 80% të shumës së garantuar. Pjesa e mbetur prej 20% lirohet pas verifikimit të ekzekutimit të rregullt.

3.2. Kontratat mund të modifikohen gjatë ekzekutimit me miratimin paraprak të AICS dhe brenda kufijve të përcaktuar nga neni 72 i Direktivës 2014/24/BE. Shuma e ndryshimeve në asnjë rast nuk mund të tejkalojë burimet e përgjithshme financiare të parashikuara për zbatimin e Marrëveshjes. Miratimi i ndryshimeve mund të refuzohet nëse ato e bëjnë të pamundur ose jashtëzakonisht të pamundur ekzekutimin e të gjithë komponentëve të nismës së parashikuar nga Marrëveshja. Kontraktorët nuk kanë të drejtë për asnjë pagesë ose rimbursim për modifikimet e kryera pa autorizim paraprak nga AICS. Me kërkesë të AICS ose autoritetit kontraktor, fituesi i tenderit me shpenzimet e tij rivendos situatën në gjendje të pacenuar.

3.3. Autoriteti kontraktues, nëse gjatë ekzekutimit bëhet e nevojshme të rritet ose të ulet performanca deri në një të pestën e shumës së kontratës, mund t'i imponojë kontraktuesit ekzekutimin me të njëjtat kushte të parashikuara në kontratën origjinale. Në këtë rast kontraktori nuk mund ta zgjidhë kontratën.

3.4. Kontratat nuk mund t'u kalohen palëve të treta, në të kundërt kontrata do të zgjidhet.

3.4. bis Transferimi është i pranueshëm, pas marrjes së miratimit të AICS, vetëm nëse kontraktori fillestar do të marrë vendin e tij, për shkak të vdekjes ose pas ristrukturimit të shoqërisë duke përfshirë këtu mbledhjen e të dhënave ekonomike, bashkimet, ndarjet, blerjen ose falimentimin, nga një operator tjetër ekonomik që plotëson kriteret e përzgjedhjes cilësore të përcaktuar fillimisht, vetëm nëse kjo nuk sjell ndryshime të tjera thelbësore kontratës dhe nuk ka për qëllim shmangien e zbatimit të këtij aneksi.

3.5. Kohëzgjatja e kontratës mund të ndryshojë vetëm për kontratat në proces, nëse në dokumentet e tenderit parashikohet një opsion zgjatjeje. Në këtë rast kontraktori kërkohet të kryejë shërbimet e parashikuara në kontratë me të njëjtat çmime, marrëveshje dhe kushte ose më të favorshme për autoritetin kontraktor.

3.6. Pa cenuar respektimin e detyrimeve të gjurmueshmërisë të përmendur në paragrafin 3.9, transfertat e kredive sipas tarifave të tenderit, koncesionit dhe konkursit të projektimit janë efektive dhe të kundërshtueshme ndaj qeverisë italiane vetëm me miratimin paraprak të AICS. Në çdo rast, autoriteti kontraktor, të cilit i është njoftuar transferimi, duhet të rezervojë të drejtën të ngrejë ndaj marrësit të gjitha kundërshtimet që mund të ngrihen për transferuesin në bazë të kontratës në lidhje me punimet, shërbimet, furnizimet dhe planifikimin të nënshkruar me të.

3.7. Titullarët e ngarkuar me detyrën e projektimit janë përgjegjës për dëmet e pësuar nga autoritetet kontraktore si rezultat i gabimeve ose mosrealizimit të projektit. Në rastin e tenderave me objekt projektimin ekzekutiv dhe ekzekutimin e punimeve, kontraktori është përgjegjës për vonesat dhe kostot që vijnë nga nevoja për të bërë ndryshime për shkak të mangësive në projektin ekzekutiv.

3.8. Dokumentacioni i tenderit specifikon kushtet e nënkontraktimit. Konkurrentët duhet të deklarojnë, në ofertat e tyre, cilat furnizime, shërbime ose punë synojnë të nënkontraktajnë. Fituesit e tenderit depozitojnë kontratat e nënkontraktimit pranë autoritetit kontraktor përpara fillimit të punimeve objekt nënkontraktimi. Kontraktorët



kryesorë marrin përgjegjësinë e plotë për të gjithë kontratën ndaj autoritetit kontraktor. Nënkontraktorët duhet të zotërojnë kërkesat e përcaktuara në përputhje me paragrafin 1.2 për me shërbimet që do të duhet të kryejnë dhe të mos ndeshen me arsyet e përjashtimit të parashikuara në paragrafët 1.6 dhe 1.7. Konkurrenti ose kontraktori zëvendëson nënkontraktorët që kanë arsye për përjashtim.

3.9. Çmimet e kontratës shprehen dhe paguhën në euro ose në monedhë të ndryshme të parashikuar shprehimisht në Marrëveshje. Rreziqet dhe ndryshimet në kursin e këmbimit në këtë rast nuk do t'i nënshtrohen asnjë kompensimi.

3.10. Pagesat kryhen duke përdorur metoda të gjurmueshme, sipas afateve të përcaktuara kontraktuale të cilat marrin parasysh ecurinë reale të ekzekutimit. Qeveria italiane kryen akreditimet për Palën tjetër Kontraktuese të parashikuar nga Marrëveshja në një llogari bankare të dedikuar vetëm për ekzekutimin e Marrëveshjes. Në kontrata është përfshirë një klauzolë që detyron kontraktorin, nënkontraktorët dhe palë që angazhohet nga nënkontraktori të përdorin një llogari bankare të dedikuar për pagesa.

3.11. Kontrata zgjidhet automatikisht nëse fituesit e kontratës i nënshtrohen procedurave të falimentimit, likuidimit të detyrueshëm, administrimit gjyqësor, ose administrimit të përkohshëm, ose gjenden në një situatë të ngjashme sipas një procedure të parashikuar nga legjislacioni kombëtar përkatës.

3.12. Në rastin e dashjesose fajit të rëndë, nuk lejohet kufizimi i përgjegjësisë së kontraktorëve, nënkontraktorëve, apo palëve që angazhohen nga nënkontraktori.

3.13. Ekzekutimi i kontratës rregullohet nga ligji kombëtar i autoritetit kontraktor, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Marrëveshje dhe në këtë Aneks.

3.14. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ofertuesve të suksesshëm dhe autoritetit kontraktor nuk i nënshtrohen juridiksionit italian.

3.15. Dokumentacioni i tenderit duhet të përmbajë parimet e sipërpërmendura.

4. SHPENZIMET E PRANUESHME DHE TE PAPRANUESHME

4.1. Kostot e zbritura në kontrata janë të pranueshme nëse janë aktuale, të përshtatshme dhe të nevojshme për të realizuar projektin sipas dokumentit të projektit.

4.2. Në çdo rast, nuk janë të pranueshme kostot që kanë të bëjnë me:

4.2.1. mallra jo të domosdoshme ose luksi;

4.2.2. mallra, shërbime dhe punë civile të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me aktivitete ushtarake;

4.2.3. taksa, detyrime indirekte, duke përfshirë TVSH-në, dhe detyrimet doganore që mund t'i detyrohen shtetit të cilit i përket autoriteti kontraktor;

4.2.4. amortizimin e borxheve të kontraktuara më parë dhe humbjet e ardhshme të autoritetit kontraktues ose përdoruesve fundorë;

4.2.5. interesa që nga autoriteti kontraktor ose përdoruesit fundorë u detyrohen palëve të treta.



5. KLAUZOLAT ETIKE

5.1. Çdo përpjekje e konkurrentëve (potencialë ose jo) për të marrë informacione konfidenciale, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentë të tjerë, ose për të ndikuar tek autoriteti kontraktor në fazat e analizës, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, sjell përjashtimin e konkurrentit nga tenderi dhe, si pasojë, eliminimin e ofertës së tij.

5.2. Personeli që punon në administratën publike të Palëve Kontraktuese në Marrëveshje, pavarësisht nga pozicioni specifik administrativ në të cilin ndodhen, nuk mund të punësohet si ekspertë ose konsulentë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender.

5.3. Fituesit e tenderit duhet të veprojnë gjithmonë në mënyrë të paanshme dhe si këshilltarë besnikë, në përputhje me kodin e sjelljes së profesioneve përkatëse. Ata nuk bëjnë deklarata publike për projektin apo shërbimet e kërkuara prej tyre, pa miratimin paraprak nga autoriteti kontraktor. Në çdo rast, ato nuk e detyrojnë në asnjë mënyrë autoritetin kontraktues pa pëlqimin paraprak me shkrim të tij.

5.4. Për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës, fituesit e tenderit respektojnë të drejtat e njeriut dhe angazhohen të mos cenojnë parimet, traditat dhe zakonet politike, kulturore dhe fetare të vendit përfitues. Në veçanti, fituesit e kontratave respektojnë standardet themelore të punës të përcaktuara nga konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në fuqi për vendin partner dhe për Italinë. Në çdo rast, sigurohet respektimi i dispozitave të "Konventës për lirinë sindikaliste dhe mbrojtjen e së drejtës sindikaliste", "Konventës për të drejtën për organizim dhe bisedime kolektive", të "Konventës për punën e detyrueshme", të plotësuar nga Protokolli i vitit 2014, të "Konventës për diskriminimin (punësim dhe profesion)", dhe "Konventës mbi format me të këqija të punës së të miturve", "Konventës për mbrojtjen e amësisë", të "Konventës për sigurinë dhe shëndetin në bujqësi" dhe të "Konventës kuadër për sigurinë në punë dhe shëndetin".

5.5. Fituesit e tenderit nuk pranojnë pagesa të lidhura me kontratën, përveç atyre të parashikuara në të. Fituesit e tenderit nuk kryejnë asnjë aktivitet dhe as përfitojnë ndonjë avantazh nga autoriteti kontraktor që nuk është në përputhje me detyrimet kontraktore përkatëse.

5.6. Fituesit e tenderit ruajnë sekretin profesional gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës dhe gjithashtu pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e hartuara ose të marra nga fituesi i tenderit janë konfidenciale.

5.7. Fituesit e tenderit shmangin çdo marrëdhënie që mund të rrezikojë pavarësinë e tyre ose të stafit të tyre ose ndonjë konflikt tjetër interesi. Nëse fituesit e tenderit pushojnë së qeni të pavarur ose shfaqen konflikte interesi gjatë ekzekutimit, fituesit e tenderit informojnë menjëherë autoritetin kontraktor. Autoriteti kontraktor mund ta zgjidhë kontratën pa paralajmërim dhe pa qenë në gjendje fituesi i tenderit të paraqesë pretendime për kompensim për dëmet.

5.8. Qeveria italiane rezervon të drejtën të pezullojë ose anulojë financimin e projektit, nëse në çdo fazë të procedurës së caktimit të fituesit do të shfaqen praktika korruptive



të çdo lloji dhe nëse autoriteti kontraktor nuk ka mundur të marrë të gjitha masat e duhura për të korrigjuar situatën e krijuar. Për qëllimet e kësaj klauzole, "praktika korruptive" janë ofertat e ryshfetit, dhuratave, donacioneve ose komisioneve, si një nxitje ose shpërblim për çdo person për kryerjen ose abstenimin nga kryerja e çdo veprimi që lidhet me dhënien ose zbatimin e një kontrate të lidhur tashmë me autoritetin kontraktor.

5.9. Dokumentacioni i tenderit dhe kontratat përfshijnë një klauzolë që parashikon anulimin e tenderit ose zgjidhjen e kontratës tashmë të lidhur, edhe nëse është në proces ekzekutimi, ose tashmë e ekzekutuar, nëse dhënia ose ekzekutimi i kontratës ka shkaktuar shpenzime të pazakonta tregtare. "Shpenzime të pazakonta tregëtare" janë komisionet që nuk përmenden në kontratën kryesore, ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur siç duhet dhe që i referohen kontratës kryesore, komisionet e paguara jo si rezultat i shërbimeve të ligjshme dhe realisht të kryera, komisionet e paguara në një parajsë fiskale, komisionet e paguara për një përfitues të identifikuar në mënyrë të paqartë, ose komisionet e paguara për një kompani fiktive.

5.10. Fituesit e tenderit, me kërkesë të AICS, ofrojnë elemente prove, për të shpjeguar kushtet në të cilat është ekzekutuar kontrata. Autoritetet kompetente të Republikës Italiane mund të kryejnë çdo kontroll, të dokumentacionit ose në terren, që ata e gjykojnë të nevojshme për të mbledhur elemente prove në rastet e dyshimeve për shpenzime të pazakonta tregtare ose për praktika të dyshuara korruptive.

5.11. Fituesit e tenderit që kanë paguar shpenzime të pazakonta tregtare në projekte të financuara nga fondet italiane i nënshtrohen, në varësi të seriozitetit të fakteve të konstatuara, zgjidhjes së kontratës ose përjashtimit të përhershëm nga marrja e pagesave me financim nga qeveria italiane.

5.12. Mosrespektimi i një ose më shumë klauzolave etike nga konkurrenti ose fituesi i tenderit mund të sjellë përjashtimin e tyre nga kontrata të tjera të financuara, pjesërisht ose tërësisht, me fondet italiane të ndihmës për zhvillim, dhe zbatimin e sanksioneve të parashikuara në kontratë. Individit ose kompania përgjegjëse duhet të informohet me shkrim për faktin.

5.13. Autoriteti kontraktor siguron që procedurat për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve të kryhen në mënyrë transparente, bazuar në kritere objektive dhe të pavarura nga çdo ndikim i jashtëm.



Ndërkombëtar të Republikës Italiane - Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin Zhvillimor: dgcs5@esteri.it;

- për AICS - Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor, Romë, Itali: protocol.aics@pec.aics.gov.it.

Neni 19

HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nga dy njoftimet, me anë të të cilave Palët informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme përkatëse të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e aktiviteteve të projektit, pa paragjykuar mundësinë e Palëve për ta anuluar atë në përputhje me Nenin 15.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në ROMË, më 13.11.2025, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe italiane, me vlerë të njëjtë.

**PËR KËSHILLIN E
MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**



Piro Vengu

Ministër i Mbrojtjes

**PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS ITALIANE**



Antonio Tajani

**Ministër i Punëve të Jashtme
dhe Bashkëpunimin
Ndërkombëtar**

Shtojcat:

1. Dokumenti i Projektit;
2. Klauzola etike dhe parime themelore për lidhjen dhe zbatimin e kontratave.



VENDIM

Nr. 44, datë 21.1.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
VEPRIMIT *SCHENGEN* 2026–2030

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit *Schengen* 2026–2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministritë e linjës dhe institucionet e tjera, për të cilat në plan janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

PLANI I VEPRIMIT TË *SCHENGEN*-it*Për periudhën 2026–2030*

1. Hyrje

Zona *Schengen* është një nga arritjet më të rëndësishme të integritetit evropian, duke e bërë të mundur lëvizjen e lirë pa kontrolle kufitare të brendshme. Megjithatë, kjo liri shoqërohet me kërkesa të larta, të tilla si menaxhimi efektiv i kufijve të jashtëm dhe bashkëpunimi i ngushtë në azilin, politikën e vizave, sigurinë dhe koordinimin policor. Për Shqipërinë, përgatitja për anëtarësim në *Schengen* ka një qëllim të dyfishtë. Nga njëra anë, është thelbësore të tregohet gatishmëria për t'u bashkuar me zonën pa kufij. Nga ana tjetër, mbështet drejtpërdrejt procesin më të gjerë të pranimit në BE, pasi të njëjtat detyrime janë pjesë e Kapitullit 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”. Prandaj, progresi në *Schengen* është i pandashëm nga progresi në standardet e Kapitullit 24 Cluster I (Themeloret). Shqipëria pritet të japë rezultate konkrete në fusha të tilla si menaxhimi i migracionit, forcimi i sistemit të azilit dhe përmirësimi i kontrolleve të kufijve të jashtëm, në përputhje me Planin e Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Duke ndërtuar institucione të forta dhe të koordinuara mirë,

veçanërisht në zbatimin e ligjit dhe menaxhimit të kufijve, Shqipëria do të përgatitet për përgjegjësitë e *Schengen*-it dhe do të përparojë me vendosmëri në rrugën e saj drejt anëtarësimit të plotë në BE.

Në këtë kuadër, Plani i Veprimit *Schengen* (PVS) është mjeti qendror që udhëheq përpjekjet e Shqipërisë. Ai luan një rol të dyfishtë: ndihmon vendin të përmbushë standardet e pranimit në BE, ndërkohë që përgatitet, gjithashtu, për pranim në zonën *Schengen*. PVS-ja përcakton masa konkrete të lidhura drejtpërdrejt me *acquis Schengen* dhe komponentët e tij përkatës, por nuk duhet parë i izoluar. Ai duhet të lexohet së bashku me strategjitë e tjera sektoriale dhe institucionale, si dhe planet e tyre përkatëse të veprimit, të cilat tashmë mbulojnë shumicën e fushave të trajtuara nga Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”. Në këtë mënyrë, PVS-ja shkon përtej qëllimit të tij kryesor për të siguruar gatishmërinë e Shqipërisë për t'u bashkuar me Zonën *Schengen*, por, gjithashtu, përforcon dhe plotëson procesin më të gjerë të pranimit në BE. Masat dhe veprimet që përmban janë hartuar për të funksionuar së bashku me dokumentet ekzistuese strategjike, duke krijuar një kornizë koherente që forcon progresin e përgjithshëm të Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është përmbushja e kërkesave dhe standardeve të *Schengen*-it dhe vazhdimi i përpjekjeve për të përmirësuar më tej menaxhimin e integruar të kufijve, duke ruajtur një nivel të lartë të sigurisë kufitare dhe kushtet e sigurisë së brendshme si pjesë integrale e sistemit të përgjithshëm të sigurisë së Shqipërisë, për të siguruar kontroll të besueshëm të kufirit shtetëror, për të lehtësuar trafikun ndërkufitar në pikat e kalimit kufitar, për të parandaluar dhe menaxhuar migracionin e parregullt, për të parandaluar dhe ndërprerë krimin ndërkufitar dhe për të përmirësuar procesin e kthimit për personat që nuk kanë leje të qëndrojnë në Shqipëri. Migracioni i parregullt, terrorizmi, krimi i organizuar dhe ndërkombëtar, kërcënimet kibernetike dhe ndjeshmëria në rritje e shoqërisë moderne janë sfida që kërkojnë zhvillimin e aftësive për të menaxhuar kufirin me qëllim parandalimin e kërcënimeve të tilla.

Duke u bazuar në strategjitë ekzistuese ndërinstitucionale dhe sektoriale, qeveria shqiptare ka një vizion të qartë afatmesëm dhe afatgjatë, për përafrimin e politikave dhe operacioneve kombëtare me kërkesat e *Schengen*-it dhe të BE-së, gjë që do të



sigurojë gatishmërinë për integrimin në *Schengen* dhe pajtueshmërinë e qëndrueshme.

Objektivi strategjik është që deri në vitin 2030, që përbën objektivin kryesor të qeverisë për t'u anëtarësuar në BE, Shqipëria të ketë përmbushur të gjitha kërkesat e *Schengen*-it, të cilat do të zbatohen përmes Planit Kombëtar të Veprimit të *Schengen*-it. Pikat e ardhshme kyçe teknike të arritjes së zbatimit të plotë të rregullave të *Schengen*-it dhe të cilat përbëjnë parakushte për përfitimin e të drejtave të caktuara të *Schengen*-it, të tilla si qasja e plotë operacionale në të gjitha sistemet përkatëse të informacionit, autoriteti për të lëshuar viza *Schengen* dhe heqja e kontrolleve të kufijve të brendshëm, do të zbatohen brenda pak vitesh nga data e anëtarësimit.

Autoritetet shtetërore shqiptare do të marrin përsipër detyrimin e plotë për të miratuar standardet dhe praktikat më të mira të *Schengen*-it në fushën e sigurisë kufitare, duke u përgatitur për të marrë përsipër përgjegjësinë e kontrollit të kufijve të jashtëm të Bashkimit Europian.

Plani i Veprimit të *Schengen*-it për Shqipërinë mbështet vizionin e paraqitur në dokumente të tjera të integritimit në BE. Ai përfshin një pasqyrë gjithëpërfshirëse kombëtare të të gjitha zhvillimeve në zonën e menaxhimit të integruar të kufijve dhe fushave të lidhura me standardet e *Schengen*-it dhe identifikimin e nevojave të reja në të gjitha fushat që ndikojnë në zbatimin e *Schengen*-it. Objektivat specifike të këtij dokumenti janë plotësisht në përputhje me objektivat e dokumenteve strategjike në nivel kombëtar.

Procesi i hartimit u drejtua nga Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me një grup pune të përbërë nga institucionet kryesore të përfshira në proces. Pas përfundimit, Plani i Veprimit *Schengen* do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, duke theksuar rëndësinë e saj dhe duke siguruar angazhimin e plotë të të gjitha agjencive shtetërore të përfshira në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në dokument. Zbatimi i tij do të monitorohet nga afër nga Koordinatori Kombëtar i *Schengen*-it, i mbështetur nga Struktura Drejtuese e *Schengen*-it, e cila përbëhet nga institucione kryesore shtetërore përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me *Schengen*-in. Këto struktura do të shërbejnë si autoriteti kryesor përgjegjës për koordinimin dhe përditësimin e PVS-së.

Plani i Veprimit i *Schengen*-it përmban një pasqyrë të masave, të cilat përkthehen në aktivitete konkrete, për secilin nga kapitujt e mbuluar, të nevojshme për të arritur objektivat e përgjithshëm dhe specifike. Për secilin aktivitet parashikohen autoritetet përgjegjëse, afatet, burimi i financimit dhe treguesit e rezultateve, si dhe gjendja e zbatimit për të monitoruar nga afër zhvillimet.

Plani i Veprimit të *Schengen*-it mbulon objektivin e përgjithshëm dhe 11 objektiva specifike si më poshtë:

Objektivi i përgjithshëm

Të sigurohet përafrimi i plotë i Shqipërisë me standardet e *Schengen*-it si pjesë integrale e *acquis* të BE-së, nëpërmjet zbatimit gjithëpërfshirës dhe strukturor të të gjitha masave të kërkuara ligjore dhe operacionale, me qëllim përmbushjen e të gjitha kushteve deri në kohën e anëtarësimit në BE.

Objektivi specifik 1 (Drejtimi i *Schengen*-it)

1.1 Ngritja e një strukture drejtuese të *Schengen*-it të udhëhequr nga një Koordinator Kombëtar i caktuar i *Schengen*-it, i mbështetur nga një kuadër ligjor koordinimi që angazhon të gjithë palët e interesuara përkatëse.

Objektivi specifik 2 (Menaxhimi i kufijve të jashtëm)

2.1 Për të arritur përputhshmëri të plotë me standardet e *Schengen*-it duke harmonizuar kornizat legislative, administrative dhe institucionale, dhe duke përmirësuar infrastrukturën dhe pajisjet.

2.2 Forcimi i koordinimit ndërinstitucional dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar

2.3 Përmirësimi i kontrollit kufitar duke rritur kapacitetet institucionale të strukturave të sapokrijuara dhe ekzistuese të menaxhimit kufitar.

2.4 Përmirësimi i nivelit të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave themelore nga shërbimet e kontrollit kufitar

Objektivi specifik 3 (Situata dhe zhvillimi në kufijtë e brendshëm (të ardhshëm))

3.1 Të zhvillohen korniza ligjore dhe operacionale që sigurojnë pajtueshmëri në mungesë të kontrolleve të kufijve të brendshëm, duke rritur njëkohësisht bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh me shtetet fqinje të *Schengen*-it.

Objektivi specifik 4 (Politika e kthimit)

4.1 Për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të kthimit dhe ripranimit për shtetasit e huaj.

4.2 Për të rritur kapacitetin operacional dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, duke përforcuar



njëkohësisht masat mbrojtëse për të siguruar mbrojtjen e të drejtave themelore.

4.3 Për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar dhe gatishmërinë operacionale për zbatimin efektiv të procedurave të kthimit.

Objektivi specifik 5 (Sisteme informacioni në shkallë të gjerë)

5.1 Për të harmonizuar aktet ligjore, teknike dhe operacionale me sistemet e informacionit *Schengen* dhe për të siguruar një arkitekturë dhe infrastrukturë teknike të sigurt dhe të ndërveprueshme për lidhje të pandërprerë.

Objektivi specifik 6 (Politika e përbashkët e vizave dhe qarkullimi i lirë me viza afatgjata dhe leje qëndrimi)

6.1 Përmirësimi i procedurave, sistemeve dhe kapaciteteve institucionale kombëtare të vizave për t'u përafëruar me Politikën e Përbashkët të Vizave të BE-së dhe sigurimi i gatishmërisë për integrimin me Sistemin e Informacionit të Vizave (VIS).

Objektivi specifik 7 (Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit dhe siguria e brendshme)

7.1 Për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar midis agjencive të zbatimit të ligjit, për të luftuar në mënyrë efektive aktivitetet kriminale ndërkufitare

Objektivi specifik 8 (Mbrojtja e të dhënave në lidhje me kornizën e *Schengen-it*)

8.1 Për të përmirësuar kuadrin rregullator dhe për të forcuar kapacitetet teknike dhe organizative në fushën e mbrojtjes së të dhënave, për t'u përafëruar me standardet e BE-së.

Objektivi specifik 9 (Legjislacioni për armët e zjarrit)

9.1 Për të harmonizuar plotësisht kuadrin ligjor kombëtar me *acquis* të BE-së dhe për të rritur kapacitetet logjistike dhe operacionale të institucioneve të zbatimit të ligjit në fushën e armëve të zjarrit.

Objektivi specifik 10 (Funksionimi i autoriteteve që zbatojnë *acquis*-in e *Schengen-it*)

10.1 Të forcohen kornizat kundër korrupsionit dhe integritetit në të gjitha autoritetet përkatëse të *Schengen-it* duke zbatuar reforma të synuara ligjore dhe strukturore, dhe të sigurohen procese të drejta, transparente dhe të bazuara në meritë të rekrutimit dhe përparimit në karrierë.

Objektivi specifik 11 (Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale)

11.1 Për të rritur bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor.

Vlerësimi dhe monitorimi

12.1 Të sigurohet monitorimi efektiv i aktiviteteve të PVS-së për të garantuar zbatimin e tyre dhe arritjen e objektivave të përcaktuara.

2. Procesi i hartimit të Planit të Veprimit të *Schengen-it*

Ky Plan Veprimi është përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet kryesore të përfshira në menaxhimin e kufijve, si dhe institucione të tjera shtetërore përgjegjëse për masat e përshkruara në kapitujt e ndryshëm të planit të veprimit. Drafti fillestar i hartuar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 12.1.2026, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Planit të Veprimit *Schengen* 2026–2030”, u shpërnda më pas për konsultim me të gjerë me të gjithë aktorët shtetërorë përkatës dhe palët e tjera të interesuara. Më pas, ai ndoqi procedurat formale për miratim nga Këshilli i Ministrave.

3. Burimet Financiare për zbatimin e Planit të Veprimit të *Schengen-it*

Burimet e nevojshme financiare për zbatimin e masave të përfshira në Planin e Veprimit të *Schengen-it* do të planifikohen çdo vit, brenda buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë, i cili do të përbëjë burimin kryesor financiar.

Procesi i përcaktimit të kostos do të bazohet në konsultimin e dokumenteve kombëtare, duke përfshirë Programet Buxhetore Afatmesme, si dhe në konsultimet me institucionet përkatëse. Do të zhvillohet dhe përfshihet një përcaktim analitik i kostos për secilën masë individuale të përcaktuar në planin e veprimit dhe bazuar në progresin e arritur, do të zhvillohet një vlerësim vjetor për të siguruar një mekanizëm të qëndrueshëm financimi.

Mbështetja financiare e donatorëve do të përfaqësojë, gjithashtu, një burim kyç financimi për masa dhe aktivitete të ndryshme. Në këtë kontekst, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përcaktimit të përparësive të financimit të BE-së për objektivat që lidhen me *Schengen-in*, me agjencitë përkatëse që mbikëqyrin koordinimin e donatorëve. Në këtë kontekst, përparësi do t'u jepet zhvillimeve aktuale dhe investimeve ekzistuese, veçanërisht në infrastrukturë dhe sistemet e IT-së, duke marrë në konsideratë me kujdes nismat e mbështetura nga donatorët, me qëllim sigurimin e mirëmbajtjes së tyre të rregullt dhe përmirësimeve në kohë



KAPITULLI 1 DREJTIMI I SCHENGEN-it

Për të siguruar koherencë dhe për të lehtësuar integrimin pa probleme në sistemin *Schengen*, qeveria shqiptare do të marrë të gjitha masat e nevojshme që të paraqesë një strukturë në cilësinë e organit kombëtar drejtues të *Schengen-it*, me qëllimin e tij kryesor demonstrimin e aftësisë për të hartuar, koordinuar dhe mbikëqyrur zbatimin e standardeve të *Schengen-it* në të gjitha fushat dhe autoritetet përkatëse të politikave. Ai do të vijojë të shërbejë si struktura kryesore drejtuese për zhvillimet që lidhen me *Schengen-in*, duke siguruar përmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve pas anëtarësimit në *Schengen*.

Prandaj, do të ngrihet një mekanizëm kombëtar koordinimi dhe bashkëpunimi i të gjitha autoriteteve dhe agjencive të përfshira në sigurinë kufitare.

Një numër institucionesh qeveritare do të përfshihen në këtë mekanizëm, i cili përfshin, por nuk kufizohet vetëm nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Integritetit Europian dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Migracionin dhe Azilin), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Departamenti i Kufirit dhe Migracionit), Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme (Drejtoria e Çështjeve Konsullore), Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave), Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë), Ministria e Mbrojtjes/Roja Bregdetare dhe QNOD, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Të gjitha institucionet shtetërore të mësipërme do të kenë një rol specifik, si struktura përgjegjëse për koordinimin e politikave dhe masave që ndikojnë në funksionimin e sistemit *Schengen*, me role dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë, në të gjitha nivelet, për zbatimin e Planit të Veprimit të *Schengen-it*. Kështu, krijimi i një strukture formale administrative për menaxhimin e *Schengen-it*, mundëson koordinim efektiv në të gjitha nivelet politike dhe operationale. Kjo strukturë drejtohet nga Koordinatori Kombëtar i *Schengen-it*/zëvendësministri i Punëve të Brendshme, i cili do

të ketë një mandat dhe autoritet të qartë për të mbikëqyrur dhe drejtuar të gjitha aktivitetet që lidhen me *Schengen-in* dhe të përcaktojë rolin institucional në procesin e vlerësimit të *Schengen-it*.

Për të siguruar zbatimin dhe pajtueshmërinë me *acquis* e *Schengen-it* në të gjitha fushat Koordinatori Kombëtar i *Schengen-it*, i mbështetur nga Struktura Drejtuese e *Schengen-it* e cila përbëhet nga institucione kryesore shtetërore përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve të *Schengen-it*, do të mbikëqyrë të gjithë procesin. Ndër funksionet e saj, Koordinatori Kombëtar i *Schengen-it* do të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e aktiviteteve sipas Planit të Veprimit të *Schengen-it*.

Për të siguruar arritjen e objektivave, do të merren masat e mëposhtme:

- Zhvillimi i një kuadri ligjor gjithëpërfshirës për të siguruar bashkëpunim dhe koordinim efektiv midis të gjithë palëve të interesuara të përfshira;

- Zhvillimi dhe miratimi i udhëzime gjithëpërfshirëse të monitorimit të brendshëm dhe sigurimit të cilësisë; Ndryshimet në aktivitetet ndërsektoriale, duke marrë parasysh arritjet, rrethanat, rreziqet, përvojat e fituara dhe rekomandimet;

- Konsultimet me palët e interesuara, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit.

Me objektivin e forcimit të ekspertizës kombëtare për të siguruar pjesëmarrje efektive në misionet e vlerësimit të *Schengen-it* dhe vlerësimet e brendshme, do të ndërmerren hapa praktikë për identifikimin dhe emërimin e ekspertëve në grupin e vlerësuesve të *Schengen-it*. Në të njëjtën kohë, do të sigurohet pjesëmarrje e rregullt në aktivitetet e trajnimit të udhëhequra nga KE në këtë drejtim.

Mbështetja financiare e vazhdueshme e BE-së është një instrument shumë i rëndësishëm në mbështetje të reformave të anëtarësimit në BE. Prandaj, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përcaktimit të përparësive të financimit të BE-së për objektivat që lidhen me *Schengen-in*. Në këtë drejtim, do të ndërmerren hapa për të krijuar një kornizë koordinimi midis aktorëve përkatës në këtë fushë. Do të jetë një mekanizëm fleksibël, i cili përveç prioriteteve të integritetit në buxhetin kombëtar, do të adresojë edhe dobësitë e reja të hasura/identifikuara.



OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1

Ngritja e një strukture menaxhuese të *Schengen*-it të udhëhequr nga një Koordinator Kombëtar i caktuar i *Schengen*-it, i mbështetur nga një kuadër ligjor koordinimi që angazhon të gjithë palët e interesuara përkatëse.

MASA 1.1.1

Krijimi i strukturës kombëtare të drejtimit të *Schengen*-it për të menaxhuar procesin.

REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Organi kombëtar i drejtimit të *Schengen*-it dhe mekanizmat vlerësues dhe koordinues të ngritura

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
1.1.1.1	Hartimi i aktit nënligjor për të formalizuar strukturën menaxhuese të <i>Schengen</i> -it, të udhëhequr nga një koordinator kombëtar i caktuar, duke përcaktuar mandatet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e koordinimit për të siguruar planifikim, vendimmarrje dhe zbatim koherent në të gjitha ministrive dhe agjencive përkatëse.	Ministria e Punëve të Brendshme	Tremujori i parë 2026	Buxheti i Shtetit	Miratimi i aktit për ngritjen e strukturës	Në proces
1.1.1.2	Hartimi dhe miratimi i udhëzime gjithëpërfshirëse të monitorimit të brendshëm dhe sigurimit të cilësisë, duke përfshirë tregues të qartë të performancës.	Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucione të tjera	Tremujori i parë 2026	Buxheti i shtetit	Udhëzime të miratuara	
1.1.1.3	Përcaktimi i hapave proceduralë për identifikimin, trajnimin dhe emërimin e ekspertëve në grupin e vlerësuesve të <i>Schengen</i> -it.	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	Buxheti i shtetit	Procedurat e përcaktuara	
1.1.1.4	Krijimi i një kornize koordinues midis Koordinatorit Kombëtar të <i>Schengen</i> -it dhe Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës për të përcaktuar në mënyrë efektive përparësitë e financimit të BE-së për objektivat që lidhen me <i>Schengen</i> -in.	Ministria e Punëve të Brendshme Agjencia Shtetërore e Programit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës	Tremujori i parë 2026	Buxheti i shtetit	Korniza e koordinimit e krijuar	

KAPITULLI 2 MENAXHIMI I KUFIJVE TË JASHTËM

Shqipëria ka krijuar një kuadër strategjik gjithëpërfshirës dhe efektiv për menaxhimin e integruar të kufijve. Ky kuadër bazohet në Udhëzimet e BE-së për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, Katalogun e *Schengen*-it, legjislacionin përkatës të BE-së dhe Strategjinë Teknike dhe Operacionale për Menaxhimin e Integruar të Kufijve Europianë. Ai, gjithashtu, përfshin standardet e përcaktuara nga Komisioni Europian për kufijtë e jashtëm, konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe të drejtat e azilkërkuesve dhe

refugjatëve, si dhe praktikat më të mira nga Shtetet Anëtare të BE-së.

Shqipëria ka miratuar dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufijve dhe Planin e Veprimit 2021 – 2027, e cila synon të sigurojë kalim efikas ndërkufitar dhe të adresojë sfidat e migracionit dhe kërcënimet e mundshme për sigurinë kufitare. Strategjia synon të përcaktojë politikat e duhura në mënyrë që të sigurohet:

-Përmirësimi i mëtejshëm i standardeve të sigurisë kufitare duke përmirësuar më tej kuadrin ligjor dhe rregullator, me qëllim përafrimin e tij me *acquis* të BE-së.



- Përmirësimi i mëtejshëm i aftësive të analizës së riskut;

- Ndërtimi i kapaciteteve të reja dhe përmirësimi më tej i aftësive teknologjike për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufijve;

- Të forcohen më tej burimet njerëzore, si dhe kapacitetet operative dhe profesionale të autoriteteve dhe agjencive kompetente që veprojnë në kufi, me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen e krimit ndërkufitar;

- Të forcohet më tej bashkëpunimi ndërkufitar (me vendet fqinje, vendet në të gjithë rajonin, shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe agjencitë e tij, si dhe organizatat ndërkombëtare);

- Të sigurohet konsolidimi dhe riorganizimi i strukturave të integruara në kufi;

- Të forcohen kapacitetet dhe të përmirësohet më tej koordinimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për kërkim-shpëtimin e qytetarëve në situata të rrezikshme në det;

- Të sigurohet krijimi i një mekanizmi për kontrollin e cilësisë dhe respektimi rigoroz i të drejtave themelore të njeriut.

Për të arritur objektivin e përgjithshëm dhe objektivat specifike të strategjisë, masat dhe aktivitetet e planit të veprimit përqendrohen në sa vijon:

- Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe rregullator, i strukturave të agjencive kufitare, procedurave të punës, burimeve njerëzore dhe trajnimit, shkëmbimit të informacionit dhe infrastrukturës e pajisjeve me qëllim përafrimin me standardet e Bashkimit Europian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;

- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shkëmbimit të informacionit, procedurat për kontrollet e përbashkëta dhe analizën e përbashkët të rrezikut të komponentëve të caktuar që lidhen me kontrollin kufitar, përdorimin e përbashkët të infrastrukturës dhe pajisjeve kufitare, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të programeve të përbashkëta të trajnimit për stafin e agjencive kufitare;

- Përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërkombëtar me qëllim zbatimin e një sërë masash në luftën e autoriteteve kufitare kundër aktiviteteve të paligjshme përtej kufirit, përfshirë terrorizmin.

Në përputhje me objektivin e përgjithshëm dhe qëllimet specifike të përcaktuara në strategjinë kombëtare të MIK-ut, si dhe kërkesat për hartimin

e Planit të Veprimit të *Schengen-it*, është përcaktuar objektivi specifik për këtë kapitull të dokumentit.

Korniza ligjore e Shqipërisë është pjesërisht e përafruar me *acquis* të BE-së në fushën e menaxhimit të kufijve të jashtëm. Në korrik 2025, u miratua një ligj i ri për kontrollin e kufijve, i cili synon përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së. Ai është pjesërisht i përafruar me: Rregulloren e (BE) 2016/399 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e datës 9 mars 2016, mbi një Kod të Unionit mbi rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufijve (Kodi i Kufijve të *Schengen-it*) (kodifikim), siç është ndryshuar nga rregullorja (BE) 2016/1624 dhe nga Rregullorja (BE) 2017/458; rregullorja (BE) 2019/1896 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e datës 13 nëntor 2019, mbi Rojën Kufitare dhe Bregdetare Europiane dhe Strategjinë Teknike dhe Operacionale për Menaxhimin e Integruar të Kufijve Europianë; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/581 e datës 9 prill 2021 mbi pamjet situacionale të Sistemit Europian të Mbikëqyrjes së Kufijve (EUROSUR) dhe Rregullorja (KE) nr. 1931/2006 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e datës 20 dhjetor 2006, që përcakton rregullat mbi trafikun lokal kufitar në kufijtë e jashtëm tokësorë të Shteteve Anëtare dhe që ndryshon dispozitat e Konventës së *Schengen-it*.

Në lidhje me kuadrin institucional, ekzistojnë disa autoritete shtetërore që luajnë një rol të rëndësishëm në kontrollin e kufijve. Bashkëpunimi i mirë midis agjencive të Policisë Kufitare dhe të Migracionit, Rojës Bregdetare Shqiptare, Shërbimit Doganor, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Shërbimit Sanitar dhe Antiepidemi dhe agjencive të tjera të përfshira në MIK ofrojnë baza të mira për krijimin e një Qendre Kombëtare Koordinuese për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, gjë që nuk është bërë e mundur ende.

Shqipëria vazhdon të ketë një bashkëpunim operacional shumë të mirë dhe të vazhdueshëm me *Frontex-in* për kontrollin e kufijve bazuar në Marrëveshjet e Statusit midis Bashkimit Europian dhe Shqipërisë mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia Europiane e Kufirit dhe Bregdetit në Republikën e Shqipërisë, marrëveshjen e bashkëpunimit operacional dhe marrëveshjen mbi



aktivitetet operative.¹ Lidhur me kërkesën për integrim të përsheptuar në lidhje me *Frontex*-in, bashkëpunimi është tashmë shumë gjithëpërfshirës me Shqipërinë.

Në përputhje me marrëveshjen, operacione të përbashkëta mund kryhen kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë. Bashkëpunimi do të forcohet duke kryer operacione të përbashkëta në kufirin detar.

Bazuar në marrëveshjen e statusit dhe marrëveshjet për bashkëpunim operacional, bashkëpunimi me *Frontex* në kufirin detar nisi në vitin 2021 përmes operacionit të përbashkët “JO Albania Sea 2021”. Aktualisht, operacioni i përbashkët “JO Albania Sea 2025”, i cili nisi në janar 2025, është në zhvillim e sipër dhe do të vazhdojë deri në janar 2026. Bashkëpunimi me *Frontex* pritet të vijojë përmes operacionit të ardhshëm të përbashkët “JO Albania Sea 2026”, i planifikuar të nisë në janar 2026.

Një ndryshim në situatën në kufijtë e vendeve të tjera, qoftë të vendeve fqinje, qoftë të vendeve të Bashkimit Europian, mund të diktojë nevojën e pjesëmarrjes në operacione në nivel dypalësh dhe operacione të koordinuara nga *Frontex*. Shqipëria ka kontribuar në operacione të ngjashme dhe vazhdon ta bëjë këtë. Pjesëmarrja në këto operacione do të vazhdojë dhe në të njëjtën kohë, numri i pjesëmarrësve potencialë në këto operacione do të rritet. Bazuar në marrëveshjen e Shqipërisë me Bashkimin Europian lidhur me aktivitetet operative të *Frontex*-it, ky kuadër i mundëson Shqipërisë të marrë pjesë në operacione të përbashkëta dhe të koordinuara të udhëhequra nga *Frontex*. Ndër objektivat e tjerë, marrëveshja synon të përfshijë Shqipërinë jo vetëm si një vend përfitues, por edhe si një vend kontribues në përpjekjet rajonale për sigurinë. Ajo mbështet zhvillimin e operacioneve të përbashkëta me *Frontex* dhe shtetet anëtare të BE-së përmes një qasjeje të koordinuar dhe të harmo-nizuar, duke favorizuar shkëmbimin e praktikave më të mira dhe mundësuar përgjigje të shpejta ndaj zhvillimeve në kufijtë e

vendeve fqinje ose të BE-së. Pjesëmarrja në operacione të tilla lejohet vetëm kur ndiqen procedurat formale të kërkesës dhe miratimit të përcaktuara në marrëveshje. Operacionet e përbashkëta të *Frontex*-it të zhvilluara jashtë Shqipërisë, në vende të tjera të BE-së, kanë përfshirë pjesëmarrjen e punonjësve të Policisë Kufitare Shqiptare si vëzhgues. Në vitin 2025, punonjësit shqiptarë vazhdojnë të marrin pjesë në këto operacione. Si pjesë e bashkëpunimit me *Frontex*, është emëruar edhe një Oficer Lidhës Rajonal (i cili mbulon Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën).

Policia kufitare dhe e migracionit e Shqipërisë merr pjesë rregullisht në konferenca ndërkombëtare, grupe ekspertësh, seminare dhe trajnime të organizuara nga *Frontex*.

Policia Kufitare dhe e Migracionit ka rifituar kompetencat e saj hetimore, si pasojë, strukturat e policisë kufitare janë të angazhuara në hetimet e veprave penale që lidhen me krimet kufitare. Kjo ka përsheptuar zbulimin e aktiviteteve kriminale ndërkufitare.

Rritja e kapaciteteve të agjencive të përfshira në menaxhimin e kufirit konsiderohet shumë e rëndësishme. Prandaj, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet trajnimit të agjencive në fushat e tyre të përgjegjësisë. Trajnimi i trajnerëve, me qëllim forcimin e pavarësisë në fushën e forcimit policor, konsiderohet, gjithashtu, i rëndësishëm. Trajnimet do të vazhdojnë të ofrohen sipas planeve të miratuara të trajnimit dhe do të adresojë prioritetet e përcaktuara nga strukturat qendrore dhe lokale. Trajnimi i ofruar nga burimet lokale do të kombinohet me trajnimin e ofruar nga partnerët ndërkombëtarë në nivel dypalësh dhe shumëpalësh dhe në kuadër të projekteve ose iniciativave të ndryshme. Zbatimi i sistemeve të reja të shkëmbimit të informacionit dhe përfshirja e teknologjive dhe pajisjeve bashkëkohore për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufijve do të shoqërohet me trajnime të specializuara me qëllim përdorimin më efektiv të këtyre sistemeve dhe pajisjeve.

¹ Marrëveshja e Statusit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian “Për veprimet e kryera nga Agjencia Europiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Shqipërisë”, e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 16.5.2018, dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 6/2019, të shpallur me dekretin nr. 11082, datë 20.2.2019;

Marrëveshja e Punës “Për Bashkëpunimin Operacional ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së

Faqe | 1974

Shqipërisë dhe Agjencisë Europiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEx)”, nr. 1309/4, datë 17.3.2021;

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian “Për veprimtaritë operationale të kryera nga Agjencia Europiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Shqipërisë”, e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 13.9.2023, dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 2/2024, të shpallur me dekretin nr. 41, datë 6.2.2024.

**OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1**

Për të arritur përputhshmëri të plotë me standardet e Schengen-it duke harmonizuar kornizat legjislative, administrative dhe institucionale, si dhe duke përmirësuar infrastrukturën dhe pajisjet.

MASA 2.1.1	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Harmonizimi i kuadrit ligjor me <i>acquis</i> e Schengen-it në këtë fushë	Një kuadër ligjor plotësisht i përafëruar me <i>acquis</i> e Schengen-it

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
2.1.1.1	Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit Shtetëror”	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	Buxheti i shtetit	Aktet nënligjore të miratuara	
2.1.1.2	Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit 38/2025 Mbi përpunimin e informacionit të udhëtimit	Ministria e Punëve të Brendshme Institucione të tjera të përfshira	Gjashtë-mujori i parë 2026	Buxheti i shtetit	Nënlegjislacioni i miratuar	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 23.10.2025, “Për miratimin e rregullores për përpunimin e të dhënave të udhëtimit”, i miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 23.10.2025, Për përcaktimin e rregullave, masës, përjashtimeve nga sanksionet dhe procedurës për mbledhjen dhe administrimin e tarifës së transmetimit të informacionit të udhëtimit, i miratuar
2.1.1.3	Miratimi i procedurave standarde të punës për mbledhjen dhe përpunimin e Informacionit Paraprak të Pasagjerëve	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Financës (Doganat)	Tremujori i parë 2026	Buxheti i shtetit	Procedurat standarde të punës të miratuara	
2.1.1.4	Miratimi i VKM që rregullon krijimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Koordinimit (QKK) për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (Akt nënligjor në zbatim të ligjit 39/2025, “Për kontrollin e kufirit Shtetëror”, i parashikuar dhe në PPAP 2026 në katërmujorin e dytë)	Ministria e Punëve të Brendshme Institucione të tjera të përfshira	2026	Buxheti i shtetit	VKM për themelimin e QKKMIK-së miratuar	Në proces. Është hartuar drafti fillestar dhe jemi në fazën e marrjes së mendimeve nga institucionet e linjës



2.1.1.5	Miratimi i procedurave standarde të punës së Qendrës Kombëtare të Koordinimit Kufirit (Akt nënligjor në zbatim të ligjit 39/2025, “Për kontrollin e kufirit Shtetëror”)	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Financës Institucione të tjera të përfshira	2026	Buxheti i shtetit	Procedurat standarde të punës të miratuara	
2.1.1.6	Miratimi i VKM, “Për përcaktimin e rregullave të verifikimit kufitar që zbatohen për kategori të caktuara të personave dhe mjeteve “ (Akt nënligjor në zbatim të ligjit 39/2025, “Për kontrollin e kufirit Shtetëror” i parashikuar dhe në PPAP 2026 në katërmujorin e parë)	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	Buxheti i shtetit	Rregullorja e miratuar	
2.1.1.7	Miratimi i VKM, “Për përcaktimin e formatit e të specifikimeve teknike të vulave të verifikimit kufitar dhe të rregullave të vendosjes së tyre në dokumentet e udhëtimit gjatë hyrje-daljeve në kufirin shtetëror”. (Akt nënligjor në zbatim të ligjit 39/2025, “Për kontrollin e kufirit Shtetëror” i parashikuar dhe në PPAP 2026 në katërmujorin e parë)	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	Buxheti i shtetit	Rregullorja e miratuar	
2.1.1.8	Miratimi i procedurave standarde të punës për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit në det. (Akt nënligjor në zbatim të ligjit 39/2025, “Për kontrollin e kufirit Shtetëror”)	Ministria e Mbrojtjes Ministria e Punëve të Brendshme	2026	Buxheti i shtetit	Procedurat standarde të punës të miratuara	

MASA 2.1.2		REZULTATI I PËRGJITHSHËM				
Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore institucionale, ndërkohë që përmirësohet dhe modernizohet infrastruktura dhe pajisjet.		Efektivitet dhe efikasitet institucional të përmirësuara, infrastruktura dhe pajisjet e modernizuara.				
Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
2.1.2.1	Ngritja e infrastrukturës për funksionimin normal të QKK-së	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Financës Institucione të tjera	Në vazhdimësi	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Përqindja e përfundimit të instalimit të infrastrukturës (p.sh., ndërtesa, pajisje, sisteme IT) brenda afatit kohor të planifikuar	
2.1.2.2	Plotësimi me staf i Qendrës Kombëtare të Koordinimit me personelin e nevojshëm	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Financës	Në vazhdimësi	Buxheti i shtetit	Numri i vendeve të punës të krijuara në Qendrën	



		Institucione të tjera të përfshira			Kombëtare të Koordinimit që janë të mbushura me personel të kualifikuar	
2.1.2.3	Përmirësimi i infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar me qëllim krijimin e kushteve që lejojnë kalimin e lehtësuar dhe të sigurt.	Ministria e Financës (Doganat) Policia e Shtetit	2026 (PKK Qafëthanë) 2029	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Përqindja e objekteve të kalimit kufitar të përmirësuara dhe plotësisht funksionale - Pajtuashmëria me standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe lehtësimit të kufijve	Në PKK Qafëthanë – Kafasan “One stop one shop” Projekti 1 për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit Projekti 2 për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit – Komponenti 1 i BB-së - Përmirësimi i efikasitetit të kufirit dhe korridoreve. Komponenti përqendrohet në përmirësimin dhe përmirësimin e korridoreve dhe pikave të kalimit kufitar për të lehtësuar reformat tregtare në kufi dhe për të përmirësuar efikasitetin e transportit në PKK Hani i Hotit, PKK Blladë, PKK Kapshicë, PKK Kakavi
2.1.2.4	Pajisja e pikave të kalimit kufitar me mjete të reja (lexues të dokumenteve optike të udhëimit celularë, pajisje për akses dhe lexim të të dhënave të automjeteve, teleskop me fibra/video, matës të dendësisë së busterit, pagerë rrezatimi etj.)	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Përqindja e pikave të kalimit kufitar të pajisura me mjetet e reja sipas planit - Numri i mjeteve të reja të instaluar dhe plotësisht funksionale në pikat e kalimit kufitar	
2.1.2.5	Pajisja e shërbimeve të mbikëqyrjes kufitare me mjete të reja (kamera termike, dylbi dite dhe nate, kamera SMARTDEC etj.)	Policia e Shtetit	Vazhdimisht/proces	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Përqindja e njësisë të mbikëqyrjes kufitare të pajisura me mjetet e reja sipas planit - Numri i mjeteve të reja të mbikëqyrjes të vendosura dhe plotësisht funksionale në operacionet e mbikëqyrjes kufitare	



2.1.2.6	Instalimi i kamerave të mbikëqyrjes dhe lexuesve të targave në pikat e kalimit kufitar	Ministria e Financave/Dogana Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Brenda vitit 2026 për fazën e tretë	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i pikave të kalimit kufitar të pajisura me kamera mbikëqyrjeje dhe lexues targash plotësisht funksionale	Është instaluar në dogana Sistemi i kamerave në pikat kufitare Morinë, Kapshticë, Kakavijë, Qafëthanë, Hani Hotit dhe është në proces instalimi në pikat e tjera kufitare si Murriqan, Tri Urat, Qafëbotë, Bllatë, Goricë.
2.1.2.7	Instalimi i radarëve shtesë të projektuar për të mbuluar zonat bregdetare të vdekura	Ministria e Mbrojtjes Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Financave	Në vazhdimësi	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i radarëve shtesë të instaluar dhe plotësisht funksionale	

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2

Forcimi i koordinimit ndërinstitucional dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar

MASA 2.2.1	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Rinovimi dhe hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë vendës dhe ndërkombëtarë, dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje.	Bashkëpunim i përmirësuar institucional në nivel lokal, ndërkombëtar dhe përtej kufijve.

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
2.2.1.1	Rishikimi i rregullores për bashkëpunimin midis Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera që merren me kufijtë në përputhje me ndryshimet e reja ligjore.	Policia e Shtetit Doganat Institucione të tjera të përfshira	2026–2028	Buxheti i shtetit	Rregullorja e rishikuar	
2.2.1.2	Forcimi i bashkëpunimit midis Departamentit të Kufirit dhe Migracionit dhe Rojës Bregdetare Shqiptare (kryesisht duke u përqendruar në hartimin dhe zbatimin e një programi të përbashkët trajnimi special, organizimin e patrullimeve të përbashkëta etj.)	Policia e Shtetit Rojë Bregdetare	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Një kuadër bashkëpunimi i miratuar VKM 439 datë 13.5.2011, “Për miratimin e dokumentit “Politikat dhe procedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), të ndryshuar	
2.2.1.3	Forcimi i bashkëpunimit operacional për mbikëqyrjen e përbashkët të	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i patrullave të përbashkëta të kryera brenda një afati kohor të caktuar	



	kufirit duke rritur numrin e patrullave të përbashkëta me Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.					
2.2.1.4	Miratimi i Rregullores për qarkullimin lokal kufitar	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	Buxheti i shtetit	Rregullorja e miratuar	
2.2.1.5	Përfundimi i marrëveshjes për ndryshimin e statusit të të gjitha pikave të kalimit kufitar me Maqedoninë e Veriut në pika të përbashkëta kalimi kufitar.	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	Buxheti i shtetit	Marrëveshja e nënshkruar	
2.2.1.6	Negocimi dhe përfundimi i marrëveshjeve për rritjen e numrit të pikave të përbashkëta të kalimit kufitar me Republikën e Malit të Zi.	Ministria e Punëve të Brendshme	Vazhdimësi/proces	Buxheti i shtetit	Numri i marrëveshjeve të reja të nënshkruara për të krijuar pika të përbashkëta kalimi kufitar	
2.2.1.7	Miratimi i Rregullores mbi rregullat që rregullojnë mbikëqyrjen e kufijve detarë në kuadër të bashkëpunimit të koordinuar operativ midis institucioneve kombëtare dhe Agjencisë Europiane dhe Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEx).	Ministria e Punëve të Brendshme Dogana Institucione të tjera të përfshira	Brenda vitit 2026	Buxheti i shtetit	Rregullorja e miratuar	Është ngritur grupi i punës dhe është hartuar draft rregullorja për sistemin e mbikëqyrjes së kufirit shtetëror nga ana e Kufirit por do të konsultohet me institucionet e tjera, Dogana, AKU, Roja Bregdetare.
2.2.1.8	Bashkëpunimi me <i>Frontex</i> përmes operacionit të përbashkët JO Albania Sea 2026	Policia e Shtetit	2026	Buxheti i shtetit Numri i operacioneve të përbashkëta të kryera	Numri i operacioneve të përbashkëta të kryera	
2.2.1.9	Vendosja e bashkëpunimit operativ midis Qendrës Kombëtare të Koordinimit (QKK-së) për Tiranën dhe <i>Schengen-in</i> dhe QKK-ve të vendeve rajonale.	Ministria e Punëve të Brendshme	Aktivitet afatgjatë	Buxheti i shtetit	Numri i marrëveshjeve zyrtare të bashkëpunimit operacional të nënshkruara midis QKK-së së Tiranës, <i>Schengen-it</i> dhe QKK-ve të vendeve rajonale	



OBJEKTIVI SPECIFIK 2.3

Përmirësimi i kontrollit kufitar duke rritur kapacitetet institucionale të strukturave të sapokrijuara dhe ekzistuese të menaxhimit kufitar.

MASA 2.3.1	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Trajnime të dedikuara dhe aktivitete të tjera për ndërtimin e kapaciteteve për strukturat e menaxhimit të kufirit.	Aftësi dhe performancë e përmirësuar e strukturave të menaxhimit të kufirit

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
2.3.1.1	Trajnime mbi analizën e riskut në përputhje me modelin CIRAM 2.0 për Departamenti I Kufirit Dhe Migracionit dhe agjencitë e tjera të përfshira	Policia e Shtetit Doganat Agjenci të tjera	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar të departamentit të kufirit dhe migracionit dhe stafit tjetër të agjencisë	
2.3.1.2	Trajnime të trajnerëve në zbatimin e CIRAM (Modeli i Përbashkët i Analizës së Integruar të Rrezikut)- Trajnime të stafit të strukturave lokale në zbatimin e CIRAM	Policia e Shtetit Doganat Agjenci të tjera të përfshira	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i ToT-së së kryer - Numri i stafit të trajnuar	
2.3.1.3	Trajnime të stafit të Policisë Kufitare të Rinasit në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit paraprak të pasagjerëve	Policia e Shtetit Doganat	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	
2.3.1.4	Studimi i nevojave dhe përgatitja, miratimi dhe zbatimi i planeve vjetore të trajnimit të përbashkët për stafin e agjencive të zbatimit të ligjit që veprojnë në kufi.	Policia e Shtetit Doganat Agjenci të tjera të përfshira	Çdo vit	Buxheti i shtetit	Planet vjetore të trajnimit të përbashkët të miratuara	
2.3.1.5	Ofrimi i trajnimit për rojet kufitare të pikave të kalimit kufitar mbi përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të reja me karakteristika të përditësuar.	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	
2.3.1.6	Forcimi i kapaciteteve profesionale të strukturave të ngritura të hetimit ndërkufitar në Policinë Kufitare, duke u përqendruar në trajnimin e burimeve njerëzore, si dhe në rritjen e kapaciteteve logjistike.	Policia e Shtetit Doganat	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	
2.3.1.7	Trajnime të avancuara fokusuar në identifikimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	
2.3.1.8	Trajnime të avancuara për punonjësit e policisë kufitare në kontrollin e vijës së dytë, duke u përqendruar në automjetet motorike të vjedhura ose të ndryshuara.	Policia e Shtetit Doganat Shërbimet e Transportit Rrugor	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	



2.3.1.9	Trajnime të avancuara për punonjësit e policisë kufitare në kontrollet e vijës së dytë, duke u përqendruar në ndarjet e fshehura të automjeteve	Policia e Shtetit Dogana	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	
2.3.1.10	Trajnime praktike mbi “Kërkim dhe Shpëtim në Det për ekuipazhin e anijeve/varkave”	Policia e Shtetit Roja Bregdetare	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	
2.3.1.11	Ofrimi i trajnimit për stafin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar në kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore.	Policia e Shtetit Shërbimet doganore	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	
2.3.1.12	Zbatimi i procedurave rigorozë në përputhje me kuadrin ligjor, promovimi i ruajtjes së personelit dhe ulja e shkallës së rotacionit brenda forcës së Policisë Kufitare	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	-Shkalla e ruajtjes së stafit, përqindja e personelit të Policisë Kufitare që ruhet gjatë një periudhe të caktuar. -Shkalla e rotacionit, përqindja e personelit që largohet nga Policia Kufitare çdo vit	

MASA 2.3.2	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Zvogëlimi i rasteve të refuzimit të hyrjes në zonën <i>Schengen</i>	Ulje e refuzimeve të hyrjes në Zonën <i>Schengen</i>

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
2.3.2.1	Miratimi i Draft Rregullores dhe Sistemit të Mbikëqyrës së Kufirit”, në zbatim të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”.	Policia e Shtetit	Tremujori i parë 2026	Buxheti i shtetit	Rregullorja e miratuar	Në proces hartimi
2.3.2.2	Forcimi i zbatimit të Urdhrit të Ministrat të Brendshëm nr. 641, datë 20.12.2019, “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i rasteve të parandaluara	
2.3.2.3	Miratimi i Procedurave Standarde e Punës, “Për verifikimin e trafikut tokësor, trafikut ajror, detar e liqenor në Kufi”.	Policia e Shtetit	2026	Buxheti i shtetit	Procedura Standarde e Punës miratuar	
2.3.2.4	Miratimi i Procedurave Standarde e Punës “Regjistrimit në sistemin TMS, të verifikimit që kryhet për kontrollin e hyrje-daljeve”.	Policia e Shtetit	2026	Buxheti i shtetit	Procedurat Standarde e Punës miratuar	
2.3.2.5	Rritja e bashkëpunimit me strukturat homologe të kontrollit në kufi të vendeve të Bashkimit Europian nëpërmjet rrjeteve të Oficerëve	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera	



	Ndërlidhës, Europol, Frontex dhe Njësitë e Informacionit të Pasagjerit të BE-së për rritjen e numrit të informacioneve rreth shtetasve shqiptarë të dënuar dhe të dëbuar nga vendet e BE-së.					
2.3.2.6	Rritja e informacioneve të analizave të riskut për shtetas shqiptarë të prapësuar nga vendet e BE-së në mënyrë që të rritet kontrolli në dalje nga Shqipëria.	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Rritja e informacioneve të analizave të riskut	
2.3.2.7	Realizimin e ndërlidhjes së sistemeve të kontrollit kufitar duke rritur efikasitetin e sistemit të hyrje-daljeve TMS dhe sistemeve të shenjëstrimit të udhëtarëve të Sektorit të Intelgjencës së Udhëtimit të Republikës së Shqipërisë	Policia e Shtetit	2026–2027	Buxheti i shtetit	Realizimi i ndërlidhjes së sistemeve të kontrollit kufitar	
2.3.2.8	Forcimi i kontrollit në zbatimin e ligjit për menaxhimin e kufijve dhe sjellja e policëve dhe doganierëve të përfshirë në kontrollin kufitar dhe doganor të kryhet në përputhje aktet ligjore dhe nënligjore dhe me standardet e BE-së	Policia e Shtetit Dogana	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri rasteve të identifikuar në shkelje të procedurave ligjore	
2.3.2.9	Reagimi në mënyrë më efektive me vendosjen e burimeve të disponueshme, bazuar në analizën e rrezikut të kryer dhe kërcënimit që mund të ndikojë në sigurinë kufitare, në përputhje me modelin e CIRAM të BE-së, reduktimin e vulnerabilitetit (ndjeshmërisë) në kufi.	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i burimeve të shtuara	

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.4

Përmirësimi i nivelit të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave themelore nga shërbimet e kontrollit kufitar

MASA 2.4.1	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Trajnime të dedikuara dhe aktivitete të tjera për ndërtimin e kapaciteteve për strukturat e menaxhimit të kufirit.	Kapacitet i shtuar i personelit të menaxhimit kufitar për të zbatuar parimet e të drejtave të njeriut në operacionet e tyre të përditshme.

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
2.4.1.1.	Trajnime të vazhdueshme mbi trajtimin e shtetasve të huaj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.	Policia e Shtetit Dogana Institucione të tjera të përfshira	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	
2.4.1.2	Draftudhëzim për informacionin që u jepet personave të cilët janë subjekt i verifikimeve në	Policia e Shtetit Dogana Institucione të tjera të përfshira	2026	Buxheti i shtetit	Miratimi i udhëzimit	



	vijën e dytë në pikat e kalimit					
2.4.1.3	Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm për rojet kufitare në mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale	Policia e Shtetit Dogana Institucione të tjera të përfshira	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të kryera - Numri i stafit të trajnuar	
2.4.1.4	Draftudhëzim i Përbashkët i Ministrat të Punëve të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e të dhënave, të grumbulluara në zbatim të ligjit për kontrollin e kufirit shtetëror”.	Ministria e Punëve të Brendshme Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	2026	Buxheti i shtetit	Udhëzim i përbashkët i nënshkruar	
2.4.1.5	Shpërndarja e fletëpalosjeve informuese në PKK (Pika e Kalimit Kufitar) mbi të drejtat e të huajve me qëndrim të rregullt në Shqipëri	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Fletëpalosje të prodhuara dhe të shpërndara në të gjitha pikat e kalimit kufitar	

KAPITULLI 3

SITUATA DHE ZHVILLIMI NË KUFIJTË E BRENDSSHËM (TË ARDHSHËM)

Duke pasur parasysh vendndodhjen e Shqipërisë në kufijtë e jashtëm të BE-së dhe anëtarësimin e pritur të vendeve fqinje në BE, futja dhe zbatimi i qëndrueshëm i menaxhimit të integruar të kufijve, në përputhje me standardet rajonale dhe të BE-së, është me rëndësi kritike për Shqipërinë.

Gjeografikisht, Shqipëria ndodhet midis Republikës së Greqisë dhe Italisë, përtej Detit Adriatik, të dyja shtete anëtare të BE-së, vendeve që kanë marrë statusin e vendit kandidat për në BE (Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut), dhe Kosova, një vend që ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në.

Autoritetet shtetërore shqiptare, të cilat janë nën detyrimin për të miratuar standardet dhe praktikatat më të mira të Bashkimit Europian në fushën e sigurisë kufitare, janë shumë të kujdesshme ndaj përgjegjësisë së tyre dhe të përgatitura të marrin përsipër përgjegjësinë e kontrollit të kufijve të jashtëm të Bashkimit Europian.

Shqipëria ka një kufi të gjatë tokësor me Greqinë, 349 km të gjatë, nga të cilët 247 km formojnë kufirin tokësor, 78 km kufirin detar, 7 km kufirin liqenor, 9 km kufirin lumor dhe 8 km kufirin përroi. Kufiri shtetëror i detit territorial me zonën fqinje (det ndërkombëtar) është 262 km i gjatë. Me dy vendet e *Schengen-it*, Greqinë dhe Italinë, Shqipëria ka:

- 9 PKK (Pika e Kalimit Kufitar) me Greqinë (3 prej të cilave janë PKK detare);
- 5 PKK (Pika e Kalimit Kufitar) me Italinë (5 PKK detare).

Përfundimi i marrëveshjeve për krijimin e Qendrave për Bashkëpunim Policor dhe Doganor me Greqinë, si dhe duke përfunduar marrëveshjen për krijimin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe kryerjen e kontroleve të përbashkëta kufitare dhe doganore me Greqinë do të ishte një masë e përshtatshme që çon drejt përmbushjes së kërkesave të *Schengen-it* në këtë fushë.

Gjithashtu, do të bëhen përpjekje për të arritur marrëveshje dypalëshe për të përdorur instrumente, të tilla si ndjekja e menjëhershme ose patrullimet e përbashkëta, drejt zhvillimit të një koncepti gjithëpërfshirës të bashkëpunimit ndërkufitar që kombinon të gjitha instrumentet e disponueshme.

Në të gjitha këto përpjekje, është e rëndësishme që strukturat dhe procedurat të sigurojnë shkëmbimin në kohë të informacionit dhe operacione të përbashkëta efektive, duke adresuar krimin ndërkufitar, migracionin e parregullt dhe kërcënimet ndaj sigurisë publike.



Sa i përket *acquis* të *Schengen*-it në këtë fushë, shumë dispozita për heqjen e kontrolleve mbi personat në kufijtë e brendshëm, të cilat do të merren në bazë të vlerësimit përkatës të *Schengen*-it për gatishmërinë e Shqipërisë, do të harmonizohen me anëtarësimin në zonën *Schengen*.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1

Zhvillimi i kornizave ligjore dhe operacionale që sigurojnë pajtueshmëri në mungesë të kontrolleve të kufijve të brendshëm, duke rritur njëkohësisht bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh me shtetet fqinje të *Schengen*-it.

MASA 3.1

Forcimi i kuadrit të bashkëpunimit me shtetet fqinje të *Schengen*-it

REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Koordinimi dhe ndërveprimi ndërkufitar me shtetet fqinje të *Schengen*-it i përmirësuar

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
3.1.1	Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje të <i>Schengen</i> -it	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i takimeve, trajnimeve ose grupeve të punës ndërkufitare të mbajtura	
3.1.2	Fillimi i negociatave për përfundimin e marrëveshjes për krijimin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore me Greqinë	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit	2028	Buxheti i shtetit	Marrëveshja përfunduar dhe nënshkruar	
3.1.3	Rinovimi ose hartimi i marrëveshjeve dhe protokolleve të reja mbi patrullimet e përbashkëta kufitare me policinë kufitare, që mbulojnë kufijtë e tokësorë dhe detarë.	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit	2026–2027	Buxheti i shtetit	Numri i marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara ose të përditësuara	Vazhdojnë patrullimet sipas protokolleve e marrëveshjeve të përbashkëta me “Guardia financa” të Italisë, me Malin e Zi në Shkodër dhe Maqedoninë në Pogradec.
3.1.4	Kryerja e patrullave, kontrolleve dhe operacioneve të përbashkëta me Greqinë	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i patrullave dhe operacioneve të përbashkëta të kryera	
3.1.5	Kryerja e patrullave, kontrolleve dhe operacioneve në detet Adriatik dhe Jon së bashku me Guardia di Finanza/Itali dhe Rojën Bregdetare Greke	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i patrullave dhe operacioneve të përbashkëta të kryera	

KAPITULLI 4 POLITIKA E KTHIMIT

Shqipëria është kryesisht një vend tranzit për shumicën e emigrantëve të paligjshëm që udhëtojnë drejt vendeve të tjera të destinacionit përmes të ashtuquajturës rruga e Ballkanit Perëndimor. Duke pasur parasysh se, në pjesën e saj më të madhe, vija kufitare jugore dhe juglindore shtrihet përgjatë kufijve malorë dhe nëpër zona më pak të populluara, policia kufitare duhet të jetë e pajisur siç duhet për të luftuar dhe zbuluar këtë migracion të parregullt kufitar. Shqipëria është e përfshirë në mënyrë aktive

në zbatimin e Planit të Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor, të paraqitur nga Komisioni European në dhjetor 2022.

Nga ana strategjike, Shqipëria ka miratuar Strategjinë e re Kombëtare për Migracionin 2024–2030 dhe planin e saj të veprimit. Strategjia pasqyron prioritetet e qeverisë shqiptare për menaxhimin efektiv të migracionit dhe për të adresuar sfidat që lidhen me menaxhimin e flukseve migratore. Ajo, gjithashtu, synon të gjejë zgjidhje efektive për promovimin e të drejtave të migrantëve, si dhe integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare. Strategjia i përgjigjet detyrimeve, brenda kuadrit të procesit



kombëtar të integritit në BE, si dhe detyrimeve ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara në këtë fushë. Objektivat specifike dhe masat prioritare janë në përputhje me pesë shtyllat e Planit të Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor.

Shqipëria po ndryshon vazhdimisht kuadrin e saj ligjor për t'u përafuar me *acquis* të BE-së në këtë fushë. Ndryshimet e fundit në ligjin për të huajt synojnë të përafrohen me disa direktiva të BE-së në lidhje me: kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime punësimi me kualifikim të lartë; Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime kërkimore, studimi, trajnimi, shërbimi vullnetar, pjesëmarrjeje në skemat e shkëmbimit të nxënësve ose në projekte arsimore, si dhe për programet “au pair” (arsyet ligjore për pajisjen me leje qëndrimi të përkohshme), mbi një procedurë të vetme aplikimi për një leje të vetme për shtetasit e vendeve të treta për të qëndruar dhe punuar në territor etj. Megjithatë, korniza ligjore për migracionin është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së.

Shqipëria duhet të zhvillojë, miratojë, zbatojë, testojë dhe të sigurojë financim të mjaftueshëm për një Plan Kontigjence, me qëllim reagimin ndaj flukseve të mundshme masive të migrantëve dhe azil kërkuesve. Plani duhet të përfshijë mekanizma të qartë aktivizimi, ndarje buxhetore dhe modalitete operacionale. Bashkëpunimi me Agjencinë e Bashkimit Europian për Azilin (EUAA) në forcimin e sistemit kombëtar të azilit dhe pritjes mbetet i qëndrueshëm dhe progresiv. Megjithatë, Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin efektiv të Ligjit për Azilin, si edhe të vijojë më tej përafrimin e procedurave dhe praktikave me *acquis* të BE-së. Kjo përfshin zhvillimin e kapaciteteve të mëtejshme administrative dhe përmirësimin e koordinimit institucional.

Për më tepër, Shqipëria duhet të garantojë kapacitete të mjaftueshme pritëse dhe të zbatojë procedurat e riatdhesimit në përputhje të plotë me Ligjin për të Huajt dhe në harmoni me *acquis* të BE-së. Në fushën e migracionit të parregullt, politika e kthimit e Shqipërisë mbështet kthimin vullnetar, në përputhje me Direktivën e Kthimit, për individët që u nënshtrohen masave ligjore për largimin nga territori. Korniza ligjore që rregullon kthimin, riatdhesimin, largimin/deportimin, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të migrantëve,

mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe mekanizmat e ankimit, përshkruhet në Ligjin për të Huajt dhe Ligjin për Azilin.

Shqipëria përballet me vështirësi në lidhjen e marrëveshjeve të ripranimit me vendet e origjinës. Kthimi i migrantëve duhet të bëhet vetëm në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedural kombëtar dhe ndërkombëtar. Fillimi dhe lidhja e marrëveshjeve për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta/personave pa shtetësi me vendet e origjinës dhe të tranzitit është dhe mbetet një politikë institucionale konstante.

Do të vihet theksi mbi vazhdimin dhe forcimin e bashkëpunimit për riatdhesimet, të kryera drejtpërdrejt dhe/ose përmes kanaleve diplomatike me autoritetet e vendeve të origjinës, në mënyrë që të identifikohen shtetasit e tyre subjekt i riatdhesimit dhe të sigurohen dokumentet e nevojshme të udhëtimit.

Shqipëria ka një bashkëpunim shumë të mirë me Shtetet Anëtare dhe Frontex-in për operacionet e ripranimit dhe kthimit. Shqipëria mund të marrë statusin e vëzhguesit në Grupin e Punës së Vendit Frontex për Kthimin dhe Ripranimin, i cili konsiston në takime në nivel ekspertësh që zhvillohen rregullisht ose *ad hoc* për të diskutuar bashkëpunimin për ripranimin me vende të treta specifike. Kjo do të ishte në interesin si të BE-së ashtu edhe të Shqipërisë dhe në përputhje me Planin e Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor për migracionin, për të përmirësuar kthimin dhe ripranimin me vendet e origjinës.

Gjatë tre vjetëve të fundit, numri i azil kërkuesve në Shqipëri ka pasur ndryshime. Tendenca nuk ka qenë e qëndrueshme; pas një rritjeje në vitin 2023 dhe një rënie të ndjeshme në vitin 2024, në vitin 2025 vihet re një rritje e moderuar, megjithatë ende nën nivelet maksimale të regjistruara në vitin 2023. Fakti që Shqipëria kufizohet me shtete anëtare të BE-së, siç janë Greqia dhe Italia, është një motiv shtesë për azilkërkuesit që të mbërrijnë në Shqipëri. Infrastruktura aktuale në vend nuk mund të përballojë flukse të mëdha hyrëse të emigrantëve dhe azilkërkuesve.

Bashkëpunimi me Agjencinë e Bashkimit Europian për Azilin për forcimin e sistemit kombëtar të azilit dhe pritjes është i mirë. Megjithatë, Shqipëria duhet të bëjë një zbatim cilësor të ligjit për azilin dhe të zhvillojë kapacitetet e nevojshme shtesë administrative, duke siguruar njëkohësisht përafrim të mëtejshëm me *acquis*.



OBJEKTIVI SPECIFIK 4.1

Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit të sistemit të kthimit dhe ripranimit për shtetasit e huaj

MASA 4.1.1	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Harmonizimi i kuadrit ligjor me <i>acquis</i> të BE-së dhe sigurimi i një kuadri të konsoliduar operativ	Një kuadër ligjor dhe institucional plotësisht i harmonizuar në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
4.1.1.1	Miratimi i ndryshimit në ligjin e azilit për ta sjellë atë plotësisht në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së.	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	Buxheti i shtetit	Ndryshimet në ligj miratuar	Është ngritur një grup pune me qëllim hartimin e amendamentit në ligjin për azilin.
4.1.1.2	Miratimi i akteve nënligjore në përputhje me ndryshimet e pritur në ligjin për Azilin	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	Buxheti i shtetit	Aktet nënligjore të miratuara	
4.1.1.3	Ndjekja dhe zbatimi i Planit të kontigjencës për një numër të konsiderueshëm mbërritjesh të mundshme të migrantëve dhe azilkërkuessve	Ministria e Punëve të Brendshme	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Plani i kontigjencës i miratuar	Plani i Kontigjencës është miratuar me VKM-në nr. 788, datë 24.12.2025
4.1.1.4	Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të ripranimit me vendet e treta të origjinës	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e shtetit Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i marrëveshjeve të ripranimit të lidhura dhe të miratuara	Lidhja e marrëveshjeve të ripranimit me vendet e treta të origjinës është një proces i vazhdueshëm.
4.1.1.5	Bashkëpunimi i forcuar për riatdhesimet, të kryera drejtpërdrejt dhe/ose përmes kanaleve diplomatike	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i takimeve formale ose shkëmbimeve të komunikimit me autoritetet konsullore ose diplomatike të vendeve të origjinës. Rritja e numrit të rasteve të suksesshme të riatdhesimeve/kthimeve të lehtësuara përmes kanaleve bilaterale ose diplomatike.	Bashkëpunimi i forcuar për riatdhesimet, të kryera drejtpërdrejt dhe/ose përmes kanaleve diplomatike

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.2

Rritja e kapaciteteve operacional dhe bashkëpunimin ndërinstucional, duke përfunduar njëkohësisht masat mbrojtëse për të siguruar mbrojtjen e të drejtave themelore.

MASA 4.2.1	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe mekanizmave koordinues për kthimin e migrantëve të parregullt, duke theksuar mbrojtjen e të drejtave themelore të tyre.	Një sistem operacional kthimi që siguron procedura kthimi në kohë dhe të koordinuara për migrantët e parregullt, duke respektuar dhe mbrojtur plotësisht të drejtat e tyre themelore.

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
4.2.1.1	Forcimi i kapaciteteve institucionale për realizimin e kthimeve, mundësimi i burimeve njerëzore/logjistike dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara për udhëheqësit e shoqëruesve dhe shoqëruesit.	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të ofruara - Numri i stafit të trajnuar	



4.2.1.2	Trajnim i vazhdueshëm për rojet kufitare mbi procedurat standarde për përzgjedhjen dhe referimin e të huajve të parregullt.	Policia e Shtetit/Partnerët	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të ofruara - Numri i stafit të trajnuar	
4.2.1.3	Trajnim për rojet kufitare mbi procedurat e reja për përzgjedhjen e shtetasve të huaj që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri.	Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Shtetit/Partnerët	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të ofruara - Numri i stafit të trajnuar	
4.2.1.4	Trajnime të përbashkëta të autoriteteve kombëtare që mbulojnë çështjet e migracionit	Të gjitha institucionet e angazhuara	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të ofruara - Numri i stafit të trajnuar	
4.2.1.5	Trajnim i vazhdueshëm për trajtimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin për të huajt.	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të ofruara - Numri i stafit të trajnuar	
4.2.1.6	Trajnime për oficerët e Policisë Kufitare dhe të Migracionit për të identifikuar refugjatët dhe migrantët me nevoja specifike.	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të ofruara - Numri i stafit të trajnuar	
4.2.1.7	Përmirësimi i kushteve të trajtimit dhe akomodimit të migrantëve në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç	Policia e Shtetit/Partnerët	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Kushtet e akomodimit u përmirësuan	
4.2.1.8	Marrja e masave për të siguruar kapacitete të përshtatshme pritjeje dhe për të krijuar alternativa ndaj akomodimit për fëmijët, gratë në rrezik dhe njerëzit me gjendje të rëndë mjekësore.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit Partnerët	Gjashtë-mujori i parë 2026	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Kapacitetet e pritjes u përmirësuan	
4.2.1.9	Vendosja e informacionit/fletëpalosjeve në pikat e kalimit kufitar në gjuhët kryesore të migrantëve, mbi rregullat e hyrjes, qëndrimit, daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, kthimit vullnetar.	Policia e Shtetit/Partnerët	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Materiale informuese, fletëpalosje të vëna në dispozicion në PKK	

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.3

Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe gatishmëri operationale për zbatimin efektiv të procedurave të kthimit

MASA 4.3.1**REZULTATI I PËRGJITHSHËM**

Rritja e kapaciteteve dhe forcimi i bashkëpunimit dhe integrimi në rrjetet europiane të bashkëpunimit

Efektiviteti dhe ndërveprimi i përmirësuar operativ dhe integrimi aktiv në rrjetet europiane të bashkëpunimit.

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
4.3.1.1	Pjesëmarrja si vëzhgues në fluturime të përbashkëta të riadhesimit drejt vendeve të origjinës, të organizuara nga shtetet anëtare të BE-së dhe të koordinuara nga <i>Frontex</i> .	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	- Numri i fluturimeve të përbashkëta të riadhesimit të vëzhguara - Numri i rekomandimeve të lëshuara bazuar në vëzhgime	
4.3.1.2	Trajnime të specializuara për udhëheqësit e eskortave, të ofruara nga <i>Frontex</i>	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	- Numri i trajnimeve të ofruara - Numri i punonjësve të trajnuar	
4.3.1.3	Forcimi i bashkëpunimit me Rrjetin European të Migracionit (EMN).	Ministria e Punëve të Brendshme	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Bashkëpunimi me Rrjetin European të Migracionit (EMN) është forcuar	Shqipëria ka nënshkruar marrëveshjen administrative me Komisionin European (DG HOME) për përfshirjen e saj në EMN në qershor 2025



4.3.1.4	Marrja e statusit të vëzhguesit në grupet e ekspertëve të punës pranë Agjencisë së Bashkimit Europian për Azilin (EUAA)	Ministria e Punëve të Brendshme	Dhjetor 2026	Buxheti i shtetit	Dhënia e statusit të vëzhguesit	Kërkesa për integrim të përsheptuar është dorëzuar tashmë.
---------	---	---------------------------------	--------------	-------------------	---------------------------------	--

KAPITULLI 5 SISTEME INFORMACIONI NË SHKALLË TË GJERË

Shkëmbimi i informacionit midis autoriteteve të ndryshme, në vend dhe jashtë vendit, është një aspekt shumë i rëndësishëm për një zbatim efektiv të ligjit, në këtë rast në funksionimin e Sistemit të Informacionit *Schengen*. Për këtë qëllim, sistemi i IT-së i mbështetur nga baza të dhënash të sigurta është mjeti më i rëndësishëm për të siguruar funksionimin e të gjithë sistemit *Schengen*.

Në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, Shqipëria ka krijuar infrastrukturën e saj të IT-së dhe operon baza të dhënash të ndryshme të cilat janë për përdorim operacional nga strukturat kufitare dhe të menaxhimit. Sistemi më i rëndësishëm në përdorim nga Policia e Shtetit Shqiptar dhe Departamenti i Kufirit dhe Migracionit është sistemi TIMS.

Sistemi TIMS është një instrument i rëndësishëm, i cili ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e punës së Policisë Kufitare në kontrollin e lëvizjes së shtetasve, automjeteve dhe mallrave. Ai lejon dërgimin e njoftimeve nga struktura të ndryshme të Policisë së Shtetit dhe në emër të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit. Ndërfaqja me sistemin Interpol ASF2 vazhdon të jetë një mjet i pazëvendësueshëm në identifikimin e personave, dokumenteve të udhëtimit dhe automjeteve të kërkuara ose shtetasve me precedentë kriminalë. Megjithatë, janë hasur vështirësi në lidhje me instalimin dhe përdorimin e TIMS në një numër stacionesh të largëta të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

Edhe pse TIMS dhe sistemet e tjera të përdorura nga agjencitë e zbatimit të ligjit janë mjete efektive, ato ende kërkojnë përmirësime të rregullta për të adresuar sfidat në zhvillim të sigurisë dhe, më e rëndësishmja, për t'u përputhur me standardet e sistemit *Schengen* dhe për të siguruar ndërveprimin me sisteme të tilla.

Shqipëria ka shprehur vazhdimisht interes për të pasur akses në Eurodac. Megjithatë, Rregullorja Eurodac nuk parashikon pjesëmarrjen ose

shkëmbimin e përgjithshëm të informacionit me vendet e treta, siç janë vendet kandidatë.

Lidhur me kufijtë detarë, instalimi i sistemit të komunikimit TETRA për zonën detare u bë i mundur nëpërmjet financimit të Bashkimit Europian. Ky sistem po funksionon, por çështjet që lidhen me mirëmbajtjen dhe përmirësimin e tij duhet të zgjidhen. Në pjesën më të madhe të juridiksionit të saj, Policisë Kufitare dhe të Migracionit i mungon një sistem komunikimi radio efektiv dhe i sigurt.

Sistemi elektronik (FER), i projektuar për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave të identitetit dhe biometrike për të huajt me qëndrim të parregullt, i cili filloi të zbatohet në gusht 2014, përfaqëson një bazë të fuqishme informacioni që lejon marrjen dhe shkëmbimin në kohë reale të informacionit operativ në kontekstin e adresimit të çështjeve të migracionit të parregullt dhe kthimeve.

Sistemi *Blue Box*, i projektuar për t'u përdorur në bord të anijeve, po përballët me vështirësi. Agjencitë po bëjnë përpjekje për të krijuar bazën e të dhënave të anijeve."

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Detare dhe strukturat e zbatimit të ligjit detar, ka zbatuar sistemin e "Bazës së të Dhënave të Trafikut Detar". Ky sistem synon kontrollin e kufijve detarë, menaxhimin më të mirë të të dhënave mbi të gjitha anijet tregtare dhe jotregtare që gjenden ose lundrojnë në ujërat dhe portet shqiptare, dhe mundëson rritjen e sigurisë dhe ruajtjen e ujërave shqiptare, përshtatjen dhe rritjen e sektorit detar shqiptar përmes përdorimit të të dhënave reale, statistikave dhe parashikimeve.

Është, gjithashtu, e nevojshme të krijohet një Sistem Mbikëqyrjeje nga Policia e Shtetit, për mbikëqyrjen e zonës detare, ku ky sistem do të shërbejë si një burim shtesë informacioni për IMOC, duke siguruar transmetimin e pamjes së përgjithshme të zonës detare.

Nisur nga situata aktuale dhe kërkesat në rritje për t'u përfaqësuar me standardet e *Schengen-it*/BE-së për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufijve, është e nevojshme të përmirësohet infrastruktura e stacioneve të PKK, si dhe sistemet e përdorura për



monitorimin e kufijve blu dhe të gjelbër me anë të pajisjeve moderne teknologjike.

Zhvillimi i sistemeve të ndryshme të informacionit të BE-së, duke përfshirë sistemin europian të hyrjes/daljes, sistemin e informacionit *Schengen* dhe inovacione të tjera të lidhura me IT-në, do të përbëjë një bazë për planifikimin dhe përmirësimin e kontroleve kufitare.

Shkëmbimi i informacionit në kohë reale me shtetet anëtare të BE-së aktualisht nuk është i mundur, pasi Shqipëria, duke qenë një vend i tretë dhe jo anëtar i BE-së, nuk ka qasje në bazat e të dhënave të BE-së. Një detyrim dhe objektiv kryesor mbetet përmirësimi dhe sigurimi i sistemeve të reja të kontrollit dhe shkëmbimit të informacionit.

Kjo përfshin përmirësimin e sistemit ekzistues TIMS, zbatimin e sistemeve PISCES, përmirësimin e sistemit të radiokomunikimit dhe më shumë, duke pasur parasysh se pajisjet aktuale nuk mbështesin në mënyrë të mjaftueshme përmbushjen e detyrave operacionale as në aspektin e cilësisë dhe as të kapacitetit.

Në korrik 2025, u miratua ligji nr. 38/2025, “Për Përpunimin e Informacionit të Udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, i cili është pjesërisht i harmonizuar me: Direktivat e Këshillit 2004/82/EC, datë 29 prill 2004, për detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat e pasagjerëve, dhe Direktivën (BE) 2016/681 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 prill 2016, për përdorimin e të dhënave të Pasagjerëve (PNR) për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave terroriste dhe krimeve të rënda. Pas hyrjes në fuqi të ligjit, u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 23.10.2025, “Për miratimin e rregullores për përpunimin e të dhënave të udhëtimit”. Në përputhje me këtë vendim, çdo transportues që operon në Republikën e Shqipërisë me rrugë tokësore, detare ose ajrore, gjatë hyrjes, daljes ose tranzitit dhe që regjistron të dhëna udhëtimi, duhet t'i transmetojë Njësisë së Inteligjencës së Udhëtimit, përmes një metode të sigurt transmetimi (push) ose çdo metode tjetër të sigurt të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare, të dhënat e udhëtimit të mbledhura gjatë aktivitetit të tij. Aktualisht, po përpunohen vetëm të dhënat e pasagjerëve që udhetojnë në rrugë ajrore.

Njësia e Informacionit për Pasagjerët (PIU) u krijua në shkurt 2022, brenda Policisë së Shtetit. Po

ashtu, është krijuar një bazë të dhënash për pasagjerët që mbledh, përpunon, shkëmben dhe shpërndan të dhënat e fluturimeve të pasagjerëve. Të dhënat e informacionit të udhëtimit mblidhen dhe përpunohen nga PIU, dhe, gjithashtu, shpërndahen ose shkëmbehen me autoritetet operacionale, vetëm për qëllimin e parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale siç parashikohet nga ligji. Autoritete të ndryshme shtetërore kanë të drejtë të kërkojnë, konsultojnë dhe të marrin të dhëna udhëtimi ose rezultatet e përpunimit të tyre, për qëllimin e parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale. PIU, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, kryen shkëmbime ndërkombëtare të të dhënave (përmes SIENA) me shtetet anëtare të BE-së, me Interpol dhe Europol, brenda kornizës së marrëveshjes për bashkëpunim operativ, si dhe me vende joanëtare të BE-së në zbatim të marrëveshjeve bilaterale. Transferimi i të dhënave PNR nga fluturimet brenda BE-së drejt Shqipërisë nuk është i mundur në kuadër të legjislacionit aktual të BE-së.

Korniza ligjore e BE-së për API/PNR u rishikua në janar 2025 me hyrjen në fuqi të Rregullores (BE) 2025/12 dhe Rregullores (BE) 2025/13. Të dyja rregulloret vendosin rregulla të reja për mbledhjen automatike të të dhënave API dhe transferimin e të dhënave API dhe PNR përmes një ruteri në nivel BE-je, aktualisht në zhvillim nga eu-LISA. Kërkesat teknike dhe operacionale të nevojshme për sistemin e ri janë duke u vendosur aktualisht dhe do të miratohen në vitin 2026. Shqipëria duhet të monitorojë me kujdes këto zhvillime në nivel BE-je për të siguruar që Ligji 38/2025 dhe çdo rregull teknik dhe operativ tjetër të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së

Lidhur me një nga sistemet e përdorura nga vendet e *Schengen*-it, për të cilin Shqipëria do të sigurojë infrastrukturë për lidhshmëri dhe ndërveprim është Sistemi i Informacionit *Schengen* (SIS). Është një sistem informacioni shumë efikas dhe në shkallë të gjerë që luan një rol kritik në mbështetjen e kontrollit të kufijve të jashtëm dhe bashkëpunimit për zbatimin e ligjit midis shteteve të *Schengen*-it. Si mjeti më i rëndësishëm dhe efektiv për shkëmbimin e informacionit në këtë kontekst, SIS u mundëson autoriteteve kompetente, siç janë policia, rojet kufitare dhe të tjerë, të fusin dhe të konsultohen me njoftime që lidhen me kategori



specifike të personave dhe objekteve të kërkuara ose të zhdukura. Çdo njoftim SIS përfshin jo vetëm detaje rreth personit ose objektit në fjalë, por edhe udhëzime të qarta operative mbi veprimet që duhen ndërmarrë kur individit ose sendi gjendet. Përveç agjencive të zbatimit të ligjit, aksesit në SIS u jepet edhe doganave, autoriteteve të vizave dhe imigracionit, organeve gjyqësore, avionëve dhe armë zjarri dhe shërbimeve të regjistrimit të automjeteve.

Përdoruesit operacionalë aksesojnë të dhënat e SIS përmes sistemeve të tyre kombëtare të zbatimit të ligjit dhe aplikacione për kërkimin e informacionit, duke lejuar kontrole rutinë për të kërkuar njëkohësisht si bazat e të dhënave kombëtare ashtu edhe SIS.

Në thelb të funksionimit të Sistemit të Informacionit *Schengen* (SIS), një rol kyç në shkëmbimin efektiv të informacionit midis Shteteve Anëtare luajnë Zyrat SIRENE.

Për këtë arsye, çdo shtet anëtar duhet të caktojë autoritetin përgjegjës që do të sigurojë shkëmbimin e të gjithë informacionit plotësues – Zyrën SIRENE – e cila funksionon në mënyrë të pandërprerë, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

Sistemi që regjistron kalimet kufitare (hyrjet dhe daljet dhe refuzimet) për të gjithë shtetasit e vendeve të treta që vizitojnë zonën *Schengen* për një qëndrim të shkurtër është Sistemi i Hyrjeve/Daljeve (SEE). Identiteti (të dhënat alfanumerike, 4 gjurmë gishtash dhe imazhi i fytyrës) së bashku me detajet e dokumentit të udhëtimit do të lidhen me të dhënat elektronike të hyrjeve dhe daljeve.

Sistemi që shërben për të mbledhur informacion dhe për të identifikuar rreziqet e migracionit, sigurisë ose shëndetit që lidhen me një vizitor të përjashtuar nga viza që udhëton në zonën *Schengen* është Sistemi i Informacionit ETIAS, dhe çdo shtet anëtar ka Njësinë e vet Kombëtare ETIAS.

OBJEKTIVI SPECIFIK 5.1

Harmonizimi i akteve ligjore, teknike dhe operationale të Policisë së Shtetit me sistemet e informacionit *Schengen* dhe për të siguruar një arkitekturë dhe infrastrukturë teknike të sigurt dhe të ndërveprueshme për lidhje të pandërprerë.

MASA 5.1.1

Përmirësimi i sistemeve ekzistuese për të përmbushur veçoritë dhe elementët e sigurisë të azhuruara.

REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Efikasiteti operativ, ndërveprim dhe siguri e përmirësuar e sistemeve kombëtare, duke siguruar përputhshmëri me standardet e BE-së/*Schengen*-it

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
5.1.1.1	Përmirësimi i përdorimit të bazave të të dhënave në lidhje me e-vizën, e-lejen (lejen) në sistemin FER dhe TIMS.	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2026–2027	Buxheti i shtetit	Numri i sistemeve të përmirësuara ose të përditësuara	<i>e-Visa</i> - përmirësuar TIMS - përmirësuar FER – Proc. prokurimi Mirëmbajtje (përmirësuar në vitin 2023) LEJET AKPA – Aktualisht sistemi është në një kontratë mirëmbajtje
5.1.1.2	Funksionimi i sistemit PISCES në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale	Policia e Shtetit	2026	Buxheti i shtetit	Funksionimi i sistemit PISCES në përputhje me standardet e BE-së	
5.1.1.3	Platforma SEED+ për shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve që veprojnë në kufi dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit	Doganat AKU Të gjitha institucionet e tjera përkatëse	2026	Buxheti i shtetit	Shkëmbim informacioni midis autoriteteve të siguruar	
5.1.1.4	Organizimi i trajnimeve tematike në lidhje me çdo përmirësim të funksionalitetit të sistemeve ekzistuese	Doganat Të gjitha institucionet përkatëse	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve tematike të organizuara - Numri i stafit të trajnuar	



MASA 5.1.2	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Përmirësimi i infrastrukturës së internetit dhe IT-së me mjete komunikimi më të përparuara	Infrastrukturë digjitale e forcur që mundëson komunikim dhe shkëmbim të dhënash më të shpejtë, më të besueshëm dhe më të sigurt.

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
5.1.2.1	Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së IT-së për menaxhimin e kufijve, për të siguruar aksesin në TIMS në të gjitha pikat e kalimit kufitar	Policia e Shtetit	2026–2028	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	- Infrastruktura e IT-së është përmirësuar - Qasja në TIMS është e siguruar	
5.1.2.2	Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës për të vlerësuar fizibilitetin e rivendosjes së sistemit ekzistues të komunikimit me radio për strukturat e Policisë Kufitare ose përcaktimin e domosdoshmërisë për zbatimin e një sistemi të ri.	Policia e Shtetit	2028	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Studimi i fizibilitetit i përfunduar dhe rekomandimet e dhëna	
5.1.2.3	Përmirësimi dhe sigurimi i pajisjeve radiokomunikimi (të lëvizshme dhe stacionare) për të gjitha shërbimet e Kufirit dhe Migracionit.	Policia e Shtetit	2026–2027	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Pajisjet e radio-komunikimit të ofruara	
5.1.2.4	Përmirësimi i sistemit të komunikimit të aplikuar nga agjencitë ligjzbatuese të përfshira në kontrollin e kufirit blu	Policia e Shtetit	2026–2027	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Sistemi i komunikimit u përmirësua	
5.1.2.5	Organizimi i trajnimeve tematike në lidhje me çdo përmirësim në infrastrukturën e IT-së dhe pajisjet e reja të futura në përdorim.	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve të organizuara - Numri i stafit të trajnuar	

MASA 5.1.3	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Harmonizimi i kuadrit ligjor dhe zhvillimi i kapaciteteve të reja për të përmbushur standardet e kërkesave të Schengen-it.	Kuadri ligjor i përditësuar dhe kapacitetet e reja operationale, të harmonizuara me kërkesat e Schengen-it, janë krijuar dhe janë në përdorim..

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
5.1.3.1	Përmirësimi i sistemit ekzistues të shkëmbimit të të dhënave të pasagjerëve, në funksion të digjitalizimit të plotë të kontrollit të të dhënave të udhëtimit për të gjitha mjetet e transportit (ajror, detar dhe tokësor).	Policia e Shtetit AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2026	Buxheti i shtetit	Sistemi i shkëmbimit të të dhënave të pasagjerëve i përmirësuar	Në progres
5.1.3.2	Përmirësimi i sistemeve të informacionit me përshtatje teknike shtesë për t'u përputhur me Sistemin e Informacionit të Vizave (SIV)	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2026–2027	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i sistemeve të informacionit të përmirësuar	
5.1.3.3	Zhvillimi i rregullave, kapaciteteve dhe procedurave përkatëse për të mbledhur gjurmët e gishtërinjve dhe imazhe të ftyrës infrastruktura e përshtatshme e IT-së për të qenë në përputhje me EUODAC pas anëtarësimit.	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2030	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Procedurat përkatëse të miratuara - Ngritja e infrastrukturës së IT-së	



5.1.3.4	Përshtatja/konfigurimi i një sistemi të ri për të përmbushur kërkesat ligjore për t'u ndërlidhur me sistemin SIS, duke përfshirë shqyrtimin e bazave të të dhënave kombëtare për krijimin e alerteve në nivel kombëtar dhe përafrimin e kategorive të të dhënave me kategoritë e të dhënave në Rregulloret e SIS.	Ministria e Punëve të Brendshme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2030	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Një sistem i ri i konfiguruar	
5.1.3.5	Përmirësimi i sistemeve për të siguruar që shërbimi përgjegjës për lëshimin e certifikatave të regjistrimit, të tilla si: certifikatat për regjistrimin e makinave, mjeteve lundruese, armëve të zjarrit etj., të ketë qasje në të dhënat e plota të ruajtura në (SIS) dhe përfshirja në procedurën e brendshme që në rast të një goditjeje policia të informohet në përputhje me rregullat.	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Institucionet e tjera përkatëse AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2030	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i sistemeve të përmirësuara	
5.1.3.6	Themelimi i Zyrës kombëtare SIRENE (zyra mund të integrohet me <i>Europol/Interpol</i>)	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit	2030	Buxheti i shtetit	Krijimi i Zyrës Kombëtare SIRENE	
5.1.3.7	Futja e rregullimeve të nevojshme, për të përmbushur kërkesat ligjore për përdorimin e sistemit EES	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2030	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Rregullimi i nevojshëm miratuar	
5.1.3.8	Krijimi i një sistemi që përputhet me kërkesat për ndërfaqe me sistemin ETIAS	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2030	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Sistemi i vendosur	
5.1.3.9	Ngritja e Njesisë Kombëtare ETIAS	Policia e Shtetit AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2030	Buxheti i shtetit	Njësia Kombëtare ETIAS krijuar	
5.1.3.10	Kryen trajnime në punë/tematike që shoqërojnë çdo zhvillim në funksionimin e sistemeve/sistemin e ri/strukturat e reja.	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik Institucionet kontribuese	2030	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i trajnimeve tematike të organizuara - Numri i stafit të trajnuar mbi tema specifike	Në proces
5.1.3.11	Rishikimi i kuadrit ligjor përkatës API/PNR për t'u harmonizuar me <i>acquis-in</i> e BE-së (Rregullorja (BE) 2025/12 dhe Rregullorja (BE) 2025/13)	Ministria e Punëve të Brendshme	2030	Buxheti i shtetit	Arritja e përputhshmërisë me kërkesat e <i>acquis-it Schengen</i>	
5.1.3.12	Zhvillimi i rregullave teknike dhe operacionale përkatëse, kapaciteteve dhe procedurave për të marrë pjesë në ndërveprueshmërinë e BE-së	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2030	Buxheti i shtetit, Mbështetje nga donatorë	Infrastrukturë IT e krijuar Infrastrukturë organizative e krijuar	



KAPITULLI 6

POLITIKA E PËRBASHKËT E VIZAVE DHE QARKULLIMI I LIRË ME VIZA AFATGJATA DHE LEJE QËNDRIMI

Politika e vizave e Shqipërisë nuk është plotësisht në përputhje me rregullat e BE-së, duke përfshirë edhe listën e vendeve të BE-së nga të cilat shtetasit janë nën detyrimin për vizë. Përveç kësaj, praktika e heqjes së përkohshme të kërkesave për vizë nuk është në përputhje me *acquis* të BE-së. Megjithatë, Shqipëria ka një plan për të përafruar politikën e saj të vizave me atë të BE-së bazuar në një Roadmap, një proces që do të kryhet në kohën e duhur.

Shqipëria ka zhvilluar sistemin e vet të vizave i cili përdoret nga të gjitha autoritetet kompetente për të marrë, verifikuar, vlerësuar dhe lëshuar ose refuzuar vizat në mënyrë elektronike (me një kod QR) ose një vizë pullë për të lëshuar vizë elektronike të vulosur në mënyrë digjitale ose vizë pullë. Procedurat për procesin e aplikimit dhe procesin e verifikimit janë të ngjashme me ato të parashikuara në *acquis* të BE-së, megjithatë, të dhënat e gjurmëve të gishtërinjve aktualisht nuk administrohen. Sistemet e informacionit të Shqipërisë do të kërkojnë përshtatje shtesë teknike për t'u përputhur me Sistemin e Informacionit për Vizat.

Lidhur me specifikimet teknike mbi standardet për karakteristikat biometrike që lidhen me zhvillimin e Sistemit të Informacionit për Vizat, Etiketat e Vizave të lëshuara nga Misionet Diplommatike dhe Konsullore Shqiptare janë në përputhje me të gjitha standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe se sistemi shqiptar i Vizave Elektronike janë në përputhje me standardet përkatëse ISO.

Të dhënat biometrike të aplikantëve për vizë nuk përpunohen nga Misionet Diplommatike dhe Konsullore Shqiptare dhe duhet të miratohet një procedurë standarde operative. Elementi i sigurisë së skanimit të gjurmëve të gishtërinjve duhet t'i shtohet procedurës së lëshimit të vizave dhe ato duhet të jenë në përputhje me një format uniform për vizat.

Pajtueshmëria me kërkesat e Sistemit të Informacionit për Vizat do të kërkojë përshtatje të mëtejshme teknike, në varësi të trajnimit të specializuar mbi Sistemin e Informacionit për Vizat. Shqipëria ka një kapacitet të mjaftueshëm administrativ për të zbatuar politikën e vizave të BE-së dhe do të marrë parasysh në mënyrë të plotë procesin e BE-së për modernizimin dhe digjitalizimin e përpunimit të vizave.

OBJEKTIVI SPECIFIK 6.1

Përmirësimi i procedurave, sistemeve dhe kapaciteteve institucionale kombëtare të vizave për t'u përafruar me Politikën e Përbashkët të Vizave të BE-së dhe për të siguruar gatishmërinë për integrimin me Sistemin e Informacionit për Vizat.

MASA 6.1.1

Përafrimi me Politikën e Përbashkët të Vizave të BE-së dhe për të siguruar gatishmërinë operative për integrimin me Sistemin e Informacionit për Vizat

REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Sistemi dhe praktikat kombëtare të vizave të përafruara me standardet e BE-së dhe plotësisht të përgatitura për integrimin e Sistemit të Informacionit për Vizat.

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
6.1.1.1	Krijimi i një Grupi Ndërinstitucional për Vizën që monitoron ndryshimet në regjimin e vizave të BE-së dhe përditëson politikën kombëtare	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit	2026	Buxheti i Shtetit	Krijimi i Grupit Ndërinstitucional për Vizën që monitoron ndryshimet në regjimin e vizave të BE-së	
6.1.1.2	Udhëzime për Vlerësimin e Analizës së Rrezikut për shtetasit e vendeve që mund të përdorin Shqipërinë si rrugë tranziti drejt vendeve të BE-së.	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme Policia e Shtetit	2026	Buxheti i Shtetit	Miratimi i udhëzimeve për Vlerësimin e Analizës së Rrezikut	
6.1.1.3	Krijimi i një regjistri elektronik mbi refuzimet e vizave dhe arsyet e tyre	Ministria e Punëve të Brendshme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2026–2027	Buxheti i Shtetit	Krijimi i një regjistri elektronik mbi refuzimet e vizave	
6.1.1.4	Krijimi i një regjistri kombëtar të integruar për vizat Tip “D” dhe	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	2026–2027	Buxheti i Shtetit	Krijimi i një regjistri kombëtar	



	lejet e qëndrimit. Një bazë të dhënash mbi vizat dhe lejet e qëndrimit të miratuara, të refuzuara dhe të anuluar	Ministria e Punëve të Brendshme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik			të integruar për vizat Tip “D” dhe lejet e qëndrimit	
6.1.1.5	Zhvillimi i procedurës standarde operative për mbledhjen e të dhënave biometrike/germave të gishtërinjve për aplikimet <i>online</i>	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme Ministria e Punëve të Brendshme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2027–2028	Buxheti i Shtetit	Miratimi i procedurës standarde operative	
6.1.1.6	Mbledhja e të dhënave biometrike për kategoritë e vizave, sipas kërkesave të <i>acquis-it</i> të BE-së.	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	2029–2030	Buxheti i Shtetit	Zgjerimi i numrit të kategorive të vizave për të përfshirë mbledhjen e detyrueshme të të dhënave biometrike	
6.1.1.7	Zhvillimi i procedurave dhe sistemeve të vizave për integrimin me VIS dhe krijimin e ndërveprueshmërisë me sisteme të tjera.	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	2030	Buxheti i shtetit, Mbështetje nga donatorë (IPA III etj.)	Procedura dhe sistemet e zhvilluara për ndërveprimin me VIS	
6.1.1.8	Ndryshimet në kuadrin ligjor për zbatimin e plotë të politikës së vizave të BE-së dhe harmonizimin me listat e vizave (d.m.th. lista pozitive dhe lista negative), në përputhje me udhërrëfyesin për harmonizimin e politikës së vizave të Shqipërisë	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2027	Buxheti i Shtetit	Numri i ndryshimeve ligjore të miratuara (Harmonizuar para anëtarësimit bazuar në planin rrugor të harmonizimit të politikës së vizave)	Harmonizuar para anëtarësimit
6.1.1.9	Përditësimi i sistemeve elektronike dhe i faqeve zyrtare (në rast se ka ndryshime në regjimin e vizave)	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit	Rritja e numrit të përdoruesve që aksesojnë informacionin e përditësuar mbi vizat <i>online</i>	

MASA 6.1.2	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Forcimi i kapaciteteve administrative dhe institucionale të stafit konsullor dhe përmirësimi i cilësisë së lëshimit të vizave.	Efikasitet i përmirësuar në përpunimin e vizave dhe besim i shtuar në sistemin e lëshimit të vizave

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
6.1.2.1	Forcimi i kapaciteteve të stafit konsullor dhe të migracionit përmes trajnimeve periodike mbi vlerësimin e rrezikut dhe sigurimin e përmirësuar në lëshimin e vizave dhe lejeve të qëndrimit.	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i stafit të trajnuar	
6.1.2.2	Zgjerimi dhe forcimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore për procedurat e mbledhjes së të dhënave biometrike.	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja nga donatorë	Numri i stafit konsullor të trajnuar dhe të certifikuar në procedurat e mbledhjes së të dhënave biometrike	
6.1.2.3	Sigurimi i kushteve që të dhënat biometrike të aplikantëve për vizë të përpunohen edhe nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore.	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme AKSHI - institucion kontribues/mbështetës teknik	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit	Numri i Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të pajisura dhe që përpunojnë në mënyrë aktive të dhëna biometrike për aplikantët për vizë	



6.1.2.4	Trajnim i specializuar mbi të gjitha aspektet e lidhura me lëshimin e vizave	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme Policia e Shtetit Shërbimi Informativ i Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i trajnimeve të kryera mbi tema specifike	
6.1.2.5	Fushatë informimi (media/rrejetet sociale) për parandalimin e aplikimeve të pasakta, e cila mund të ndihmojë në reduktimin e numrit të refuzimeve për shkak të dokumentacionit të pasaktë ose të falsifikuar.	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit	Ulja e normës së refuzimeve të aplikimeve për shkak të informacionit të pasaktë ose të falsifikuar	

KAPITULLI 7

BASHKËPUNIMI NË ZBATIMIN E LIGJIT DHE SIGURIA E BRENDSHME

Bashkëpunimi i zbatimit të ligjit në Shqipëri me shtetet anëtare të BE-së, Europolin dhe *Eurojust*-in, si dhe një përfshirje shumë aktive në EMPACT, po jep rezultate pozitive. Shqipëria ka një marrëveshje në nivel operacional dhe strategjik me Europolin që nga viti 2013 dhe ka emëruar një oficer ndërlidhës në Europol, me një të dytë të emëruar në shkurt 2023.

Agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit përdorin marrëveshjen operative me Europolin, duke përfshirë shkëmbimin proaktiv dhe në kohë të informacionit përmes SIENA-s, dhe përdorin ekipet e përbashkëta hetimore për të kryer hetime me homologët e tyre të BE-së.

Gjithashtu, Shqipëria merr pjesë në projektet e analizës operationale të Europolit dhe në projektet e analizës në lidhje me krimin kibernetik, krimin mjedisor, krimin e organizuar ndaj pronës, terrorizmin dhe kontrabandën e migrantëve, si dhe trafikimin e qenieve njerëzore, armëve dhe eksplozivëve. Hapja në korrik 2019, dhe funksionimi i Zyrës Ndërlidhëse të Europolit në Shqipëri, e para që vepron në rajonin e Ballkanit Perëndimor, dhe vendosja e një Oficeri Ndërlidhës të Europolit në Tiranë ndihmuan në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit policor me Europolin dhe Shtetet Anëtare të BE-së. Shqipëria, gjithashtu, ka vazhduar të bashkëpunojë mirë në çështjet penale, përfshirë me Shtetet Anëtare të BE-së.

Shqipëria ka ndarë gjithnjë e më shumë informacione me Europolin. Në vitin 2019, Shqipëria iu bashkua Rrjetit Operacional joformal kundër Pastrimit të Parave dhe u bë një partner strategjik në luftën kundër “krimit të organizuar ndaj pronës”, një nga fushat prioritare të krimit të Europolit dhe një prioritet në kuadër të Platformës

Multidisiplinare Europiane kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT).

Një marrëveshje është në fuqi midis Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Zyrës së Prokurorisë Speciale dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit përkatësisht për t’u lejuar atyre akses në SIENA. Një marrëveshje e ngjashme është në fuqi midis Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Agjencisë Doganore dhe është funksionale, me tre përdorues që shkëmbejnë të dhëna në kanalën SIENA të Europolit.

Pika e kontaktit lidhur me SIENA është Drejtoria e Europolit brenda Policisë së Shtetit, megjithëse SIENA përdoret nga disa institucione të tjera, si Prokuroria e Posaçme, Doganat, FIU etj. Megjithatë, nuk ekziston ende një sistem menaxhimi rastesh që të ndërveprojë me SIENA, për të cilin do të punohet dhe do të bien dakord me strukturat e Europolit në kohën e duhur.

Shqipëria është vëzhguese në Rrjetin European të Ekipeve të Kërkimit Aktiv për të Arratisurit (ENFAST) dhe merr pjesë aktive në Platformën Europiane Multidisiplinare kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT). Ajo ka emëruar një Koordinator Kombëtar të EMPACT.

Shqipëria është palë në Konventën e Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (PCCSEE). Shqipëria ka 35 marrëveshje dypalëshe me vendet palë në Konventën PCCSEE, përfshirë pesë Shtete Anëtare. Këto marrëveshje mbulojnë fusha të ndryshme në fushën e sigurisë, duke përfshirë luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, krimit ndërkufitar dhe trajnimit policor. Shqipëria ka, gjithashtu, një marrëveshje ndërkombëtare bashkëpunimi policor me Mbretërinë e Bashkuar. Shqipëria ka oficerë ndërlidhës policorë të caktuar në nëntë vende të treta, përfshirë pesë Shtete Anëtare dhe tri organizata ndërkombëtare (Europol, Interpol dhe SELEC).



Shqipëria ka kërkuar integrim të përsheptuar në lidhje me Europolin, me bashkëpunim të shtuar si fokus kryesor, duke përfshirë aksesin më të madh në bazat e të dhënave dhe aftësinë për të ndikuar në ciklin e politikave të agjencisë, në lidhje me CEPOL, në lidhje me rregulloren Prüm dhe në lidhje me Rrjetin European për Mbrojtjen e Figurave Publike (ENPPF).

Lidhur me kërkesën për integrim të përsheptuar në lidhje me Europolin, vendet që kanë marrëveshje operative në fuqi me Europolin mund të marrin pjesë si vëzhgues në takimet e Kryetarëve të Njësisë Kombëtare të Europolit. Ato mbahen katër herë në vit dhe Shqipëria ka marrë pjesë rregullisht. Ky është forumi më i rëndësishëm për Shqipërinë pasi mbulon çështje operationale. Takimet e Bordeve Menaxhuese të Europolit nuk janë të hapura për vendet joanëtare të BE-së pasi ato mbulojnë çështje të brendshme (burime njerëzore, buxhet etj.). Mundësia për një angazhim më të thellë të Shqipërisë në kuadrin e bashkëpunimit Prüm përmes dorëzimit/ndarjes së të dhënave me Europolin është duke u shqyrtuar. Lidhur me ENPPF, kërkesa i është transmetuar grupit të koordinimit të përgjithshëm të Rrjetit dhe do të vlerësohet.

Shqipëria po merr pjesë aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rajonal për zbatimin e ligjit, duke dhënë rezultate pozitive. Një numër operationesh policore kryhen rregullisht në bashkëpunim me Europolin, autoritetet e shteteve anëtare të BE-së, veçanërisht në kontekstin e EMPACT ku Shqipëria është shumë aktive. Një numër operationesh doganore kryhen rregullisht me autoritetet doganore të OBD-së (STOP, SECURE HORIZON, PANDORA, DEMETER, NEPTUNE, TENTACLE, JUBILARIAN, RANDA, THUNDER, CLAUDIS). Rrjeti Kombëtar i Zbatimit të Ligjit për Doganat (nCEN) është një sistem i zhvilluar nga OBD për të ndihmuar administratat doganore në mbledhjen dhe ruajtjen e informacionit të zbatimit të ligjit në nivel kombëtar, me aftësinë shtesë për të shkëmbyer këtë informacion në nivele rajonale dhe ndërkombëtare.

Bashkëpunimi midis Akademisë së Sigurisë Shqiptare dhe Agjencisë së BE-së për Trajnimin e Zbatimit të Ligjit (CEPOL) është i mirë konsoliduar dhe bazohet në një marrëveshje pune. Ekziston një pikë kontakti e dedikuar. Shqipëria përfiton nga aksesin i plotë në Programin e Shkëmbimit të CEPOL dhe merr pjesë në projektin e Partneritetit

kundër Krimit dhe Terrorizmit të udhëhequr nga CEPOL në Ballkanin Perëndimor.

Vendet e treta që kanë një Marrëveshje Pune me CEPOL ftohen në “Takimet e Njësisë Kombëtare” të CEPOL që zhvillohen dy herë në vit. Agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit kanë, gjithashtu, qasje në trajnime të shumta të CEPOL që janë të disponueshme në platformat *online*.

Shqipëria zbatoi një marrëveshje dypalëshe me Komisionin European për operacionalizimin e Planit të Përbashkët të Veprimit për Luftën kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor i nënshkruar në vitin 2018. Shqipëria nënshkroi më 30 tetor 2025, së bashku me partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor, Planin e Ri të Veprimit të Përbashkët për Parandalimin dhe Luftën e Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm, të propozuar nga Komisioni dhe pritet që tani të paraqesë deri në fund të janarit një plan veprimi për zbatimin e tij.

Shqipëria ka marrë pjesë aktivisht në zbatimin e nismës së Ballkanit Perëndimor kundër terrorizmit, në kuadër të Qeverisjes së Integruar të Sigurisë së Brendshme (IISG). Drejtoria kundër Terrorizmit e Policisë së Shtetit disponon një kanal të dedikuar CT SIENA dhe ka akses në platformën SIRIUS. Oficeri Ndërlidhës i Shqipërisë pranë Europolit mund të transmetojë dhe transmeton të dhëna përkatëse që lidhen me çështje të terrorizmit.

Shqipëria ka një bashkëpunim të mirë dhe pjesëmarrje aktive në aktivitetet e kryera nga institucionet për bashkëpunim rajonal, duke përfshirë Sekretariatit e Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore; Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC); Qendrën e Zbatimit të Ligjit të Europës Juglindore (SELEC); dhe Iniciativën Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI).

Aktiviteti i paligjshëm identifikohet dhe informacioni rreth tij ndahet me vendet e tjera, duke siguruar veprime të përbashkëta për ta penguar atë. Janë hartuar, gjithashtu, procedura të përbashkëta për shkëmbimin e informacionit dhe operatione e hetime të përbashkëta.

Shqipëria ka ratifikuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit Policor midis vendeve të Ballkanit Jugperëndimor, PCC SEE, “Mbi shkëmbimin automatik të të dhënave daktiloskopike, profileve të ADN-së dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve”.



OBJEKTIVI SPECIFIK 7.1

Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar midis agjencive të zbatimit të ligjit, për të luftuar në mënyrë efektive aktivitetet kriminale ndërkufitare.

MASA 7.1.1

Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me vendet rajonale dhe agjencitë e Shteteve Anëtare

REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Siguri rajonale e përmirësuar dhe parandalim e zbulim më efektiv i krimeve transnacionale përmes bashkëpunimit të forcurar midis agjencive rajonale dhe atyre të zbatimit të ligjit të shteteve anëtare.

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
7.1.1.1	Paraqitja e planit të veprimit për zbatimin e Planit të Ri të Veprimit të Përbashkët për Parandalimin dhe Luftën e Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm, të propozuar nga Komisioni Europian	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit Doganat	Janar 2026	Buxheti i shtetit	Paraqitja e planit të veprimit për zbatim	
7.1.1.2	Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit me agjencitë e zbatimit të ligjit nga vendet e rajonit dhe agjencitë e Shteteve të Anëtare mbi strukturat kriminale brenda dhe jashtë vendit.	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit Doganat Institucione të tjera të përfshira	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i rasteve të inteligjencës dhe shkëmbimit të informacionit në lidhje me strukturat kriminale brenda një viti	
7.1.1.3	Rritja e operacioneve të përbashkëta policore kundër aktiviteteve dhe strukturave kriminale	Policia e Shtetit	Vazhdimisht		Numri i operacioneve të përbashkëta të angazhuara brenda një viti	
7.1.1.4	Rritja e përdorimit proaktiv të produkteve, shërbimeve dhe aftësive të platformave të komunikimit të Qendrës Europiane Kundër Terrorizmit e Europolit.	Të gjitha agjencitë ligjzbatuese të përfshira	Vazhdimisht		Rritja e përqindjes në rastet operative të mbështetura nga Qendra Europiane Kundër Terrorizmit e Europolit mjete dhe shërbime	
7.1.1.5	Vendosja e procedurave për të rregulluar unifikimin e bazës së të dhënave vendëse për të lejuar shkëmbimin e të dhënave me Sistemin Europian të Informacionit të Regjistrimit Penal (ECRIS)	Ministria e Drejtësisë	2026	Buxheti i shtetit	Inicimi i analizës për ngritjen e këtij sistemi dhe përcaktimi i mënyrës së bashkëpunimit me vendet anëtare të BE-së	
7.1.1.6	Sigurimi i lidhjes së duhur të rrjetit për të siguruar transferimin e sigurt të të dhënave midis vendeve partnere brenda PCCSEE, si dhe me shtetet anëtare të BE-së.	Të gjitha agjencitë ligjzbatuese të përfshira	2026–2027	Buxheti i shtetit	Numri i vendeve partnere me lidhje rrjeti të sigurta aktive dhe funksionale të vendosura në kuadër të PCCSEE dhe shteteve anëtare të BE-së	
7.1.1.7	Lidhja dhe zbatimi i marrëveshjeve me vendet e treta mbi ndarjen e të dhënave (gjurmët e gishtërinjve, profili i ADN-së, të dhënat e automjeteve, të dhënat kriminale, të dhënat financiare etj.)	Ministria e Punëve të Brendshme Doganat Institucione të tjera të përfshira	2026–2027	Buxheti i shtetit	Numri i marrëveshjeve të lidhura dhe të nënshkruara	
7.1.1.8	Krijimi i një sistemi për menaxhimin e rasteve që të ndërveprojë me SIENA	Policia e Shtetit Të tjera institucione të përfshira	2027–2028	Buxheti i shtetit	Krijimi i një sistemi për menaxhimin e rasteve që ndërvepron me SIENA	



KAPITULLI 8

MBROJTJA E TË DHËNAVE NË LIDHJE ME KUADRIN E SCHENGEN-IT

Mbrojtja e të dhënave personale parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shqipëria ka ratifikuar me ligjin nr. 49/2022, “Protokollin ndryshues të Konventës, “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”” (njohur ndryshe si Konventa 108+). Legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri përbëhet nga ligji nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafruar me Rregulloren e Përgjithshme 2016/679 të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe Direktivën e BE-së 2016/680, “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”, dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Lidhur me kuadrin institucional, kapacitetet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe ato të kontrolluesve publikë dhe privatë të të dhënave duhet të forcohen për të siguruar zbatim efektiv të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave, duke përfshirë edhe nismat e ndërgjegjësimit publik për kontrolluesit publikë dhe privatë të të dhënave personale.

Procedura për ushtrimin e të drejtës për informim dhe akses në të dhënat personale kryhet sipas parashikimeve ligjore (nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 124/2024) dhe për moszbatimin e tyre parashikohen përgjegjësi administrative për kontrolluesin sipas ligjit të sipërcituar. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave personale ka rol të veçantë sipas nenit 34 të ligjit.

OBJEKTIVI SPECIFIK 8.1

Përmirësimi i kuadrit rregullator për të forcuar kapacitetet teknike dhe organizative në fushën e mbrojtjes së të dhënave, për t'u përafruar me standardet e BE-së.

MASA 8.1.1

REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Përmirësimi i kuadrit rregullator për t'u përafruar me standardet e BE-së

Kornizat ligjore dhe rregullatore kombëtare të harmonizuara me standardet e BE-së

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
8.1.1.1	Miratimi i kuadrit ligjor/legjislacionit dytësor përkatës dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe procedural për mbrojtjen e të dhënave në të gjitha sistemet relevante për Schengen (mandati ligjor dhe kapaciteti për të mbikëqyrur SIS, VIS, EES, ETIAS dhe ndërveprimin).	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	2026–2027	Buxheti i shtetit	Numri i akteve nënligjore të miratuara	
8.1.1.2	Forcimi i mbrojtjeve ligjore dhe sigurimi i ligjeve të qëndrueshme që rregullojnë përdorimin e të dhënave të mbikëqyrjes, duke e vendosur mbikëqyrjen e saj nën kontrollin e fortë gjyqësor.	Ministria e Drejtësisë Ministria e Punëve të Brendshme	2027	Buxheti i shtetit	Ndryshimet e duhura ligjore të miratuara	

MASA 8.1.2

REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Rritja e kapaciteteve teknike dhe organizative të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Efektivitet dhe efikasitet i përmirësuar i Komisionerit në përmbushjen e mandatit të tij

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
8.1.2.1	Forcimi i kapaciteteve (teknike dhe organizative) dhe kompetencave të Komisionerit që rrjedhin nga legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	2026–2027	Buxheti i shtetit	- Numri i veprimeve zbatuese, dokumenteve udhëzuese të	



					lëshuara dhe inspektimeve të kryera çdo vit - Numri i stafit të trajnuar dhe të rekrutuar në përputhje me kompetencat e reja ligjore të Komisionerit	
8.1.2.2	Forcimi i veprimtarisë mbikëqyrëse ndaj kontrolluesve/përpunuesve për garantimin e sigurisë teknike dhe konfidencialitetit, gjatë përpunimit të të dhënave personale.	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i shkeljeve të sigurisë ose incidenteve të qasjes joautorizuar në vit Reduktimi i numrit të incidenteve të sigurisë që përfshijnë të dhënat personale për shkak të dështimeve teknike ose qasjes joautorizuar	
8.1.2.3	Rritja e kapaciteteve administrative në lidhje me praktikatat ndërkombëtare të transferimit të të dhënave personale	Të gjitha institucionet përkatëse të zbatimit të ligjit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Gjetjet e përputhshmërisë lidhur me transferimet ndërkombëtare të të dhënave të identifikuese Reduktimi i numrit të gjetjeve të mos-përputhshmërisë	
8.1.2.4	Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në shkëmbimin e praktikave më të mira	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Institucione të tjera përkatëse të zbatimit të ligjit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve	- Numri i kornizave të bashkëpunimit ndërkombëtar të nënshkruara, ose praktikatat më të mira të miratuara në procedurat kombëtare - Pjesëmarrja në forume ndërkombëtare, grupe pune ose rrjete ekspertësh për mbrojtjen e të dhënave	
8.1.2.5	Përmirësimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi autoritetet që kanë qasje në sistemet ekzistuese dhe të reja	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i autoriteteve kompetente të audituara brenda një afati kohor të caktuar/periudhës njëvjeçare Numri i ankesave/kërkesave të subjekteve të të dhënave të trajtuara brenda një periudhe të caktuar kohore	
8.1.2.6	Forcimi i kapacitetit në Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në Policinë e Shtetit, për integrimin e sistemeve të të dhënave me fokus të veçantë në sigurimin e mbrojtjes së të dhënave	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i stafit të trajnuar dhe të rekrutuar Përqindja e sistemeve të integruara që plotësojnë kërkesat kombëtare/BE për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë Numri i masave të avancuara për mbrojtjen e të dhënave të zbatuara	



MASA 8.1.3	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit dhe fushatave të ndërgjegjësimit	Kapacitete institucionale dhe kuptim i përmirësuar i parimeve dhe praktikave të mbrojtjes së të dhënave

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
8.1.3.1	Zhvillimi i trajnimeve për përpunimin, shkëmbimin dhe ndërvëprimin e të dhënave personale, me qëllim rritjen e aftësive të zyrtarëve përgjegjës për mbledhjen dhe procesimin e të dhënave.	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Institucione të tjera përkatëse të zbatimit të ligjit	2026–2027	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i stafit të trajnuar dhe të certifikuar në përpunim, shkëmbim/transferimin e të dhënave personale	
8.1.3.2	Trajnim i vazhdueshëm për policinë kufitare në mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale.	Policia e Shtetit	2026–2027	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i stafit kufitar të trajnuar	
8.1.3.3	Trajnim i vazhdueshëm mbi mbrojtjen e të dhënave për stafin konsullor	MEPJ	2026–2027	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i stafit konsullor të trajnuar	
8.1.3.4	Trajnim mbi kërkesat e mbrojtjes së të dhënave në lidhje me sistemet dhe strukturën e re, e cila do të ngrihet	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Institucione të tjera përkatëse të zbatimit të ligjit	2026–2027	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i stafit përkatës të trajnuar	
8.1.3.5	Intensifikim i ndërgjegjësimit mbi të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale si një të drejtë themelore.	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i fushatave të ndërgjegjësimit të organizuara	

KAPITULLI 9 LEGJISLACIONI PËR ARMËT E ZJARRIT

Kuadri ligjor i Shqipërisë është pjesërisht i përafëruar me *acquis* të BE-së në fushën e armëve të zjarrit. Gjithashtu, është pjesërisht i përafëruar me Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit. Është palë në Protokollin kundër Prodhimit dhe Trafikimit të Paligjshëm të Armëve të Zjarrit, Pjesëve dhe Komponentëve të tyre dhe Municionit, i cili plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

Shqipëria ratifikoi Traktatin për Tregtinë e Armëve në bazë të ligjit nr. 6/2014, “Për ratifikimin e traktatit për tregtinë e armëve”.

Shqipëria zbatoi një strategji kombëtare për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) 2019–2024 dhe planin e saj të veprimit 2022–2024, dhe është e angazhuar në mënyrë aktive në zbatimin e Udhërrëfyesit Rajonal për një zgjidhje të qëndrueshme për posedimin, keqpërdorimin dhe trafikimin e paligjshëm të AVL-ve dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024, i cili është pjesë e Planit të Veprimit të BE-së për trafikimin e armëve të zjarrit që nga viti 2020, dhe aktualisht është hartuar kuadri i ri strategjik për AVL-të, municionet dhe eksplozivët në përputhje me Udhërrëfyesin Rajonal të rishikuar deri në vitin 2030.

Në nivel operacional, Shqipëria është, gjithashtu, partner aktiv në Veprime të Ndryshme Operacionale për armët e zjarrit, në kuadër të EMPACT Planit Operacional i Veprimit (OAP) për pjesëmarrjen gjatë viteve 2024-2025 në 20 Operacione Operacionale (OAs). Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta dhe një Pikë Kontakti për Armët e Zjarrit janë dy aktorë kryesorë në vlerësimin dhe koordinimin



e veprimeve të drejtpërdrejta kundër kërcënimeve dhe rreziqeve të keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të zjarrit. Njësi Fokale për Armët e Zjarrit funksionon në një format virtual. Ai menaxhon mbledhjen, analizën, shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit penal dhe balistik mbi armët ligjore dhe të paligjshme. Megjithatë, protokollet e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të të dhënave midis agjencive duhet të forcohen

Shqipëria ka një arkitekturë të konsoliduar për identifikimin dhe gjurmimin e armëve të zjarrit nëpërmjet përdorimit të bazave të të dhënave kombëtare, të tilla si: regjistri elektronik kombëtar për armët (“SIMA”), në të cilin janë regjistruar më shumë se 75% e poseduesve të armëve të zjarrit), “iBase” (të dhëna balistike mbi të gjitha armët dhe municionet ushtarake të sekuestruara në një çështje penale) dhe “iArms” (sistemi i gjurmimit të Interpolit) dhe Evofinder. Një bazë të dhënash shtesë – “Traffic” (për shkëmbimin e informacionit balistik) është ende në proces. Në pikat e kalimit kufitar, policia kufitare zbaton procedura standarde të kontrollit për të zbuluar armët.

Megjithatë, ka mangësi që duhen adresuar, duke përfshirë harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së për armët e zjarrit; forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjen e kapaciteteve të strukturës së përhershme si pikë kontakti për armët e zjarrit dhe sigurimin e ndërveprimit të bazave të të dhënave. Shqipëria duhet të rrisë përpjekjet e saj për rritjen e ndërgjegjësimit, shtrirjen e aktiviteteve dhe edukimin mbi rreziqet që lidhen me keqpërdorimin, posedimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit/AVL-ve. Kërkohet mbështetje shtesë për trajnime të specializuara dhe për përmirësimin e infrastrukturës IT, në mënyrë që të ruhet statusi aktual dhe të forcohet ndërveprueshmëria.

OBJEKTIVI SPECIFIK 9.1

Harmonizim i plotë i kuadrit ligjor kombëtar me *acquis* e BE-së dhe për të rritur kapacitetet logjistike dhe operacionale të institucioneve të zbatimit të ligjit në fushën e armëve të zjarrit.

MASA 9.1.1

REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Harmonizimi i politikave dhe kuadrit ligjor në këtë fushë. Një kuadër ligjor dhe politikash koherent dhe në përputhje me BE-në

Nr.	AKTIVITETI	AUTORITETI PËRGJEGJËS	AFATI I FUNDIT	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
9.1.1.1	Ndjekja dhe zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kombëtar për armët e vogla dhe të lehta 2025-2030, në përputhje me Udhërrëfyesin e rishikuar për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor (2025-2030).	Ministria e Punëve të Brendshme	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit	Strategjia dhe Plani i Veprimit miratuar	Strategjia dhe Plani i Veprimit janë miratuar me VKM-në nr. 787, datë 24.12.2025
9.1.1.2	Ndryshimi i Kodit Penal për ta harmonizuar plotësisht atë me Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Drejtësisë	2026	Buxheti i Shtetit	Ndryshimet e propozuara në CC (Komiteti i Koordinimit/Konsultativ) miratuar	Tashmë janë hartuar ndryshime konkrete.
9.1.1.3	Harmonizimi i legjislacionit kombëtar për armët me legjislacionin e rishikuar/përditësuar të BE-së.	Ministria e Punëve të Brendshme	2027	Buxheti i Shtetit	Ndryshimet ligjore të miratuara/ligjet e ndryshuara	Një analizë paraprake është kryer, megjithatë do të kryhet një analizë më e detajuar për të përcaktuar konkretisht fushat e ndërhyrjeve.
9.1.1.4	Plotësimi i legjislacionit dytësor në këtë fushë	Ministria e Punëve të Brendshme	2027	Buxheti i Shtetit	Numri i legjislacionit dytësor të miratuar	

MASA 9.1.2

REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Forcimi i kapaciteteve operacionale të institucioneve të zbatimit të ligjit dhe përmirësimi i infrastrukturës logjistike. Efikasitet, reagim dhe efektivitet i përmirësuar i institucioneve të zbatimit të ligjit në kryerjen e detyrave të tyre në përputhje me standardet e BE-së.

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
9.1.2.1	Forcimi i kontrollin kufitar duke u fokusuar në përmirësimin e profesionalizmit të punonjësve të Pikave të Kalimit Kufitar dhe	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit	2026	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve (IPA etj.)	Numri i trajnimeve të zhvilluara Përqindja e logjistikës së përmirësuar	Në proces



	mbështetjes logjistike në kontrollin kufitar (njësitë K9). Qen policie K9, pajisje zbulimi etj.)					
9.1.2.2	Forcimi i kapaciteteve të pikës fokale për armët e zjarrit	Policia e Shtetit	2026	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve (IPA etj.)	Numri i trajnimeve Përqindja e logjistikës së përmirësuar Përmirësimi/Modernizimi i sistemeve/bazave të të dhënave në përdorim	Në proces
9.1.2.3	Forcimi i shkëmbimit dhe bashkëpunimit të informacionit midis shteteve të ndryshme të palëve të interesuara dhe agjencitë e zbatimit të ligjit	Policia e Shtetit Doganat Institucione të tjera të zbatimit të ligjit	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve (IPA etj.)	Numri i protokolleve të shkëmbimit të të dhënave midis agjencive % e rritjes së shkëmbimit të informacionit	Në proces
9.1.2.4	Forcimi i bashkëpunimit me mekanizmat ekzistues dypalësh, rajonalë dhe ndërkombëtarë dhe shkëmbimi i praktikave më të mira për të luftuar trafikimin e armëve të zjarrit	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve (IPA etj.)	Rritur shkëmbimi i praktikave më të mira	Në proces
9.1.2.5	Forcimi i shkëmbimit të informacionit operativ dhe strategjik, të të dhënave dhe inteligjencës me agjenci dhe organizma ndërkombëtarë si Europol, Frontex, Eurojust dhe EMPACT.	Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve (IPA etj.)	% e rritjes së shkëmbimit të informacionit	Në proces
9.1.2.6	Përpjekje të shtuara për fushata ndërgjegjësimi, shtrirje në publik dhe edukim mbi rreziqet që lidhen me keqpërdorimin, posedimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit.	Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Arsimit Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2026	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i fushatave ndërgjegjëse	

KAPITULLI 10 FUNKSIONIMI I AUTORITETEVE QË ZBATOJNË *ACQUIS*-in E *SCHENGEN*-it

Shqipëria ka miratuar Strategjinë e re Kundër Korrupsionit për vitet 2024-2030, e cila përqendrohet në fushat me rrezik të lartë për korrupsion (si prona, prokurimi publik, shëndetësia, arsimit, doganat dhe taksat), me theks në edukimin për integritetin e të rinjve. Strategjia kundër korrupsionit ka përfshirë masa për të përmirësuar mekanizmat e monitorimit dhe koordinimit institucional. Megjithatë, synohet të adresohet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale, planifikimit, koordinimit dhe mekanizmave të monitorimit.

Shqipëria ka një kornizë të gjerë ligjore në fushën e parandalimit të korrupsionit që mbulon administratën publike, deklarimin e pasurive, konfliktin e interesave dhe mbrojtjen e

denoncuesve. Ajo është palë në instrumentet ndërkombëtare kundër korrupsionit, Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit. Shqipëria, gjithashtu, ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Konventat e së Drejtës Civile dhe Penale mbi Korrupsionin të Këshillit të Europës, të cilat tani janë pjesë e legjislacionit të saj të brendshëm. Shqipëria, gjithashtu, ka një kuadër ligjor pjesërisht në përputhje me Konventën e OECD-së për Luftimin e Ryshfetit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit, megjithëse ende nuk e ka ratifikuar atë.

Pavarësisht këtij legjislacioni gjithëpërfshirës për të luftuar korrupsionin, korniza ligjore e Shqipërisë duhet të jetë plotësisht në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet europiane, veçanërisht në fushat e konfliktit të interesit, financimit të partive politike, donacioneve dhe sponsorizimeve, mbrojtjes së



denoncuesve, luftës kundër mashtrimit dhe sekuestrimit të asetëve dhe konfiskimit të tyre. Shqipëria nuk është ende anëtare e Rrjetit Europian të Pikave të Kontaktit kundër Korrupsionit.

Ndërkohë që janë ndërmarrë hapa për të rritur efikasitetin në parandalimin e korrupsionit, siç është përparimi drejt përafrimit të legjislacionit për konfliktin e interesit me standardet europiane, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar plotësisht ligjet për mbrojtjen e sinjalizuesve, lobimin, donacionet dhe financimin e partive politike me standardet europiane.

Ligji, “Për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” përmban rregulla për raportimin e një akti të dyshuar korrupsioni nga sinjalizuesit në sektorin publik dhe privat, përcakton mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe përcakton detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin. Janë miratuar akte nënligjore dhe akte të tjera ligjore të nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë të ligjit. Megjithatë, ligji për sinjalizimin është pjesërisht në përputhje me Direktivën (BE) 2019/1937. Shqipëria ka kërkuar pjesëmarrje në Grupin e Ekspertëve për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe në Rrjetin Europian të Pikave të Kontaktit kundër Korrupsionit.

Lidhur me kornizën institucionale, janë ndërmarrë disa hapa organizativë. Drejtoria e Përgjithshme Kundër Korrupsionit është transferuar nga Ministria e Drejtësisë tek Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Korrupsionin në qershor 2024. DPKK-ja iu nënshtrua një riorganizimi të kapaciteteve që merren me hetimin administrativ dhe vlerësimin e riskut, si dhe i kushtoi më shumë rëndësi parandalimit. Të gjitha ministritë e linjës tashmë i kanë miratuar planet e tyre të integritetit.

Janë bërë përpjekje, veçanërisht në fushat me rrezik të lartë për korrupsion, por zbatimi efektiv ende kërkon që të demonstrohet. Koordinimi midis institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit dhe strukturave përkatëse të zbatimit të ligjit duhet të forcohet më tej.

Masat për rekrutimin bazuar në meritë dhe për rritjen e pagave u vendosën në nivel qendror. Megjithatë, dispozitat që lidhen me rekrutimin, avancimin në detyrë dhe shkarkimin në bazë të meritës duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha nivelet.

Shqipëria ka marrë masa për të siguruar digjitalizim më të madh të shërbimeve të saj për të forcuar luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu, Policia e Shtetit ka një platformë që lejon raportimin anonim të veprimeve të paligjshme dhe korrupsionit.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është përgjegjëse për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave të dyshuara penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe strukturës për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka rritur aktivitetet e saj me qëllim sigurimin e integritetit të personelit policor.

Janë iniciuar disa masa kundër korrupsionit, përfshirë rishikimin e Ligjit për Policinë, së bashku me disa reforma strukturore. Janë krijuar mekanizma për të monitoruar aktivitetin e agjencive kufitare, duke përfshirë strukturat antikorrupsion në agjencitë kufitare, instalimin e kamerave në pikat e kalimit kufitar dhe zbatimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në kryerjen e procedurave kufitare, si dhe një sërë masash të tjera në këtë fushë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 10.1

Forcimi i kuadrit kundër korrupsionit dhe integritetit në të gjitha autoritetet përkatëse të *Schengen*-it duke zbatuar reforma konkrete ligjore dhe strukturore, dhe garantimi i proceseve të drejta, transparente dhe të bazuara në meritë gjatë rekrutimit dhe përparimit në karrierë.

MASA 10.1.1	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Rishikimi i legjislacionit përkatës dhe forcimi i kapaciteteve institucionale	Efektivitet dhe transparencë e përmirësuar e autoriteteve në parandalimin dhe adresimin e korrupsionit

NR.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
10.1.1.1	Rishikimi i kuadrit ligjor për të përafruar plotësisht ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, me standardet europiane.	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin	2026	Buxheti i Shtetit	Ndryshimet ligjore të miratuara	
10.1.1.2	Forcimi i rolit të auditimeve të brendshme	Të gjitha institucionet	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit	Rritje e përqindjes së	



	dhe të jashtme, si dhe inspektimeve, në parandalimin e korrupsionit.	Dogana			rekomandimeve të auditimit dhe inspektimit që lidhen me parandalimin e korrupsionit, të cilat zbatohen nga institucionet publike. - Numri ose përqindja e auditimeve dhe inspektimeve që identifikojnë rreziqe ose parregullsi të lidhura me korrupsionin - Numri i rasteve të lidhura me korrupsionin të referuara nga organet e auditimit ose inspektimit tek autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit	
10.1.1.3	Përmirësimi i cilësisë dhe zbatimit të planeve të veprimit për integritetin, të përcaktuara në nivel qendror dhe lokal, në ato autoritete shtetërore që janë më të prirura ndaj korrupsionit.	Të gjitha institucionet Dogana	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit	- Shkalla e zbatimit të masave të planit të veprimit për integritetin në të gjitha autoritetet e synuara - Numri i planeve të integritetit të shqyrtuara dhe të përmirësuara bazuar në vlerësimet e standardizuara të cilësisë	
10.1.1.4	Rritja e kapaciteteve institucionale për planifikim, koordinim dhe monitorim efektiv të përpjekjeve kundër korrupsionit	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Dogana Të gjitha institucionet	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit	Numri i aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve (p.sh., trajnime). Numri i stafit të trajnuar në aspektet e planifikimit, koordinimit ose monitorimit të antikorrupsionit. Përqindja e stafit në institucionet kyçe me aftësi të përmirësuara teknike në vlerësimin e rrezikut të korrupsionit dhe reagimin ndaj tij.	
10.1.1.5	Forcimi i koordinimit midis institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit dhe strukturave përkatëse të zbatimit të ligjit	Të gjitha institucionet	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit	- Numri i iniciativave ose operacioneve të përbashkëta të kryera çdo vit midis organeve të parandalimit të korrupsionit dhe agjencive të zbatimit të ligjit.	



					- Përmirësimi i protokolleve ose bazave të të dhënave për ndarjen e informacionit midis agjencive.	
--	--	--	--	--	--	--

KAPITULLI 11

BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJET PENALE

Shqipëria është palë në konventat përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Europës. Shqipëria ka marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim gjyqësor në çështjet penale me një numër vendesh të treta, disa prej të cilave mbulojnë ekstradimin dhe transferimin e personave të dënur.

Bashkëpunimi gjyqësor si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale është i kënaqshëm dhe ka treguar një rritje në të dyja fushat, me një rritje si të kërkesave dalëse ashtu edhe të atyre hyrëse. Numri i ekipeve të përbashkëta hetimore është rritur. Bashkëpunimi me Zyrën e Prokurorit Publik Europian (EPPO) është krijuar. Shqipëria është vëzhguese në Rrjetin Europian të Trajnimit Gjyqësor dhe ka statusin e vendit kandidat të BE-së në rrjetin europian gjyqësor. EPPO-ja ka përfunduar një marrëveshje pune me Prokurorinë e Përgjithshme dhe me Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit.

Marrëveshja e bashkëpunimit me *Eurojust*-is, e cila hyri në fuqi më 1 nëntor 2019, ka lehtësuar më tej bashkëpunimin gjyqësor midis Shqipërisë dhe BE-së në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar. Megjithatë, Shqipëria synon të përmirësojë më tej bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, zbatimin në kohë të instrumenteve shumëpalëshe dhe kapacitetin e saj institucional. Përpjekje të tilla duhet të bëhen së bashku me përpjekje të mëtejshme për të përafruar legjislacionin me *Acquis* të BE-së dhe për të promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor.

Që nga emërimi i Prokurorit Lidhës shqiptar në Hagë në vitin 2021, është vërejtur një rritje e qëndrueshme e numrit të rasteve të hapura në Eurojust, shumica e të cilave lidhen me trafik droge, pastrim parash, mashtrim dhe krim të organizuar. Shqipëria është vendi i Ballkanit Perëndimor që ka marrë pjesë në numrin më të madh të ekipeve të përbashkëta hetimore në Eurojust.

Korniza ligjore dhe institucionale e Shqipërisë është pjesërisht e përafruar me *acquis* të BE-së. Mbeten boshllëqe, veçanërisht në lidhje me dispozitat mbi të drejtat procedurale në procedurat e Urdhër-Arrestit Europian. Në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike, legjislacioni është, gjithashtu, pjesërisht i përafruar me *acquis* të BE-së.

Legjislacioni mbi parimin e njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në çështjet penale është pjesërisht i përafruar me *acquis* të BE-së. Në mënyrë të ngjashme, legjislacioni mbi rekordet kriminale është, gjithashtu, vetëm pjesërisht i përafruar me *acquis* të BE-së.

Kapaciteti administrativ synohet të forcohet për të përmbushur kërkesat e BE-së për bashkëpunim gjyqësor në çështjet penale dhe për të siguruar përpunimin në kohë të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike. Kjo do të ndihmojë në hedhjen e themeleve për bashkëpunim të ardhshëm bazuar në parimin e njohjes së ndërsjellë. Do të alokohen burime të mjaftueshme njerëzore dhe institucionale për të mbështetur bashkëpunimin efektiv gjyqësor dhe për të përmirësuar efikasitetin e trajtimit të kërkesave.

OBJEKTIVI SPECIFIK 11.1

Rritje e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor

MASA 11.1.1	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Harmonizim i legjislacionit dhe rritja e kapaciteteve institucionale	Efektivitet dhe efikasitet i përmirësuar i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar përmes kornizave ligjore të harmonizuara dhe kapacitetit të shtuar institucional.

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
11.1.1.1	Kryerja e analizës së hollësishme ligjore të <i>acquis</i> të BE-së në fushën e bashkëpunimit gjyqësor	Ministria e Drejtësisë	2026	Buxheti i shtetit Mbështetja e donatorëve (IPA etj.)	Një analizë e detajuar e përfunduar	



	për të identifikuar ndryshimet e nevojshme që duhen bërë në kuadrin ligjor shqiptar.					
11.1.1.2	Përafrimi i kuadrit ligjor dhe institucional të Shqipërisë me <i>acquis</i> të BE-së në fushën e bashkëpunimit gjyqësor.	Ministria e Drejtësisë	2027	Buxheti i shtetit	Numri i ligjeve të harmonizuara me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së	
11.1.1.3	Forcimi i kapaciteteve institucionale për të siguruar trajtimin efektiv dhe në kohë të kërkesave për bashkëpunim gjyqësor.	Ministria e Drejtësisë	2026–2027	Buxheti i shtetit	Shtimi i numrit të trajnimeve në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në fushën penale, civile dhe tregtare	
11.1.1.4	Përmirësimi i efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor në lidhje me minimizimin e kohës për zbatimin e kërkesave të bëra nga Shqipëria dhe vendet e huaja për bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar	Ministria e Drejtësisë	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit	Numri i rasteve të bashkëpunimit gjyqësor ndërkufitar të përpunuara me sukses duke përdorur mekanizmat e BE-së	
11.1.1.5	Rritja e kapacitetit njerëzor të strukturave për t'u përshatur me standardet e BE-së për bashkëpunimin gjyqësor.	Ministria e Drejtësisë	Vazhdimisht	Buxheti i Shtetit Mbështetja e donatorëve	Numri i stafit të trajnuar në instrumentet dhe procedurat e bashkëpunimit gjyqësor të BE-së	

KAPITULLI 12 VLERËSIMI DHE MONITORIMI

Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit *Schengen* do të jetë një nga aspektet më të rëndësishme në këtë proces. Në këtë kuadër, treguesit e rezultateve që parashikohen për të gjitha masat dhe aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit do të monitorohen me kujdes, për të vlerësuar se sa janë arritur objektivat e vendosur për secilën nga fushat e mbuluara.

Përveç zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara në PVS, monitorimi i vazhdueshëm i performancës së strukturave përgjegjëse për përmbushjen e këtyre detyrimeve është thelbësor. Kjo lejon një analizë të saktë të statusit të zbatimit dhe siguron mbikëqyrje efektive të aktiviteteve në vazhdim për të mbështetur përfundimin e tyre me sukses.

Ministria e Punëve të Brendshme/Koordinatori Kombëtar i *Schengen*-it do të jetë institucioni kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen e hartimit, miratimit dhe zbatimit të Planit të Veprimit të *Schengen*-it. Gjithashtu, do të koordinojë të gjithë aktorët politikë dhe teknikë në të gjitha institucionet shtetërore përkatëse të përfshira në proces.

Koordinatori Kombëtar i *Schengen*-it, i mbështetur nga Struktura Drejtuese e *Schengen*-it, e cila përbëhet nga institucione kryesore shtetërore përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve të *Schengen*-it, do të mbikëqyrë të gjithë procesin.

Në këtë mënyrë formalizohen rolet dhe përgjegjësitë specifike të institucioneve të përfshira dhe përcaktohet mandati i Strukturës Drejtuese së *Schengen*-it ku përcaktohet qartë autoriteti i Koordinatorit Kombëtar të *Schengen*-it duke e fuqizuar atë për të koordinuar, mbikëqyrur dhe udhëhequr në mënyrë efektive të gjitha aktivitetet që lidhen me *Schengen*-in në nivel operacional.

Do të ndërmerren hapat e mëposhtëm për të siguruar vlerësimin dhe monitorimin efektiv të Planit të Veprimit *Schengen*:

- Të vlerësohet përmbushja e treguesve të matshëm sasiorë dhe cilësorë;
- Të vlerësohet nëse aktivitetet po japin rezultatet e synuara;
- Të vlerësohet përmbushja e objektivave të vendosur bazuar në rezultatet e pritura dhe të kuptueshme;



- Të sigurohet që rolet dhe përgjegjësitë e strukturave të caktuara për raportim, mbikëqyrje dhe marrje vendimesh të zbatohen;

- Të përgatitet një plan i detajuar me afatet kohore, metodat dhe personelin përgjegjës për ndjekjen e progresit;

- Të mblidhen të dhëna dhe informacione në intervale të paracaktuara (gjysmëvjetore dhe vjetore);

- Të identifikohen tendencat, boshllëqet, vonesat ose rezultatet e papritura;

- Të përgatiten raporte monitorimi të qarta dhe të aksesueshme për palët e interesuara;

- Të përfshihen aktorët kyç në procesin e monitorimit dhe vlerësimit;

- Të planifikohen vlerësime afatmesme dhe përfundimtare për të vlerësuar efektivitetin e përgjithshëm;

- Të përdoren rezultatet e vlerësimit për të përshtatur aktivitetet, afatet kohore ose ndarjen e burimeve.

Procesi i Monitorimit do të kryhet bazuar në raportet që do të dorëzohen nga të gjitha institucionet përgjegjëse për arritjen e objektivave dhe zbatimin e masave përkatëse. Të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit *Schengen* do të ofrojnë raporte periodike, gjashtëmujore dhe vjetore në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Planin e Veprimit.

Ministria e Punëve të Brendshme, në rolin e Koordinatorit Kombëtar të *Schengen*-it do të mbledhë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe vjetore. Struktura e raporteve do të përcaktohet në metodologjinë e monitorimit. Në procesin e analizës, Struktura Drejtuese e *Schengen*-it do të ketë, gjithashtu, rolin e saj.

Raporti i përgjithshëm hartohet nga Ministria e Punëve të Brendshme/Koordinatori Kombëtar i *Schengen*-it. Në varësi të marrëveshjes me Komisionin Europian, do të përcaktohet koha e dorëzimit të raporteve të Planit të Veprimit *Schengen* si pjesë e raportit periodik të progresit të KE-së. Raporte të tjera mund të dorëzohen me kërkesë të Komisionit Europian.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm të fushave specifike, progresi drejt arritjes së objektivave specifike të Planit të Veprimit *Schengen* do të vlerësohet përmes dy vlerësimeve gjithëpërfshirëse:

Vlerësimi afatmesëm për periudhën e parë të zbatimit (2026–2027) do të kryhet në fund të vitit 2027. Ky vlerësim do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Bazuar në gjetjet, do të identifikohen përshtatjet e nevojshme në qasje dhe do të vlerësohet rëndësia e objektivave në përputhje me kontekstin fillestar. Plani i Veprimit, i rishikuar, që mbulon periudhën e mbetur nga viti 2028 deri në vitin 2030, do të zhvillohet bazuar në këtë vlerësim për të mbështetur arritjen e objektivave të përgjithshëm.

Vlerësimi përfundimtar i periudhës së dytë të zbatimit (2028–2030) do të përfshijë një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha veprimeve të ndërmarra dhe ndikimit të tyre të përgjithshëm. Ky vlerësim do të shqyrtojë rezultatet e masave të zbatuara, burimet e investuara dhe masën në të cilën janë arritur rezultatet e pritura. Do të analizohen të dhëna nga burime të ndryshme, duke përfshirë gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimet e ndikimit të programeve në komunitet. Raportet dhe studimet nga organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët, gjithashtu, do të kontribuojnë me njohuri të vlefshme.

OBJEKTIVI SPECIFIK 12.1

Monitorimi efektiv i aktiviteteve të Planit të Veprimit *Schengen* për të garantuar zbatimin e tyre dhe arritjen e objektivave të përcaktuara.

MASA 12.1.1	REZULTATI I PËRGJITHSHËM
Vlerësimi i Mekanizmit të monitorimit dhe progresit	Numri i treguesve të përfunduar Numri i rekomandimeve të dhëna Raportet gjysmëvjetore dhe vjetore Raportet e vlerësimit

Nr.	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI	FONDET E NEVOJSHME/BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESI I REZULTATIT	STATUSI
12.1.1.1	Monitorimi i treguesve të rezultateve	Koordinatori Kombëtar i <i>Schengen</i> -it Struktura Drejtuese e <i>Schengen</i> -it	3 muaj 6 muaj/1 vit	Buxheti i shtetit	Numri i treguesve të përfunduar	



12.1.1.2	Rekomandimi i ndryshimeve në aktivitetet ndërsektoriale	Koordinatori Kombëtar i Schengen-it Struktura Drejtuese e Schengen-it	Vazhdimisht	Buxheti i shtetit	Numri i rekomandimeve	
12.1.1.3	Përgatitja e raporteve 6-mujore dhe vjetore	Të gjitha institucionet	6 muaj 1 vit	Buxheti i shtetit	Raportet gjysmëvjetore të përgatitura	
12.1.1.4	Përgatitja e vlerësimit afatmesëm	Koordinatori Kombëtar i Schengen-it Struktura Drejtuese e Schengen-it	2027	Buxheti i shtetit	Vlerësimi i përgatitur	
12.1.1.5	Përgatitja e vlerësimit përfundimtar	Koordinatori Kombëtar i Schengen-it Struktura Drejtuese e Schengen-it	2030	Buxheti i shtetit	Vlerësimi i përgatitur	

URDHËR**Nr. 61, datë 19.1.2026****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Për shkak të angazhimeve për të garantuar vijimësinë e veprimtarisë administrative të Ministrisë, delegoj të drejtën e firmës për të gjitha dokumentet dhe aktet që lidhen me procedurat e importeve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit, z. Fatmir Guri, për periudhën 19.1.2026 deri më datë 4.2.2026.

2. Zëvendësministri i përmendur në pikën 1 është i autorizuar të nënshkruajë në emër të ministrit dokumentet që lidhen me importet, si më poshtë:

- kërkesat dhe miratimet për importe sipas kompetencës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Autorizimet, vërtetimet dhe shkresat zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore dhe subjekteve private për çështje që lidhen me importet;

- Çdo dokument tjetër administrativ që kërkon firmën e ministrit në fushën e importeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ky delegim është i vlefshëm vetëm për periudhën 19.1.2026 deri më datë 4.2.2026. Pas kësaj date, e drejta e firmës kthehet tek ministri sipas kompetencave të tij të plota ligjore.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, drejtoria përgjegjëse për importet dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

5. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv-protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin, sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR**Nr. 62, datë 19.1.2026**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E FRANCËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:



- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Hauts-de-France	Pas-de-Calais	Calais*
2.	Pays de la Loire	Maine-et-Loire	Cholet*
3.	Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Châteaubriant*
4.	Pays de la Loire	Vendée	Fontenay-le-Comte*
5.	Nouvelle-Aquitaine	Lot-et-Garonne	Nérac*
6.	Grand Est	Haute-Marne	Saint-Dizier*
7.	Centre-Val de Loire	Cher	Bourges*
8.	Auvergne-Rhône-Alpes	Allier	Moulins*
9.	Auvergne-Rhône-Alpes	Loire	Montbrison*
10.	Bourgogne-Franche-Comté	Côte-d'Or	Beaune*
11.	Bourgogne-Franche-Comté	Côte-d'Or	Dijon*
12.	Grand Est	Mame	Vitry-le-François*
13.	Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Nantes*
14.	Pays de la Loire	Vendée	Les Sables-d'Olonne*
15.	Pays de la Loire	Vendée	La Roche-sur-Yon*
16.	Nouvelle-Aquitaine	Deux-Sèvres	Bressuire*
17.	Nouvelle-Aquitaine	Deux-Sèvres	Parthenay*
18.	Nouvelle-Aquitaine	Dordogne	Périgueux*
19.	Auvergne-Rhône-Alpes	Ain	Bourg-en-Bresse*
20.	Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Saint-Nazaire*
21.	Nouvelle-Aquitaine	Haute-Vienne	Bellac*
22.	Ile-de-France	Yvelines	Rambouillet*
23.	Nouvelle-Aquitaine	Dordogne	Bergerac*
24.	Hauts-de-France	Somme	Abbeville*
25.	Centre-Val de Loire	Loir-et-Cher	Romorantin-Lanthenay*
26.	Nouvelle-Aquitaine	Landes	Dax*
27.	Bretagne	Finistère	Morlaix*
28.	Normandie	Calvados	Bayeux*
29.	Bretagne	Côtes-d'Armor	Saint-Brieuc*
30.	Hauts-de-France	Nord	Dunkerque*
31.	Drôme*	-	-
32.	Vendée*	-	-
33.	Deux-Sèvres*	-	-
34.	Loire-Atlantique*	-	-
35.	Lot-et-Garonne*	-	-
36.	Allier*	-	-

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të

shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 44, datë 13.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 63, datë 20.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Gorj	Calnic*	
Gorj	Capreni*	
Gorj	Crasna*	
Gorj	Turburea*	
Sibiu	Cisnadic*	
Sibiu	Orlat*	
Timiş	Liebling*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me

nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe



ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 46, datë 13.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i

Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 64, datë 20.1.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i) 65 °C në 39.8 sekonda;

ii) 70 °C në 3.6 sekonda;

iii) 74 °C në 0.5 sekonda;



iv) 80 °C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasieczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wołomin	Thuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżeń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniadz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*

42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomysl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomysl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuly	Duszniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Plonawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytoń*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzetnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njofim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të



informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 40, datë 13.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 68, datë 21.1.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SPANJËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) mishit të freskët;
- ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë

përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65 °C në 39.8 sekonda;
- ii. 70 °C në 3.6 sekonda;
- iii. 74 °C në 0.5 sekonda;
- iv. 80 °C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Castello de Rugat*
2.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Ontinyent*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Spanjës, të cilat nuk kanë pasur njohim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit



biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 20, datë 9.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 69, datë 21.1.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E LETONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha

kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinës, ushqimit të thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Dienvidkurzemes	Vaiņodes pagasts*	
Kurzemes	Tukuma	Dzūkstes*
Kurzemes	Talsu	Ģibuļu*
Latgales	Augšdaugavas	Līksnas*
Vidzemes	Madonas	Cesvaines*
Vidzemes	Madonas	Kalsnavas*
Vidzemes	Ogres	Lauberes*
Vidzemes	Valkas	Ērgemes*
Zemgales	Bauskas	Iecavas*
Zemgales	Dobeles	Tērvetes*
Zemgales	Jelgavas	Glūdas*
Zemgales	Bauskas	Dāviņu*
Rīgas	Mārupes	Babītes*
Rīgas	Mārupes	Salas*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Letonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.



2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**



a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të

derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 7, datë 5.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Letonisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri



VENDIM
Nr. 67, datë 5.11.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 4.11.2025
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 4 (A) 2025 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aleksandër Fadili, përfaqësuar nga
avokat Fran Dashi, me akt përfaqësimi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga
prokuror Alfred Progonati, me autorizim.

Fatime Fejzillari, Petrit Fejzillari

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 867-128,
datë 5.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Kurbini; nr. 218, datë 14.5.2021, të Gjykatës së Apelit
Tiranë; nr. 00-2024-1782, datë 5.11.2024, të Kolegjit
Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1,
shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika
1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
(*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të
Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë
10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,
i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini,
mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit
Aleksandër Fadili (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar
pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të
interesuara, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Fatime
e Petrit Fejzillarit (prindërit/trashëgimtarët e

viktimit), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si
dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi në datën 30.4.2018 është paraqitur në
Komisariatit e Policisë Kurbini për të bërë kallëzim
penal, pasi një ditë më parë, në datën 29.4.2018,
shoku i tij, shtetasi F.F., me të cilin e kishte lënë të
takohej në orën 18:00 në qytetin e Laçit, kishte
humbur kontaktet me të. Kërkuesi në kallëzimin e
tij ka dhënë shpjegime se me shtetasin F.F. ka qenë
shokë fëmijërie dhe se të dy, pjesë e komunitetit
rom, punonin me tregtimin e rrobave të përdorura
(perde, tyle e çarçafë). Sipas tij, megjithëse e kishte
kërkuar gjithë natën, nuk kishte mundur ta gjente.
Gjithashtu, po sipas shpjegimeve të kërkuarit,
shtetasi F.F. kishte pasur me vete 270.000 lekë,
gjysma e të cilave i përkiste atij.

2. Fillimisht, Prokuroria pranë Gjykatës së
Rrethit Gjyqësor Kurbini (*Prokuroria e Kurbinit*) në
datën 2.5.2018, mbi bazën e materialit kallëzues të
dërguar nga Komisariati i Policisë Kurbini, ka ngritur
dyshime se shtetasi F.F. mund të jetë marrë peng nga
persona të tjerë, për shkak të problemeve me lojërat
e fatit. Për sqarimin e rrethanave Prokuroria e
Kurbinit ka kërkuar kryerjen e veprimeve të tjera
hetimore, si dhe bazuar në të dhënat/provat e
grumbulluara ka regjistruar procedimin penal për
veprën penale “Heqja e paligjshme e lirisë”.

3. Në datën 15.5.2018, pas veprimeve hetimore
të kryera për këtë çështje, Prokuroria e Kurbinit ka
urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i
atribuohet vepra penale, pasi, sipas saj, janë krijuar
dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se
shtetasi F.F. është vrarë me qëllim vjedhjen e
shumës të të hollave që kishte pasur me vete dhe
dyshohej se autor i këtij veprimi ishte shoku i tij,
kërkuesi. Mbi këtë bazë, prokuroria ka marrë të
pandehur kërkuesin, si personi i fundit që ka pasur
kontakt me shtetasin F.F., duke e akuzuar për
veprën penale “Vjedhja me pasojë vdekjen”, të
parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal (*KP*). Në
datën 15.8.2018 prokuroria ka marrë vendim për
zgjatjen e afatit të hetimeve. Pas përfundimit të
hetimeve, prokurori, me kërkesën e datës 4.12.2018,



e ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 867-128, datë 5.7.2019, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me pasojë vdekjen”, të parashikuar nga neni 141 i KP-së dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim. Pas ankimit të kërkuarit dhe trashëgimtarëve të viktimës/prindërve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 218, datë 14.5.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimin nr. 867-128, datë 5.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Pas rekursit të kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1782, datë 5.11.2024, ka vendosur mospranimin e tij, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Kërkuari në datën 21.1.2025 (*data e shërbimit postar*) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pas plotësimit sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 31.1.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 8.4.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

6.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi në rekurs janë paraqitur pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, por Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje atyre, megjithëse janë me natyrë kushtetuese. Pretendimet e ngritura gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes.

6.1.2. *Parimit të paanshmërisë*, për shkak se gjyqtarja relatore Z.S. në Gjykatën e Apelit Tiranë ka manipuluar mënyrën për caktimin e datës së seancës gjyqësore. Vetëm pasi kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit, për shkak të kohëzgjatjes të afateve të paraburgimit, gjyqtarja relatore ka vepruar me shpejtësi për caktimin e datës së seancës gjyqësore për themelin e çështjes, pa respektuar rregullat procedurale të regjistrimit të

datës në serverin e gjykatës dhe pa e afishuar atë në tabelën e njoftimit të datave në hyrje të gjykatës. Në datën 5.5.2021 gjyqtarja ka caktuar datën e seancës gjyqësore, duke njoftuar vetëm avokatin K.S. (që ka përfaqësuar kërkuarin në shkallën e parë), kurse avokati F.D. (që ka përfaqësuar kërkuarin në gjykimin në apel) është njoftuar nga familjarët e kërkuarit. Gjithashtu, në seancën për gjykimin e themelit të çështjes është kërkuar të gjykohej fillimisht çështja për shuarjen e masës së sigurimit, por kërkesa është refuzuar nga gjyqtarja Z.S. Kjo gjyqtare është kallëzuar nga avokati F.D. për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”. Në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë edhe gjyqtarja E.L., ish-bashkëshortja e gjyqtarit G.H., që ka gjykuar të njëjtën çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Vetë gjyqtarja E.L. i ka paraqitur kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, por kjo kërkesë nuk është pranuar. Ndërsa gjyqtarja E.T., po pjesë e trupit gjykues në gjykatën e apelit, është kallëzuar penalisht nga shtetasja M.H., e cila përfaqësohet nga avokati i kërkuarit në një çështje që pritet për t’u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë.

6.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka riparuar shkeljet e proceseve gjyqësore të zhvilluara në shkallët e tjera. Në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk janë paraqitur shkaqet e rekursit, për të cilat kërkuari ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, fakt që krijon dyshime për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit. Gjithashtu, në përmbajtje të vendimit është cituar se kërkuari ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit, kur në fakt ai ka kundërshtuar vendimet e të dyja shkallëve më të ulëta. Kolegji Penal, në mënyrë absurde, ka refuzuar kalimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

6.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 32 i Kushtetutës, pasi kërkuari është dënuar pa prova. Në rastin e dhënies së dënimeve ekstreme, për vepra penale të rënda, duhet të ketë prova bindëse dhe në unitet me njëra-tjetrën, si dhe procesi nuk mund të fillojë me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin që akuzohet. Akti i ekspertimit të ADN-së nuk mund të përdoret si provë, pasi nuk përcakton kohën, mënyrën dhe vendin ku janë



gjetur njollat e gjakut. Njollat e gjakut janë gjetur në makinë, për shkak të një aksidenti që ka kryer F.F. dhe prokuroria nuk ka hetuar për këtë rrethanë. Makina përdorej nga kërkuesi, pasi megjithëse ishte në pronësi të viktimës, ky i fundit nuk kishte leje drejtimi. Viktima nuk gëzon statusin e personit të zhdukur, madje sipas akteve të gjendjes civile rezulton të jetë i gjallë. Pra, ende nuk ka një viktimgë, një vendngjarje, akt të ekspertimit mjeko-ligjor ose edhe vendim gjykate që të provojë se shtetasi F.F. është person i zhdukur ose të ketë humbur jetën. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 876, datë 21.12.2005 ka mbajtur qëndrimin se nuk mund të pranohet fajësia e një personi të akuzuar për kryerjen e një veprë penale vetëm me një provë, cilado qoftë ajo, edhe nëse është shkencore, nëse nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë.

6.3. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë shkelur dispozitat procedurale lidhur me marrjen dhe vlerësimin e provave e një fakt i tillë ka sjellë një vendim të padrejtë dhe të pambështetur në prova e ligj. Gjykata e Apelit Tiranë kishte detyrimin për të bërë hetim të ngjarjes, sepse Prokuroria e Apelit Tiranë është mjaftuar me ato çfarë kanë shkruar punonjësit e policisë dhe Prokuroria e Kurbinut, pa u thelluar në hetimin e faktit.

7. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka paraqitur prapësime me shkrim, duke argumentuar, si vijon:

7.1. *Pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë*, për shkak se gjyqtarët e gjykatës së apelit kanë qenë në konflikt interesi, është i pabazuar. Gjyqtarët janë të detyruar të zbatojnë rregullat e paanshmërisë, dhe nëse nuk ka prova të drejtpërdrejta që provojnë se lidhjet personale të tyre kanë ndikuar në vendim, kjo nuk mund të konsiderohet shkelje. Edhe pretendimi se gjykata e apelit (gjyqtarja relatores) ka shkelur rregullat procedurale për caktimin e datës së seancës gjyqësore dhe njoftimin e palëve nuk është i bazuar. Në rastin konkret kërkuesi nëpërmjet mbrojtësit të tij ka marrë pjesë në gjykim dhe ka parashtruar argumentet duke realizuar mbrojtjen e tij. Edhe nëse do të vërtetoheshin shkelje, ato nuk kanë qenë të tilla që të kenë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Parregullsitë formale që mund të ndodhin në procesin gjyqësor, sikurse pretendohet mosafishimi i datës së gjykimit, nuk çojnë automatikisht në cenimin e procesit gjyqësor, pasi

kërkuesi duhet të provojë dëmin e drejtpërdrejtë që i ka ardhur nga këto parregullsia. Pretendimit për shkeljen e rregullave për t'u njoftuar i ka dhënë përgjigje edhe Gjykata e Lartë.

7.2. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar*. Arsyetimi i vendimit ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete, natyrës së vendimit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, sipas rregullit të përcaktuar në nenin 436/a të KPP-së, e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit, duke arsyetuar në vendim shkaqet e ngritura në rekurs. Vendimi është i mirarsyetuar dhe në të janë trajtuar me hollësi pretendimet e kërkuesit. Arsyetimi kryesisht është përqendruar rreth pretendimit thelbësor të kërkuesit, i cili lidhet me vlerësimin e provave nga dy gjykatat më të ulëta. Referuar akteve të dosjes pretendimet e kërkuesit nuk gjejnë mbështetje në to dhe në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë janë pasqyruar të gjitha shkaqet e rekursit.

7.3. *Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë* ka të bëjë me vlerësimin e provave nga gjykatat e faktit sipas nenit 152 të KPP-së, mbi të cilat është disponuar për fajësinë e kërkuesit. Marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksionin e gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues, si dhe në rastin konkret nuk konstatohen të dhëna ose indicie që të tregojnë zbatim arbitrar të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë ka arsyetuar në lidhje me pretendimin se kërkuesi është dënuar vetëm mbi bazë të një prove, duke arsyetuar se përveç provës së ADN-së ka edhe prova të tjera, të cilat të çmuara në harmoni me njëra-tjetrën kanë krijuar bindjen për provueshmërinë e akuzës.

8. **Subjektet e interesuara, Fatime Fejzillari dhe Petrit Fejzillari**, kanë paraqitur prapësime me shkrim, si vijon:

8.1. Kërkuesi është personi i fundit që e ka parë shtetasin F.F. dhe nga data 29.4.2018 e në vazhdim ai rezulton i zhdukur. Prokurori i caktuar për këtë çështje nuk ka ushtruar ndjekjen penale ndaj kërkuesit dhe shtetasve të tjerë, të afërm të tij, të cilët kanë kryer veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës". Gjithashtu, kërkuesi ka konsumuar elementet e veprës penale "Fshehja ose asgjësimi i kufomës". Prokurori, në kundërshtim me ligjin, u ka caktuar avokat kryesisht personave që janë pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për



rrethanat e ngjarjes, konkretisht kërkuesit dhe dy të afërmve të tij, shtetasve A.F. dhe Xh.F. Për këtë arsye, ndaj prokurorit dhe oficerit të Policisë Gjyqësore është bërë kallëzim penal për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Ndërsa për shtetasit A.F. dhe Xh.F. është bërë kallëzim penal për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”. Për këtë kallëzim penal, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbën dhe kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme sipas detyrave të lëna në pjesën arsyetuese të vendimit për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” dhe “Fshehja ose asgjësimi i kufomës”. Por deri në datën 30.4.2025 vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër nuk është zbardhur/arsyetuar ende. Kërkuesi është person me rrezikshmëri të lartë dhe në raste analoge (të hetuara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar) personat janë dënuar edhe për fshehjen dhe asgjësimin e kufomës, por ndaj kërkuesit nuk është ngritur kjo akuzë, ndoshta për arsye profesionale ose të lidhura me diskriminimin, pasi kërkuesi i përket komunitetit rom. Gjithashtu, nga kërkuesi janë depozituar edhe certifikata personale dhe familjare të subjekteve të interesuara, duke vënë në dyshim respektimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, por për këtë do të merren masa sipas ligjit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë

themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse/i dënuar në procesin gjyqësor penal ndaj të cilit ka ngritur pretendime.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm. Në përmbajtje të ankimit kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, edhe pretendimin *për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, duke parashtruar vetëm në mënyrë të përgjithshme se ka pasur shkelje të ligjit procedural në mënyrën e marrjes së provave gjatë hetimit ose gjykimit të çështjes së tij, por pa parashtruar argumente konkrete për këtë lloj shkeljeje. Gjykata konstaton se kërkuesi nuk e ka parashtruar këtë pretendim në ankimin e paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë, as në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë, ndonëse e ka përmendur me fjalë të përgjithshme se është shkelur ligji për mënyrën e marrjes së provave (*shih fagen 12 të rekursit të paraqitur në Gjykatën e Lartë*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se për pretendimin *për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme* kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Për pretendimet e tjera, Gjykata konstaton se kërkuesi i ka shteruar si në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual².

² Gjyqtarja Sonila Bejtja, në ndryshim nga shumica, për këtë pretendim votoi me qasjen se kërkuesi nuk ka paraqitur

argumente të mjaftueshme kushtetuese dhe për këtë arsye ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.



12. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 5.11.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 21.1.2025, për rrjedhojë kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar pretendime për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në aspekt të parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të së drejtës së aksesit nga Gjykata e Lartë, si dhe për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

14. Gjykata vëren se për pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkuesi ka parashtruar dy argumente: i. gjyqtarja relatore ka manipuluar rregullat për caktimin e datës së seancës gjyqësore dhe njoftimin ia ka dërguar vetëm avokatit që ka përfaqësuar kërkuenin në shkallën e parë, ndërsa avokati që e ka përfaqësuar në apel është njoftuar nga familjarët; ii. në përbërje të trupit gjykues në gjykatën e apelit ka pasur dy gjyqtare në kushtet e papajtueshmërisë.

15. Për argumentin e parë, për shkeljen e rregullave të njoftimit të datës së seancës, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për efekt të gjykimit kushtetues rezulton se për seancën e datës 11.5.2021, ora 14:00, që do të zhvillohej në gjykatën e apelit, me njoftimin nr. 3969 akti, datë 6.5.2021 për kërkuenin është njoftuar dhe ka firmosur se ka marrë dijeni avokati K.S., që e ka përfaqësuar gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja relatore ka njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për shoqërimin e kërkuetit. Seanca gjyqësore e datës 11.5.2021, ku kërkuesi ka qenë i pranishëm, është shtyrë për në datën 14.5.2021, për shkak të mungesës së prokurorisë dhe trashëgimtarëve të viktimës. Edhe gjatë seancës së datës 14.5.2021 kërkuesi ka qenë përsëri i pranishëm. Në rrethanat kur kërkuesi ka qenë i pranishëm gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe ka pasur mundësi për të parashtruar mbrojtjen e tij, Gjykata vlerëson se ai nëpërmjet argumenteve të paraqitura nuk ka provuar cenimin e të drejtave të tij

kushtetuese, për rrjedhojë pretendimi është haptazi i pabazuar.

16. Për argumentin e dytë, Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar dy fakte: se i. njëra nga gjyqtaret e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë është kallëzuar penalisht nga shtetasja M.H., e cila përfaqësohet nga avokati i kërkuetit në një çështje që pritët për t’u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë; ii. gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë gjyqtarja E.L. ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë, si ish-bashkëshorte e gjyqtarit G.H., që ka qenë pjesë e trupit gjykues gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

17. Në lidhje me faktin e parë, Gjykata vëren se shtetasja M.H. nuk ka asnjë lidhje si me kërkuenin, po ashtu edhe me shtetasin F.F./viktimën, dhe çështja së cilës i referohet kërkuesi nuk ka lidhje me rastin në shqyrtim. Vetëm fakti që kërkuesi dhe shtetasja M.H. përfaqësohen në gjykime të ndryshme nga i njëjti avokat, nuk përbën argument në nivel kushtetues në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

18. Në lidhje me faktin e dytë, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar se në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë gjyqtarja E.L., (ish) bashkëshortja e gjyqtarit G.H., që ka gjykuar të njëjtën çështje në Gjykatën e Rrethit e Gjyqësor Kurbin. Për këtë pretendim nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se gjyqtarja E.L. i ka paraqitur kryetarin të gjykatës së apelit kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes. Pas shqyrtimit të kërkesës, kryetari i gjykatës së apelit, me vendimin nr. 919 prot., datë 12.5.2021, ka vendosur mospranimin e saj, duke vlerësuar se shkaku i parashtruar për paanshmëri nga kërkuesi se në shkallë të parë ai është gjykuar nga gjyqtari G.H., nuk parashikohet nga neni 17 i KPP-së, pasi mes tij dhe gjyqtarës E.L. është zgjidhur martesë me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe për këto arsye pretendimi i kërkuetit për paanshmëri ka qenë i pabazuar. Ky pretendim është vlerësuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila, pasi e ka marrë në shqyrtim, i ka dhënë kërkuetit përgjigje të arsyetuar se nuk rezulton të mos jenë respektuar garancitë e procesit të rregullt.

19. Në vijim të standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për parimin e paanshmërisë, në kuptim të nenit 42, pika 2, të



Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 49, datë 10.7.2015; nr. 11, datë 2.4.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Referuar fakteve konkrete, Gjykata vlerëson se në drejtim të testit subjektiv, për bindjen e brendshme të gjyqtarës, parashtrimi i kërkuesit se parimi i paanshmërisë është cenuar vetëm se në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë gjyqtarja E.L.L., ish-bashkëshortja e gjyqtarit G.H. (pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen e tij në gjykatën e shkallës së parë), nuk provon të kundërtën e prezumimit se gjyqtarja ka qenë e paanshme. Edhe për sa i përket testit objektiv, Gjykata konstaton se në kohën e gjykimit midis gjyqtarës së apelit E.L.L. dhe gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë G.H. nuk ka pasur lidhje familjare që të vinin në dyshim që gjyqtarja E.L.L. do të cenonte parimin e paanshmërisë në gjykimin e çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë është haptazi i pabazuar³

20. Gjykata konstaton se në drejtim të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të

pafajësisë, të cilin në thelb kërkuesi e ka ndërlidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, kërkuesi ka parashtruar të njëjtat argumente të cilat në mënyrë të përmblodhur janë si në vijim, se: i. është dënuar pa prova; ii. vetëm analiza e ADN-së nuk mjafton nëse nuk shoqërohet me prova të tjera; iii. nuk është gjendur asnjëherë viktima; iv. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje kërkimeve të tij për parimin e prezumimit të pafajësisë; v. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në raste të ngjashme, sikurse është vendimi nr. 876, datë 21.12.2005, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin është shprehur se nuk mund të pranohet fajësia e një personi të akuzuar për kryerjen e një veprë penale vetëm me një provë, cilado qoftë ajo, edhe shkencore, nëse nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë. Lidhur me këtë argument të fundit, Gjykata vëren se, pavarësisht se kërkuesi e ka parashtruar atë në drejtim të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, në thelb ai lidhet me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit. Në këtë drejtim Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të mbështesë *a priori* pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 17, datë 23.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në rastet e ekzistencës së vendimeve njësuere/unifikuese, gjykatat, duke mos analizuar çështjen konform këtyre vendimeve, cenohet parimi i sigurisë juridike të kërkuesit për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate (*shih vendimet nr. 64, datë 23.10.2025; nr. 47 datë 11.6.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj në kushtet kur kërkuesi nuk ka argumentuar nëse

³ Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi se ky pretendim është haptazi i pabazuar me arsyetim paralel sipas qasjeve të mbajtura prej saj në vendimet e mëparshme (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese; nr. 103, datë 17.5.2023 të Mbledhje së Gjyqtarëve*). Në konsideratë të kësaj qasjeje, nga materialet e dosjes gjyqësore ka rezultuar se gjyqtarja E.L.L. (pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë) ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi, e Faqe | 2022

cila është shqyrtuar nga kryetari i gjykatës së apelit, që ka arsyetuar rregullisht duke dhënë përgjigje për rrëzimin e saj. Gjyqtarja Sonila Bejtja konstaton se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë pretendim, për rrjedhojë asnjë fakt ose provë në lidhje me parregullsinë e procesit gjyqësor, ku është shqyrtuar kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi të gjyqtarës E.L.L.



vendimi i referuar prej tij është njësuës/unifikues i praktikës gjyqësore, pra që të jetë i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pretendimi i tij është haptazi i pabazuar.

21. Për rrjedhojë, argumentet e tjera të kërkuarit në vijim Gjykata do t'i analizojë në këndvështrim të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuarisi ka parashtruar se është dënuar pa prova, por vetëm mbi bazën e dyshimeve, pasi trupi i viktimës nuk është gjendur asnjëherë, madje ende sot, sipas akteve të gjendjes civile, rezulton i gjallë. Vetëm analiza e ADN-së për njollat e gjakut të gjendura në sediljen e makinës nuk mund të përdoret, nëse nuk shoqërohet me prova të tjera. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë zhvilluar procesin me bindjen se kërkuarisi e ka kryer veprën penale, duke e prezumuar të vdekur shtetasin F.F. Gjithashtu, sipas tij, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs për (pa)fajësinë e tij.

23. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pretendimi ka të bëjë me vlerësimin e provave nga gjykata e faktit mbi të cilat është disponuar për fajësinë e kërkuarit. Marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksionin e gjyqimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues, e në rastin konkret nuk konstatohen të dhëna ose indicie që të tregojnë zbatim arbitrar të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë është shprehur për pretendimin e kërkuarit se është dënuar vetëm mbi bazë të një prove, duke arsyetuar se përveç provës së analizës së ADN-së ka edhe prova të tjera, të cilat të çmuara në harmoni me njëra-tjetrën kanë krijuar bindjen për provueshmërinë e akuzës.

24. Subjektet e interesuara, Fatime dhe Petrit Fejzillari (trashëgimtarët e viktimës), kanë parashtruar se kërkuarisi është personi i fundit që e ka parë/takuar djalin e tyre, i cili nga data 29.4.2018 deri më sot rezulton i zhdukur. Kërkuarisi është person me rrezikshmëri të lartë dhe në raste analoge personat janë dënuar edhe për fshehjen e asgjësimin e kufomës, por ndaj kërkuarit nuk është ngritur kjo akuzë, ndoshta për arsye profesionale ose për shkak të diskriminimit, pasi kërkuarisi i përket komunitetit

rom. Ndaj prokurorit të çështjes dhe oficerit të Policisë Gjyqësore është bërë kallëzim penal për shpërdorim detyre.

25. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

26. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 12, datë 24.4.2018; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se kur vlerësohet parimi i prezumimit të pafajësisë në çështjet penale, prezumimet e faktit ose të ligjit nuk janë të ndaluara, por ato duhet të jenë brenda kufijve të arsyeshëm, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e interesit që rrezikohet dhe të sigurojnë të drejtat e mbrojtjes (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka evidentuar edhe dallimin që ekziston midis mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Në këtë drejtë, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, për sa kohë që gjykatat e zakonshme, në arsyetimin e vendimeve të tyre, e mbështesin fajësinë e kërkuarit edhe mbi disa prova të tjera (*shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 42, datë 18.12.2007; nr. 9, datë 28.4.2004, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në drejtëm të parimit të prezumimit të pafajësisë, Gjykata ka pohuar se garancitë kushtetuese të tij janë konkretizuar në rregullat e KPP-së, duke i krijuar në këtë mënyrë të gjitha mundësitë organit që procedon me ndjekjen penale



(prokurorisë dhe gjykatave) për të përmbushur detyrën kushtetuese të respektimit të këtij parimi. Parimi i prezumimit të pafajësisë (neni 4 i KPP-së) përcakton se i pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të tij, si dhe vendimi i fajësisë jepet kur ai rezulton fajtor përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ndërsa në nenin 152 të KPP-së parashikohet se çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre, se çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata e zakonshme i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi dhe se ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Parimi i prezumimit të pafajësisë është trajtuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në kuadrin e nenit 6, pika 2, të KEDNJ-së. *GJEDNJ*-ja, ndër të tjera, në rastin kur ka pasur një akuzë penale dhe procedurat penale kanë përfunduar me dënimin e personit, ka theksuar se gjykatat duhet të garantojnë që parimi i prezumimit të pafajësisë të shihet si një garanci procedurale në kontekstin e një gjykimi penal, duke imponuar zbatimin e disa kërkesave të lidhura me: i. barrën e provës (*shih Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës, 6 dhjetor 1988, § 77, Seria A nr. 146 dhe Telfner kundër Austrisë, nr. 33501/96, § 15, 20 mars 2001*); ii. prezumimet ligjore të lidhura me faktet dhe ato të lidhura me ligjin (*shih Salabiaku kundër Francës, 7 tetor 1988, § 28, seria A nr. 141-A, dhe Radio Francë dhe të tjerë kundër Francës, nr. 53984/00, § 24, ECHR 2004-II*); iii. privilegjin kundër vetinkriminimit (*shih Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar, 17 dhjetor 1996, § 68, raportet e vendimeve dhe aktgjykimeve 1996-VI, dhe Heaney dhe McGuinness kundër Irlandës, nr. 34720/97, § 40, ECHR 2000-XII*).

29. Lidhur me respektimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohej individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato

janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa i takon ndarjes së detyrave midis juridiksionit kushtetues dhe atij të gjyqësorit të zakonshëm, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimin nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi dhe shtetasi F.F. punonin së bashku me shitjen e rrobave të përdorura. Automjeti në pronësi të shtetasit F.F. përdorej nga kërkuesi për tregti. Në datën 29.4.2018 kërkuesi dhe shtetasi F.F. kanë shkuar për tregti në qytetin e Laçit. Shtetasi F.F. kishte pasur me vete një shumë afërsisht 270.000 lekë. Po në këtë datë ka rezultuar se komunikimi i fundit telefonik i shtetasit F.F. me celularin e tij ka qenë në orën 14:54, ndërsa komunikimi i fundit i kërkuetit në orën 15:30. Të dy numrat e telefonit janë fikur pothuajse në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën vend (antena Miloti E). Kërkuesi e ka rindezur telefonin pas 11 orësh, duke hedhur hipoteza për vendndodhjen e tij në Tiranë, por nuk ka paraqitur prova në lidhje me të. Në datën



30.4.2018, në orën 09:15, kërkuesi është paraqitur në Komisarjatin e Policisë Kurbin për të bërë kallëzim penal, pasi një ditë më parë shtetasi F.F., me të cilin e kishte lënë të takohet në orën 18:00 në qytetin e Laçit, kishte humbur kontaktet me të. Sipas tij, shtetasi F.F. kishte me vete 270.000 lekë, gjysma e të cilave i përkiste kërkuesit.

33. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka analizuar fillimisht se Prokuroria e Kurbinit në datën 2.5.2018, mbi bazën e materialit kallëzues të dërguar nga Komisarjati i Policisë Kurbin, ka ngritur dyshime se shtetasi F.F. mund të jetë marrë peng nga persona të tjerë, për shkak të problemeve me lojërat e fatit dhe prokuroria ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Heqja e paligjshme e lirisë”. Nga procesverbali i datës 2.5.2018 rezulton se ekspert i kriminalist, oficeri i Policisë Gjyqësore dhe vetë kallëzuesi kanë shkuar në vendet e treguara nga ky i fundit, por në asnjë prej këtyre vendeve nuk janë gjetur prova ose sende që mund të kishin lidhje me ngjarjen. Disa ditë pas ngjarjes, kërkuesi i ka dorëzuar nënës së shtetasit F.F. telefonin celular të këtij të fundit, i cili, sipas ekspertimit teknik, ka rezultuar se ishte i thyer dhe jofunksional. Një javë më pas, kërkuesi ka dërguar makinën në një lavazh në Peqin, duke kërkuar nga punonjësit e atij subjekti larjen e makinës jashtë e brenda. Në datën 9.5.2018, pas larjes së automjetit, shërbimet e Policisë Gjyqësore kanë bërë këqyrjen e automjetit. Në bazë të aktit të ekspertimit biologjik vlerësues nr. 5390, datë 16.5.2018, gomina e derës së pasme, nga ana e majtë e shoferit ka rezultuar pozitive nga testi specifik për gjak human. Për këqyrjen fizike të personit dhe marrjen e kampionëve biologjikë të pështymës (ADN) të prindërve të shtetasit F.F. është përpiluar akti i ekspertimit biologjik krahasues ADN-je nr. 5391, datë 16.5.2018, sipas të cilit, nga mostrat biologjike të marra nga gomina e derës së pasme të automjetit, ekzistojnë lidhje gjenetike baba-bir dhe nënë-bir. Po ashtu, gjatë këqyrjes së mjetit janë gjetur një palë gërrshërë, por në bazë të aktit të ekspertimit biologjik nr. 5520, datë 18.5.2018 është konkluduar se ato nuk përmbajnë mbetje humane për identifikim me anë të analizës së ADN-së. Po ashtu, edhe nga akti i ekspertimit biologjik të ADN-së të kryer për xhupin e veshur nga kërkuesi ditën e ngjarjes, është arritur në përfundimin se nuk ka pasur mbetje të vlefshme për identifikimin individual të analizës së ADN-së. Në vijim, edhe një grup punonjësish të policisë së Kurbinit, me qëllim

gjetjen e shtetasit F.F., ka kontrolluar zona të ndryshme, por nga kontrolli nuk është konstatuar viktimit ose rrobë/send që mund të ketë pasur ai ditën kur është zhdukur. Ndërkohë, rezulton se prokuroria ka kryer edhe përgjim ambiental për bisedat mes kërkuesit dhe xhaxhait, sipas të cilave nuk do të flasin e tregojnë se çfarë ka ndodhur kur shpohen, ndër të tjera: *“Eeeee, se mos llafos. Joo. Ai ka ik vetë”*.

34. Për sa më lart, pas veprimeve hetimore të kryera për këtë çështje, në datën 15.5.2018 Prokuroria e Kurbinit ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, pasi, sipas saj, ishin krijuar dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se shtetasi F.F. ishte vrarë me qëllim vjedhjen e shumës të të hollave që kishte pasur me vete dhe dyshohej se autor i këtij veprimi ishte shoku i tij/kërkuesi. Mbi këtë bazë, prokuroria ka marrë të pandehur kërkuesin, si personi i fundit që kishte pasur kontaktet me shtetasin F.F., duke e akuzuar për veprën penale “Vjedhja me pasoje vdekjen”, të parashikuar nga neni 141 i KP-së. Pas përfundimit të hetimeve (të cilat kanë zgjatur edhe për një afat 3-mujor), prokurori, me kërkesën e datës 4.12.2018, ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

35. Kërkuesi, gjatë fazës së gjykimit, ka dhënë deklaramë/sqarime, duke ngritur disa alibi për vendndodhjen e tij ditën e ngjarjes, duke thënë se ka nuk qenë në qytetin e Laçit, por në fakt ka qenë në qytetin e Tiranës, tek e dashura e tij, por pa dhënë gjeneralitetet e saj dhe për këtë shkak nuk është bërë e mundur pyetja e saj si dëshmitare nga prokuroria, e cila nuk e ka konsideruar alibinë e pretenduar nga kërkuesi. Në cilësinë e dëshmitarëve janë pyetur prindërit e shtetasit F.F., bashkëshortja S.C. dhe shtetasi I.K., (daja i shtetasit F.F.). Këta dëshmitarë, në mënyrë të përmbledhur, kanë shprehur dyshimet e tyre në lidhje me marrëdhënien që kishte kërkuesi ndaj shtetasit F.F. dhe sjelljen që kishte pasur pas zhdukjes së tij, që sipas tyre ka qenë e dyshimtë. Në cilësinë e dëshmitarëve janë pyetur xhaxhai i kërkuesit dhe punonjësit e lavazhit ku ai kishte çuar makinën për ta larë një javë pas ngjarjes. Kërkuesi ka dhënë shpjegime se ka qenë në komisarjatin e policisë në orën 07:30–08:00, por sipas librit të pritjes ka qenë në orën 09:15. Për njollat e gjakut të gjendura në sediljen e makinës kërkuesi ka deklaruar se janë për shkak të një aksidenti që kishte pësuar shtetasi F.F., por sipas Prokurorisë së Kurbinit



automjeti nuk ka qenë i përfshirë në asnjë aksident dhe shtetasi F.F. nuk ka pasur hemorragji.

36. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka arsyetuar se nga shqyrtimi gjyqësor, vlerësimi i provave shkresore dhe shkencore (aktet e ekspertimit biologjik), analiza e të dhënave të dërguara në formë elektronike nga operatorët telefonikë dhe provave me dëshmitarë, është provuar plotësisht ekzistenca e faktit penal dhe rrethanave të tij në versionin e parashtruar nga organi i akuzës. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se objekti i veprës penale ka qenë cenimi i pasurisë së viktimës dhe si pasojë e këtij cenimi ka ardhur vdekja. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se kërkuesi ka kryer veprime me strategji për të mos rënë në sy, se autori i vërtetë ishte ai vetë dhe se i ka dorëzuar familjarëve të viktimës mallin e mbetur nga tregtia, por nuk ka dorëzuar telefonin tjetër që përdorte shtetasi F.F. për t'u lidhur me shërbimin e internetit, si dhe çelësat e makinës. Me qëllim fshehjen e të gjitha fakteve e provave, ndonëse automjeti nuk ishte i tij dhe shoku ende nuk ishte gjetur, kërkuesi e ka çuar makinën në lavazhin e personave që i njihte. Për njollat e gjakut, si provë thelbësore shkencore, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ato janë gjendur në sediljen e pasme dhe jo në vendin ku ulej shtetasi F.F. dhe nuk ka sens tjetër për krijimin e tyre përveçse me vendosjen e detyrueshme të personit/viktimës aty, me qëllim transportin e tij (*shih faqet 15-18 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin*).

37. Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë kërkuesi ka paraqitur ankim, duke parashtruar në mënyrë të përmblodhur pretendime se është dënuar pa prova, për më tepër në rrethanat kur nuk është gjetur asnjë kufomë. Pas ankimit të kërkuesit dhe trashëgimtarëve të viktimës, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 218, datë 14.5.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 867-128, datë 5.7.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, duke e vlerësuar të drejtë këtë vendim. Gjykata e apelit ka konfirmuar provat e vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë dhe ka evidentuar se vrasja nga ndodhur në mizori, pasi kërkuesi vazhdon të refuzojë të tregojë vendndodhjen e trupit (*shih faqen 27 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

38. Pas rekursit të kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1782, datë 5.11.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk

përbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se shkaqet e ngritura në rekurs nuk e cenojnë vendimarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi kjo gjykatë ka respektuar parimet e vlerësimit të lirë të provës e ato të çmuarjes së saj. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se nuk ka konstatuar mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit penal material ose procedural nga gjykata e apelit, me rëndësi për njësimin apo zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk është verifikuar shkelja ose zbatimi i gabuar i ligjit procedural penal me pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; nuk rezulton që vendimi i ankimuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

39. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë parashtrimet e palëve, Gjykata do të verifikojë nëse në procesin gjyqësor penal të zhvilluar ndaj kërkuesit gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë respektuar garancitë e parimit të prezumimit të pafajësisë në përcaktimin e fajësisë së tij, si dhe nëse kërkuesi ka marrë përgjegje për pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Konkretisht do të analizohet: i. nëse kanë përcaktuar drejt dhe qartë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore; ii. nëse kanë përmblodhur detyrimin për barrën e provës, duke evidentuar provat determinante që provojnë fajësinë, nëse kanë filluar procesin me bindjen se kërkuesi e ka kryer veprën penale, nëse është respektuar e drejta për të mos u vetinkriminuar dhe nëse kanë vlerësuar se dyshimet shkojnë në favor të kërkuesit; iii. nëse janë përdorur në mënyrë të arsyeshme prezumimet e faktit dhe nëse është analizuar mjaftueshëm në vendimet gjyqësore lidhur me faktin që trupi i viktimës nuk është gjetur ose thjesht është prezumuar vdekja ose zhdukja e personit, gjë që ka pasqyruar edhe prezumimin se kërkuesi është fajtor.

i. Përcaktimi i drejtë dhe i qartë i fakteve të çështjes të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore

40. Nisur nga rrethanat e parashtruara në arsyetimet e vendimeve gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të sipërcituara (*shih paragrafët 33 deri në 38 të këtij vendimi*), Gjykata vlerëson se në drejtim të kriterit të përcaktimit të drejtë dhe të qartë të fakteve të çështjes të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore, vendimet gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, edhe pse kanë



përcaktuar gjerësisht rrethanat e faktit dhe janë përpjekur të evidentojnë shkallën e rëndësisë ose peshës që luan secili prej fakteve të analizuara në kompleksin e përgjithshëm të rrethanave të faktit, nuk kanë arsyetuar sa duhet se pse këto rrethana justifikonin faktin penal të vjedhjes me pasojë vdekjen ose si ky fakt penal lidhet me kërkuesin. Nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore nuk kuptohet sesi gjykatat kanë arritur në përfundimin se nga rrethanat rezulton se është synuar vjedhja e shtetasit F.F. dhe pse vrasja ka pasur si qëllim vjedhjen. Po ashtu, ndonëse gjykatat i kanë radhitur e përcaktuar qartë faktet më të rëndësishme që lidhen me rrethanat e çështjes për përcaktimin e përgjegjësisë ligjore të kërkuesit, nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me faktin që nuk ka një kufomë, nëse shtetasi F.F. është zhdukur ose është vrarë dhe pse është prezumuar si i tillë apo pse zhdukja është prezumuar si vrasje.

ii. Përmbushja e detyrimit për barrën e provës duke evidentuar provat determinante, konstatimi nëse procesi ka filluar me bindjen se kërkuesi ka kryer veprën penale, respektimi i së drejtës për mos u vetëkriminaluar dhe, vlerësimi se dyshimet shkojnë në favor të kërkuesit

41. Në vijim, Gjykata vlerëson ta analizojë kriterin e dytë (ii) të zbërthyer në disa nënkritere, si më poshtë:

42. Në lidhje me nënkriterin *përmbushja e detyrimit për barrën e provës duke evidentuar provat determinante*, Gjykata konstaton se nga analiza e provave të lidhura me rrethanat e faktit të parashtruara në paragrafët 33 deri 38 të këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka arsyetuar se nga shqyrtimi gjyqësor janë evidentuar dhe konsideruar si prova determinante ose thelbësore: provat shkencore, si akti i ekspertimit biologjik vlerësues për analizën e ADN-së; analiza e të dhënave të dërguara në formë elektronike nga operatorët telefonikë; fakti se sipas tabulateve telefonike telefoni i kërkuesit dhe i viktimës janë fikur në të njëjtën kohë; aktet e ekspertimit për njollat e gjakut, ku është përcaktuar vendi i gjetjes së tyre dhe drejtimi i gjurmës së këtyre njollave; analiza e provave me dëshmitarë; rezultatet e përgjimit ambienta të bisedës së kërkuesit me xhaxhain, pra të gjitha këto prova, në kompleksitetin e tyre, janë analizuar në unitet me njëra-tjetrën.

43. Në përfundim të analizës për këtë nënkriter, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë bërë përpjekje për të përmbushur

detyrimin për barrën e provës, duke evidentuar disa prova determinante të konsideruara si të rëndësishme ose thelbësore për të provuar ekzistencën e faktit penal dhe fajësinë e kërkuesit, duke bërë referencë, ndër të tjera, në provat shkencore të njollave të gjakut dhe të akteve të ekspertimit biologjik që lidhen me to, të dhënat elektronike nga operatorët telefonikë, fikjen e telefonave në të njëjtën kohë, provat me dëshmitarë dhe përgjimin ambienta të kërkuesit dhe xhaxhain të tij, të cilat janë vlerësuar në unitet me njëra-tjetrën. Gjithsesi, nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm duket sikur ato e kanë çliruar prokurorin nga barra e provës, duke ia kaluar këtë barrë kërkuesit, i cili, sipas tyre, ka qenë në pozita mohuese dhe jo bashkëpunuese për të treguar vendin se ku është trupi i viktimës, gjë që për rrjedhojë e bën arsyetimin e vendimeve gjyqësore të paplotë. Mënyra e arsyetimit të gjykatave të faktit që kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ka kryer veprime me strategji për të mos rënë në sy se autori i vërtetë ishte ai vetë apo se është evidente që pasoja e ardhur, vrasja, ka qenë përvetësimi i shumës së parave që ai ka pasur me vete, apo se kërkuesi me qëndrimin e tij jobashkëpunues, mohues dhe mbi të gjitha duke tentuar të japë alibi të rreme për veprimet e tij ka synuar të fshehtë krimin e kryer, janë përfundime të nxjerra pas një analize duke ia kaluar barrën e provës kërkuesit. Ndonëse fakti penal mund të nxirret nëpërmjet indicieve, me kusht që ato të jenë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën (*neni 152, pika 2, i KPP-së*), gjykatat e faktit nuk rezulton të kenë evidentuar se cilat janë këto indicie që të ndërlidhura vërtetojnë faktin e vjedhjes së shtetasit F.F. dhe faktin e vrasjes së tij me qëllim vjedhjen.

44. Në lidhje me nënkriterin që lidhet me të drejtën për të mos u vetëkriminaluar, Gjykata thekson se bazuar në nenin 34/a, shkronja “c”, të KPP-së çdo i pandehur ka të drejtën që të heshtë dhe të mos ndihmojë aspak në fajësimin e tij dhe në rastin konkret vetëm fakti që një person humbet kontaktet/zhdukët, nuk përbën prezumim faktik për kryerjen e veprës penale të vrasjes dhe është detyrimi i organeve proceduese e në vijim i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të bërë lidhjen mes zhdukjes së një personi dhe identifikimit, si dhe ndjekjes penalisht të autorit/autorëve. Gjykata konstaton se prokuroria dhe gjykatat e juridiksionit



të zakonshëm kanë pranuar ekzistencën e “mizorisë” në kryerjen e veprës penale, duke u bazuar vetëm në qëndrimin mohues të kërkuesit gjatë gjykimit, që ka refuzuar të tregojë trupin, pavarësisht se përpara se të evidentohet se vrasja ka ndodhur me mizori (gjë që del nga vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit), duhet që të shpjegohet qartë dinamika e kryerjes së veprës penale dhe të arsyetohet në mënyrë të qartë pse zhdukja e kufomës e bën skenarin mizor, duke kryqëzuar faktet dhe rrethanat në mënyrë bindëse dhe të lidhura në mënyrë harmonike me njëra-tjetrën. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nga vendimet gjyqësore objekt i këtij shqyrtimi rezulton se e drejta kushtetuese e të pandehurit për të mos u vetinkriminuar është interpretuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në mënyrë arbitrare, në të kundër të qëllimit të saj.

45. Në drejtim të analizës së nënkriterit *nëse është filluar procesi me bindjen se kërkuesi e ka kryer veprën dhe nëse është vlerësuar se dyshimet shkojnë në favor të kërkuesit*, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që të ketë filluar hetimi dhe gjykimi me dyshimin dhe paragjykimin se kërkuesi është fajtor për vrasjen e F.F. (se fillimisht u dyshua për rrëmbimin e tij për shkak të lojërave të fatit). Po ashtu edhe në vijim, prokuroria dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë grumbulluar prova të mjaftueshme dhe kanë bërë përpjekje për t’i analizuar ato duke i ndërlidhur me njëra-tjetrën, duke mos u udhëhequr nga ndonjë paragjykim për fajësinë e kërkuesit. Megjithatë, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të kishin analizuar dhe arsyetuar në mënyrë më të qartë lidhjen e faktit penal të vrasjes me kryerjen e vrasjes nga kërkuesi, në kushtet kur nuk është gjetur trupi i viktimës. Një arsyetim më i plotë dhe më i kujdesshëm i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm do të eliminonte edhe mundësinë e ekzistencës së *dyshimeve të cilat do të shkonin në favor të të pandehurit*.

iii. Nëse janë përdorur në mënyrë të arsyeshme prezumimet e faktit dhe prezumimet ligjore

46. Lidhur me këtë kriter, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, në kundërshtim me detyrimin e tyre, prokuroria dhe më pas gjykatat kanë nxjerrë prezumimin e faktit se shtetasi F.F. është vrarë me qëllim vjedhjen e tij nga kërkuesi. Ato e kanë prezumuar këtë fakt në mënyrë të paarsyeshme, duke u bazuar në rrethanën se ai rezulton i zhdukur dhe në faktin se në automjet është gjetur një njollë

giaku e tij. Nuk ka të dhëna të sakta, të rëndësishme dhe që përputhen me njëra-tjetrën as për kohën e saktë të zhdukjes, as për kohën që i përkasin njollat e gjakut në automjet, as për sendet që janë vjedhur. Duke vepruar në këtë mënyrë, nuk kanë mbajtur në konsideratë as të drejtën e mbrojtjes së kërkuesit për të kundërshtuar akuzën e ngritur. Prokuroria dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë detyrimin për të qenë të qarta dhe të sakta në arsyetimin ligjor, për shkak se vepra penale për të cilën akuzohet kërkuesi mbart rrezikun e një dënimi penal të ashpër, duke sjellë si pasojë rrezikimin e cenimit të të drejtave substanciale për jetën dhe lirinë e individit. Për të hetuar një zhdukje të dyshimtë dhe një vdekje të dyshimtë, analiza duhet të fillojë me zbulimin e trupit, të armës së krimit, të vendit të krimit, të motivit e të mekanizmit të vrasjes dhe në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë analizuar vlerën provuese të njollave të gjakut të lidhur me mungesën e një trupi në drejtim të fajësisë, për sa kohë që nuk rezulton të jetë gjetur as arma e krimit.

47. Në drejtim të kriterit *nëse janë përdorur në mënyrë të arsyeshme prezumimet e faktit dhe prezumimet ligjore*, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë prezumuar që ka vrasje vetëm nga fakti që personi nuk gjendej dhe nuk kanë arsyetuar sa dhe si duhet për faktin se trupi i viktimës nuk është gjetur, për të arritur në përfundimin se ka ndodhur vepra penale e vrasjes, për të cilën është akuzuar kërkuesi. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar se kërkuesi nuk ka bashkëpunuar për të treguar vendndodhjen e trupit të viktimës, por kjo nuk është e mjaftueshme për të justifikuar prezumimin e faktit. Gjykata vlerëson se në çështjet penale nuk mund të shmangen edhe prezumimet e fakteve, por ato duhet të përdoren nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duke mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e interesit që rrezikohet për shkak të natyrës dhe llojit të veprës penale të lidhur me ashpërsinë e masës së dënimit, e cila ndikon drejtpërdrejt në garantimin e të drejtave substanciale të mbrojtjes. Për këtë arsye, prezumimet e fakteve duhet të mbeten brenda kufijve të arsyeshëm, të cilët duhet të përcaktohen qartë përmes arsyetimit të vendimeve gjyqësore, që në rastin konkret duhet të fokusohet tek analiza përse fakti i vrasjes është prezumuar në kushtet e mungesës së trupit të viktimës, në analizë edhe të provave të tjera të grumbulluara në këtë proces



penal. Nga vlerësimi i mësipërm, Gjykata arrin në konkluzionin se mënyra e arsyetimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për prezumimin faktit të zhdukjes, vdekjes ose vrasjes dhe autorit të saj, nuk është e plotë dhe qartë.

48. Në analizë të sa më lart, në konkluzion të të gjithë komponentëve/kritereve të analizuar më sipër, Gjykata vlerëson se ndonëse vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit kanë listuar gjerësisht faktet e çështjes për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore, ato nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me faktin penal të vjedhjes me pasojë vdekjen apo se si ky fakt penal lidhet me kërkuesin, nisur nga fakti që nuk ka një kufomë, nëse viktimë ka vdekur apo është vrarë dhe pse zhdukja e F.F. është prezumuar si vrasje. Në vendimet gjyqësore është prezumuar fakti se ka viktimitë dhe ka vrasje vetëm nga fakti që personi nuk gjendet dhe nuk është arsyetuar sa dhe si duhet për faktin se trupi i viktimës nuk është gjetur, për të arritur në përfundimin se ka ndodhur vepra penale e vrasjes për shkak të vjedhjes, për të cilën është akuzuar kërkuesi. Ato kanë përmbushur në mënyrë jo të plotë detyrimin për t'iu përgjigjur në arsyetimin e vendimeve gjyqësore kërkuesit për *pretendimet e tij për cenimin e parimit të prezumimit e pafajësisë*, duke ceduar në analizën e një raporti të drejtë dhe harmonik të të gjithë ansamblit të provave që provojnë fajësinë, qofshin ato determinante/thelbësore të drejtpërdrejta ose indirekte, duke mbajtur në konsideratë se masa e kujdesit duhet të jetë në një nivel të arsyeshëm, për sa kohë jemi para një veprë penale, ku ashpërsia e masës së dënimit rrezikon ndjeshëm të drejtat kushtetuese substanciale. Në konkluzion të analizës së saj, Gjykata vlerëson se mënyra e arsyetimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm ka bërë që në dukje të zhvendoset barra e provës nga prokurori te kërkuesi, i cili nuk ka treguar se ku e ka fshehur trupin e viktimës.

49. Në vijim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formal dhe nuk ka riparuar shkeljen e gjykatave të faktit. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se arsyetimi i bërë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është një arsyetim jo bindës, duke *cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë*.

50. Në përfundim, Gjykata çmon se sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj dhe ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1782, datë 5.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 5.11.2025.

Shpallur më 21.1.2026.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

Nr. 82, datë 18.12.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	kryesuese;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Sandër Beci,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 6.11.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (K) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Klodiana Cankja, Ermelinda Cankja, Ardit Cankja, Drita Cani, Suzana Cani,



Marvis Cani, Engjëll Tirana, Brian Tirana, Helga Hasekiu

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli I Ministrave, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, me autorizim.

Ministria e Brendshme, përfaqësuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan, Ilir Bejtja, me urdhër delegimi.

Bashkia e Elbasanit, në mungesë.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4040, datë 22.10.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 18, 41, 42, 43, 44, 131, shkronja “F”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 71 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuësve, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Bashkisë së Elbasanit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 228, datë 14.5.2014, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga hapja dhe sistemimi i rrugës ‘11 Nëntori’, segmenti nga shkolla ‘Jorgji Dilo’ deri tek ‘Rotonda te Posta’, të

Bashkisë së Elbasanit” (*VKM-ja e shpronësimit*), bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” (*Ligji për Shpronësimet*), ka shpronësuar kundrejt shpërblimit disa pasuri të paluajtshme që prekeshin nga hapja dhe sistemimi i rrugës “11 Nëntori” në qytetin e Elbasanit. Dy prej pasurive të paluajtshme të shpronësuar u përkisnin trashëgimlënësve ligjorë të kërkuësve. Pasuria e parë ishte truall me sipërfaqe 202 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 82 m², e shpronësuar kundrejt shpërblimit 4.577.120 lekë, duke vlerësuar ndërtesën me vlerën 45.119 lekë/m², truallin me vlerën 4.081 lekë/m² dhe drufrutorët me vlerën 53.000 lekë. Pasuria e dytë ishte truall me sipërfaqe 262,15 m² e shpronësuar kundrejt shpërblimit prej 1.172.434,15 lekësh, duke e vlerësuar truallin sërish me vlerën 4.081 lekë/m² dhe drufrutorët me vlerën 102.600 lekë. Si rezultat i këtij shpronësimi, të shpronësuarit e këtyre dy pasurive kanë përfituar shpërblimin gjithsej prej 5.749.554,15 lekësh.

2. Shpërblimi është përlllogaritur sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” (*VKM-ja e Kriteve Teknike të Vlerësimit*) dhe nr. 187, datë 6.3.2013, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë” (*VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013*). Kjo e fundit është miratuar bazuar në vendimin nr. 658, datë 26.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” (*Metodologjia e Vlerësimit të Pronave*), i cili, për të përlllogaritur vlerën e pasurive të paluajtshme, krijon një proces të plotë administrativ të mbledhjes të të dhënave të tregut nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme sipas çmimit të kontratave të shitjes të regjistruara prej tyre.

3. Vlera e ndërtesës për njësi/m² është përcaktuar me shkrim në shtator 2013 nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Elbasan, me referencë *de jure* të mesatarja e shitblerjes të këtyre lloj pasurive gjatë vitit 2013 në zonën kadastrale ku ndodhej pasuria e kërkuësve.



Ndërsa vlera e truallit për njësi/m² është konfirmuar me shkrim në tetor 2013 nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me referencë të VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013.

4. Me pretendimin se vlera e shpërblimit nuk i përgjigjej çmimit të tregut, një nga bashkëpronarët e dy pasurive ka paraqitur padi në gjykatë kundër Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë së Elbasanit, duke kërkuar ndryshimin e pjesshëm të VKM-së së Shpronësimit vetëm për sa i përket vlerës së shpërblimit. Gjatë gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka pranuar ndërhyrjen kryesore të bashkëpronarëve të tjerë, me të njëjtin objekt si ai i padisë dhe gjykimi ka vazhduar edhe me pjesëmarrjen e tyre.

5. Ndërkohë që çështja po shqyrtohej në gjykatën e shkallës së parë, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 514, datë 30.7.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë” (*VKM-ja e Vlerës së Pronës 2014*), me të cilin vlera e truallit për njësi/m² në zonën kadastrale të pasurive të kërkuësve u caktua në masën 7.502 lekë/m².

6. Gjatë gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me kërkesë të përfaqësuesit të kërkuësve, ka caktuar ekspert në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme për të përcaktuar vlerën e shpërblimit. Në datën 19.11.2014, eksperti ka paraqitur aktin e ekspertimit, për të cilin kishte përdorur metodën e krahasimit të drejtpërdrejtë, duke marrë parasysh ecurinë e transaksioneve të pronave të ngjashme, karakteristikat e veçanta të pasurive të shpronësuara dhe pozicionimin e tyre. Sipas ekspertit, pasuria e parë vlerësohej me 7.472.000 lekë (24.000 lekë/m² për truallin dhe 56.000 lekë/m² për ndërtesën), ndërsa pasuria e dytë me 6.291.600 lekë (24.000 lekë/m²). Si rezultat i përllogaritjeve të ekspertit, shpërblimi i shpronësimit për të dyja pasuritë duhej të ishte 13.763.600 lekë.

7. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 88, datë 28.1.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se institucionet publike provuan në gjykim ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre në caktimin e vlerës së shpronësimit. Sipas saj, institucionet publike e kishin llogaritur shpërblimin sipas VKM-së së

Kritereve Teknike të Vlerësimit që referonte të VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013. Për sa i takon aktin të ekspertimit, që kishte përcaktuar një vlerë dukshëm më të lartë, gjykata e shkallës së parë është shprehur se eksperti nuk e kishte arsyetuar konkluzionin e tij, ekspertimi nuk kishte vlerë të paracaktuar provuese dhe nuk lidhej me provat e tjera të shqyrtuara. Po kështu, ajo gjykatë ka arsyetuar se nuk mund t'i referohej një vlere të kërkuar nga palët dhe të mbështetur nga eksperti, por ajo duhej përcaktuar sipas një metodologjie shtetërore, në mënyrë që të mos cenohej përmbushja e interesit publik.

8. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Kjo e fundit me vendimin nr. 2182/2256, datë 18.5.2017, ka arsyetuar se shpërblimi i shpronësimit ishte përllogaritur bazuar në Ligjin për Shpronësimet, i cili në nenet 17 dhe 18 autorizon Këshillin e Ministrave të caktojë kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së shpërblimit. Më tej, ajo gjykatë është shprehur se, në të kundërt me sa pretendonin kërkuësit, vlera e shpronësimit nuk përllogaritet sipas akteve nënligjore në fuqi në kohën kur del vendimi i Këshillit të Ministrave që miraton shpronësimin, por sipas atyre në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësimin. Në mbështetje të këtij arsyetimi, gjykata e apelit ka analizuar përmbajtjen e neneve 10, 17 dhe 19, të Ligjit për Shpronësimet, të cilat rregullojnë procedurën e shpronësimit, përllogaritjen e vlerësimit paraprak dhe të atij përfundimtar të pasurisë që shpronësohet. Për rrjedhojë, sipas Gjykatës Administrative të Apelit, shpërblimi ishte i drejtë, pasi ishte përllogaritur nga institucionet publike bazuar në VKM-në e Vlerës së Pronës 2013 dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësimin.

9. Ndonëse kërkuësit kanë paraqitur rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4040, datë 22.10.2024, ka vendosur mospranimin e tij. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat e faktit kishin përcaktuar saktë faktet e mosmarrëveshjes dhe kishin analizuar hollësisht Ligjin për Shpronësimet.

10. Në datën 14.2.2025, kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 2.5.2025 ka vendosur kalimin e



çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Gjykata, në datën 6.11.2025, ka zhvilluar seancën plenare mbi bazë të dokumenteve dhe deri në datën 18.12.2025, ka biseduar për marrjen e vendimit. Përgjatë kohës së bisedimeve, gjyqtarja Holta Zaçaj, njëherazi Kryetare e Gjykatës, ka përfunduar ushtrimin e detyrës, për rrjedhojë nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë u janë cenuar:

11.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

11.1.1 *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë pa arsyetim nuk ka bërë zëvendësimin procedural të një prej rekursuesve (ndërhyrës kryesor në proces), që kishte ndërruar jetë, megjithëse ishte kërkuar me shkrim në datën 15.10.2024, duke paraqitur edhe dëshminë e trashëgimisë ligjore.

11.1.2 *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë sipërfaqësore, pa analizuar pretendimet e kërkuarve. Ajo nuk ka dhënë përgjigje për pretendimet se përse nuk është aplikuar vlera e tokës në momentin e shpronësimit dhe as përse gjykata e apelit nuk ka analizuar aktin e ekspertimit. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk është bindës dhe bie ndesh me qëndrimin që ajo ka mbajtur në raste të tjera të ngjashme.

11.2 *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi vlera e shpronësimit është shumë e ulët, duke i vendosur kërkuarve në pozita të pafavorshme dhe të pabarabarta me pronarët e pasurive të ngjashme, që i shesin pronat me çmimet e tregut, si dhe me ata që janë shpronësuar pas dy muajve, që janë shpërblyer me çmimet e reja të rritura me gati 100%.

11.3. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi atyre u është mohuar përfitimi i shpërblimit të drejtë, i cili më së paku duhet të ishte i njëjtë me çmimin e miratuar në vitin 2014 kur ndodhi shpronësimi dhe jo me çmimin e VKM-së së Vlerës së Pronës 2013, që i referohet situatës së tregut në vitin 2012. Shpërblimi nuk

është aspak në koherencë me çmimet e aplikuar në të njëjtën zonë si përpara ashtu edhe pas shpronësimit. Për më tepër, rruga e re Tiranë-Elbasan ka rritur ndjeshëm vlerën e pronës. Për rrjedhojë, është cenuar edhe *parimi i sigurisë juridike*.

12. **Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit**, kanë prapësuar mbi të njëjta argumente, duke u shprehur, në mënyrë të përmbledhur, se:

12.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është haptazi i pabazuar. Çështja lidhet drejtpërdrejt me shpërblimin e drejtë, që ka të bëjë me vlerësimin dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, ndaj nuk i përket juridiksionit kushtetues. Gjykata e apelit ka vlerësuar pretendimet në mënyrë të plotë mbi bazën e akteve të dosjes gjyqësore. Shpronësimi është bërë në përputhje me Ligjin për Shpronësimet dhe aktet nënligjore në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësimin. Akti i ekspertimit ka qenë teorik dhe jo konkret, pasi eksperti nuk ka sjellë asnjë argument dhe provë bindëse për vlerën e pronës të përlllogaritur prej tij sipas metodologjive të përcaktuara në VKM. Gjykata e Lartë ka plotësuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit, pasi ka shprehur përmbledhtazi shkaqet e mospranimit të rekursit dhe pjesa arsyetuese lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv.

12.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk qëndron, pasi argumentet nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Fakti që gjykatat kanë vendosur ndryshe në raste të tjera, nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e kërkuarve. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk janë shprehur me vendim njësoj për çështje të kësaj natyre, ndaj kërkuarve nuk mund të kenë pritshmëri të ligjshme për pretendimet e tyre.

12.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është i pabazuar, pasi metodologjia e përdorur në përcaktimin e vlerës së shpronësimit të pasurisë nuk shfaq probleme në aspektin kushtetues. Po kështu, interpretimi që gjykatat i kanë bërë konceptit kushtetues të “shpërblimit të drejtë” nuk rezulton të jetë arbitrar.

13. **Subjekti i interesuar, Ministria e Brendshme, përfaqësuar nga prefekti i qarkut Elbasan**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkuarve janë të pabazuara. Procedura e



shpronësimit është bërë në përputhje me aktet ligjore në fuqi në atë kohë. Çmimi, përlllogaritja dhe vlera për shpronësim për kategorinë “truall” janë bërë nga Bashkia e Elbasanit, bazuar në VKM-në e Vlerës së Pronës 2013, ku është përcaktuar çmimi për të gjitha pronat që do të shpronësohen për interes publik, për rrjedhojë Ministria e Brendshme nuk mund të rishikojë përlllogaritjen e çmimit.

14. **Subjekti i interesuar, Bashkia e Elbasanit**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin nuk është pranuar rekursi i tyre ndaj vendimeve gjyqësore që kanë rrëzuar padinë e tyre për shpërblimin nga shpronësimi, ndaj justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar. Ata e kanë përmbushur edhe *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion*, të parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pasi i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor për çështjen e shpërblimit nga shpronësimi. Po kështu, kërkuësit legjitimohen edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin

71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 22.10.2024 dhe ankimin kushtetues individual e kanë paraqitur në datën 14.2.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae* kërkuësit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor (në aspektet e së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit), parimi i barazisë përpara ligjit dhe e drejta e pronës private e lidhur me sigurinë juridike, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 18 dhe 41 të Kushtetutës.

18. Për sa i takon *së drejtës së aksesit*, ata kanë parashtruar se gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, dy prej bashkëpronarëve të pasurisë, që kishin vënë në lëvizje procesin gjyqësor (paditësja dhe një ndërhyrëse kryesore), kanë ndërruar jetë. Sipas tyre, Gjykata e Lartë, pa dhënë asnjë argument, ka vepruar ndryshe për kalimin procedural, pasi për një bashkëpronar e ka bërë kalimin, ndërsa për tjetrin jo, megjithëse për këtë të fundit kërkuësit, në datën 15.10.2024, kishin paraqitur kërkesë me shkrim.

19. Gjykata konstaton se në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë janë shënuar emrat e trashëgimtarëve ligjorë të njërit prej bashkëpronarëve (paditëses), si dhe emrat e bashkëpronarëve të tjerë (ndërhyrësit kryesorë). Ndërsa në pjesën arsyetuese është përshkruar se me vendim të ndërmjetëm është bërë kalimi procedural i palës paditëse te fëmijët e saj bazuar në dëshminë e trashëgimisë që mban datën 28.1.2020 (*shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Nuk rezulton që e njëjta procedurë të jetë ndjekur për trashëgimtarët ligjorë të bashkëpronarit tjetër (një prej ndërhyrësve kryesorë), që ka ndërruar jetë, përpara dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, gjë që *prima facie* përbën shkelje procedurale. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuësin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimin nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, si dhe duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, se kërkuësit nuk kanë argumentuar sesi kjo shkelje ka pasur ndikim vendimtar në ecurinë e procesit dhe interesat e tyre, dhe, nga ana tjetër, se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e



rekursit të tyre, që kanë mbajtur të njëjtin qëndrim përgjatë të gjithë procesit, konkludohet se shkelja nuk është thelbësore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit është haptazi i pabazuar.

20. Gjykata vëren se pretendimet e tjera të kërkuësve (standardi i arsytimit të vendimit, parimi i barazisë përpara ligjit dhe e drejta e pronës), kanë të bëjnë me shpërblimin nga shpronësimi. Konkretisht, kërkuësit janë ankuar bazuar në nenet 42, 18 dhe 41 të Kushtetutës, duke parashtruar se Gjykata e Lartë, në ndryshim nga qëndrimi që ka mbajtur në raste të tjera të ngjashme, ka dështuar t'u japë përgjigje për vlerën e shpërblimit për dy pasuritë e shpronësuara, si dhe për refuzimin e rezultateve të ekspertimit. Ndërsa subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se arsytimi i Gjykatës së Lartë plotëson standardet kushtetuese dhe se përcaktimi i shpërblimit ka të bëjë me interpretimin e ligjit dhe me çmuarjen e provave, ndaj nuk përbën çështje kushtetuese. Sipas tyre, në kushtet kur Gjykata e Lartë nuk ka dhënë vendim njësoj për çështje të kësaj natyre, nuk mund të ngrihen pretendime për qëndrimet e saj në çështje të ngjashme.

21. Neni 41 i Kushtetutës, teksa garanton të drejtën e pronës private (*pika 1*), përcakton, ndër të tjera, se ligji mund të parashikojë shpronësimin vetëm për interesa publikë (*pika 3*), ndërsa shpronësimi lejohet vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (*pika 4*) dhe për mosmarrëveshjet për masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë (*pika 5*).

22. Në jurisprudencën kushtetuese për sa u takon garancive të nenit 41 të Kushtetutës është pohuar se e drejta e pronës përjashtimisht mund të cenohet vetëm në formën e “shpronësimit” dhe të “kufizimit”. Kufizimi i ligjshëm që mund t'i bëhet së drejtës së pronësisë, në njërën prej këtyre dy situatave, kërkohej të realizohet me “ligj”, “vetëm për interesa publikë” dhe “vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë” (*shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Shpërblimi i drejtë është koncept kushtetues i lidhur me rastet e shpronësimit ose kufizimit të së drejtës së pronës me ligj për interesa publikë gjatë një marrëdhënieje midis individit pronar dhe shtetit, ku individ i zhvishet nga e drejta e pronësisë sa herë që ndërhyr një interes publik dhe ka të drejtë

të ketë pretendime vetëm për masën e shpërblimit (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se gjatë gjykimit të zhvilluar përpara gjykatave të zakonshme nuk ka pasur kundërshtim për faktin se dy pasuritë e kërkuësve janë shpronësuar bazuar në Ligjin për Shpronësimet për zbatimin nga Bashkia e Elbasanit të projektit për interes publik për hapjen dhe sistemimin e rrugës “11 Nëntori” brenda qytetit. Me fjalë të tjera, është fakt i pakundërshtueshëm se kërkuësit kanë pësuar ndërhyrje me ligj në të drejtën themelore të pronës, ndërhyrje e cila ka plotësuar edhe kriterin e interesit publik. Thënë këtë, çështja kryesore që është shtruar për zgjidhje përpara gjykatave të zakonshme lidhet me proporcionalitetin e ndërhyrjes, konkretisht me vlerën për metër katror të truallit dhe të ndërtesës, me të cilat është përlogaritur shpërblimi i kërkuësve për shpronësimin. Edhe pse gjykatat e zakonshme, si rregull, janë në pozicionin më të mirë për të përcaktuar ekzistencën dhe masën e dëmit, për shkak të kompetencës së tyre për të shqyrtuar dhe vlerësuar provat, Gjykata thekson se, sipas neneve 41, pika 4 dhe 17, të Kushtetutës, ajo ka juridiksion për të vlerësuar nëse shpërblimi për shpronësimin është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm, pra nëse është proporcional.

24. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se prapësimi i subjekteve të interesuara se rasti nuk përbën çështje kushtetuese nuk qëndron, ndaj do ta shqyrtojë themelin e saj në këndvështrim të standardit të arsytimit të lidhur me proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës, që hyn në juridiksionin kushtetues. Brenda të njëjtit këndvështrim dhe për aq sa është i zbatueshëm parimi i barazisë përpara ligjit, Gjykata do t'u japë përgjigje edhe argumenteve të palëve për qëndrimin e ndryshëm që Gjykata e Lartë ka mbajtur në çështje të tjera të ngjashme.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës

25. Kërkuësit kanë parashtruar se janë shpronësuar përkundrejt një shpërblimi të padrejtë. Vlera e shpronësimit është llogaritur në kohën e kërkesës për shpronësim sipas VKM-së së Vlerës së Pronës 2013, e cila i ka përcaktuar



çmimet sipas situatës së tregut në vitin 2012. Ndërkohë, kërkesit janë shpronësuar në vitin 2014, vit në të cilin u miratua VKM-ja e Vlerës së Pronës 2014, që rriti vlerën e tokës me gati 100%, ndaj gjykatat e zakonshme duhej t'u referoheshin vlerave të nxjerra nga akti i ekspertimit. Shpërblimi nuk është në koherencë me çmimet e aplikuara në të njëjtën zonë si përpara, ashtu edhe pas shpronësimit. Rruga e re Tiranë-Elbasan ka rritur ndjeshëm vlerën e pronës. Sipas kërkesve, arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk është bindës dhe bie ndesh me qëndrimin që ajo ka mbajtur në vendime të tjera të ngjashme. Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit se përse gjykata e apelit nuk ka analizuar aktin e ekspertimit.

26. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se shpërblimi i shpronësimit është përcaktuar nga gjykatat e zakonshme sipas metodologjisë në fuqi, që nuk shfaq probleme kushtetuese. Interpretimi i “shpërblimit të drejtë” nga gjykatat nuk rezulton të jetë arbitrar dhe nuk cenon të drejtën e kërkesve. Sipas tyre, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkesve për aktin e ekspertimit, njësoj si gjykata administrative e shkallës së parë, se eksperti nuk ka sjellë asnjë argument bindës në aktin e ekspertimit për përllogaritjen e shpërblimit. Ndërsa subjekti tjetër i interesuar, Ministria e Brendshme, ka prapësuar se shpërblimi është përllogaritur nga Bashkia e Elbasanit bazuar në VKM-në e Vlerës së Pronës 2013, për rrjedhojë ministria nuk mund të rishikonte përllogaritjen e shpërblimit.

27. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i vendimit të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimi të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime kushtetuese, Gjykata e Lartë,

bazuar në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Sipas Gjykatës, e drejta e individit të shpronësuar për shpërblim të drejtë përbën garanci kushtetuese me natyrë materiale në rastin e shpronësimit (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 41 i Kushtetutës nuk ka përcaktuar kriteret që duhen zbatuar për përcaktimin e “shpërblimit të drejtë”, që do të thotë se kushtetutëbërësi e ka lënë në diskrecionin e ligjvënësit për të përcaktuar treguesit konkretë të vlerësimit të tij (*shih vendimin nr. 33, datë 30.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata e ka marrë edhe më parë në analizë “shpërblimin e drejtë”, të parashikuar në nenin 41, pika 4, të Kushtetutës, por rastet kanë pasur të bëjnë me procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave të marra padrejtësisht nga shteti në vitet 1945–1990 dhe jo me shpronësimet e tjera për interes publik. Për rastet e para, Gjykata, duke interpretuar edhe nenin 181 të Kushtetutës, ka theksuar se garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e padrejta nga shteti. Në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, Gjykata e ka interpretuar shpërblimin e drejtë të lidhur me interesin publik, veçanërisht me respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social. Sipas saj, nga kriteret kushtetuese të “rregullimit të drejtë” dhe të “shpërblimit të drejtë”, të pranuar në nenet 41 dhe 181 të Kushtetutës, kriteri për shpërblimin ose kompensimin në dobi të subjektit të shpronësuar nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Lidhur me shpërblimin nga shpronësimi, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se autoritetet vendase gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në përcaktimin e masës së tij. Roli i saj është i



kufizuar, ajo respekton gjykimin e ligjvënësit për shpërblimin për shpronësimin përveçse kur ai është haptazi i paarsyeshëm (*shih Lithgow dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 8.7.1986, § 122*). Sipas GJEDNJ-së, ekuilibri midis interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore individuale, si rregull, arrihet kur shpërblimi që i paguhet të shpronësuarit lidhet në mënyrë të arsyeshme me vlerën e tregut, të përcaktuar në kohën e shpronësimit (*shih Gasbi kundër Kroacisë, datë 13.12.2007, § 41*). Çdo qasje tjetër mund të hapë derën për një shkallë pasigurie, madje edhe arbitrariteti (*shih Vistiņs dhe Perepjolkins kundër Letonisë [DhM], datë 25.10.2012, § 111*). Megjithatë, rregulli për shpërblimin e plotë sipas çmimit të tregut nuk është pa përjashtime (*shih Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DhM], datë 29.3.2006, § 96*). Objektivat legjitimë të “interesit publik” (siç janë ato që ndiqen në masat e reformës ekonomike ose ato për të arritur një drejtësi më të madhe sociale) mund të kërkojnë që shpërblimi të jetë më i ulët se çmimi i plotë i tregut (*shih James dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 21.2.1986, § 54*).

31. Gjykata, në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete, vë në dukje se shpronësimi është një institut juridik, i cili, nëpërmjet një akti individual të bazuar në ligj dhe për interes publik, shuan të drejtën e pronës për një pasuri private, në këmbim të një shpërblimi të drejtë, në rastet kur kjo është e nevojshme për të realizuar përmbushjen e interesit publik. Shpronësimi është rezultat i masave ose i reformave të planifikuara për të përmbushur interesa publike, ndaj ligjvënësi dhe ekzekutivi, si rregull, gëzojnë hapësirë të gjerë vlerësimi në caktimin e shpërblimit, sepse janë në pozicionin e duhur për të pasur njohuri të drejtpërdrejta të shoqërisë, nevojave dhe burimeve. Në këtë drejtëm, një kusht thelbësor është vlerësimi nëse përdorimi i ri i pasurisë që shpronësohet do të sjellë dobi publike më të madhe sesa ajo që rrjedh nga përdorimi aktual i saj, pra kur interesi publik mbizotëron kundrejt interesave privatë të pronarit të pasurisë.

32. Natyra e shpërblimit nga shpronësimi ndryshon nga ajo e dëmshpërblimit sipas së drejtës civile, pasi nuk synon të rimbursojë individin e prekur nga të gjitha humbjet aktuale dhe të ardhshme që lidhen me dëmin e pësuar, siç është fitimi i munguar. Në fakt, ai synon në parim

të pasqyrojë shumën financiare të nevojshme për të zëvendësuar pasurinë e shpronësuar me një pasuri të së njëjtës kategori dhe cilësi, dhe merr parasysh vetëm vlerën në kohën e shpronësimit dhe jo zhvillimet e ardhshme të pronës. Me fjalë të tjera, qëllimi i shpërblimit sipas nenit 41, pika 4, të Kushtetutës, është të rivendosë një gjendje “të barasvlershme me gjendjen e mëparshme”.

33. Thelbi i garancisë kushtetuese, të parashikuar në nenin 41, pika 4, të Kushtetutës, është të garantojë ekuilibrin midis interesit publik dhe shuarjes të së drejtës së pronës së individit, prej nga rrjedh detyrimi i prerë dhe i pakushtëzuar i shtetit për të siguruar një shpërblim të drejtë për shpronësimin. Ky shpërblim mund të korrespondojë me një vlerësim të plotë, por mund të jetë edhe më i ulët, pasi llogaritja e tij nuk merr në konsideratë vetëm interesin e individit të prekur, por e peshon atë në raport me interesin publik. Kështu, kur shteti ndërmerr një projekt të madh që kërkon shpronësimin e shumë individëve, barra e shpronësimit ndahet mes shumë individëve dhe pabarazia individuale zvogëlohet. Në këto rrethana, ekuilibrimi i interesit publik me atë privat mund të justifikojë dhënien e një shpërblimi më të ulët sesa vlera e plotë e pronës.

34. Megjithatë, shpërblimi dukshëm i ulët vendos barrë joproporcionale ndaj individit dhe mund të përbëjë cenim të Kushtetutës. Për këtë arsye, autoritetet kompetente, gjatë procedurës së shpronësimit, dhe më tej gjykatat e zakonshme, gjatë procesit gjyqësor, duhet të shqyrtojnë me kujdes të gjithë faktorët relevantë për përcaktimin e shpërblimit nga shpronësimi për të arritur ekuilibrin e duhur dhe për të mos i vendosur individit një barrë të tepruar. Shpërblimi nga shpronësimi duhet të jetë domosdoshmërisht rezultat i ekuilibrit të interesave të individit të shpronësuar me ato të publikut të gjerë. Ai nuk mund të përfaqësojë as njohjen e njëanshme të interesave të pronarit dhe as vetëm ato të publikut të gjerë.

35. Në vështrim të kriterëve të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuessit kundërshtojnë vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të tyre. Në situatën kur rekursi nuk është shqyrtuar në themel dhe për të respektuar kufirin midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor, Gjykata për zgjidhjen



e çështjes do t'i japë përgjigje pyetjes nëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm për vlerën e shpërblimit që kanë përfituar kërkuesit nga shpronësimi, pra për proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronësisë, që, siç u theksua, atyre u është kufizuar me ligj dhe për interes publik (*shih supra paragrafin 23*).

36. Në këtë këndvështrim, Gjykata konstaton se Bashkia e Elbasanit në janar të vitit 2014 ka paraqitur kërkesë për shpronësim në Ministrinë e Brendshme për të realizuar projektin për hapjen dhe sistemimin e rrugës “11 Nëntori” brenda qytetit. Në cilësinë e kërkueses së shpronësimit, ajo ka kryer procedurën e vlerësimit paraprak të pasurive dhe ka përgatitur dokumentacionin që duhet të shoqëronte kërkesën për shpronësim. Sipas saj, dy pasuritë e kërkuesve vlerësoheshin paraprakisht me 4.577.120 lekë (pasuria e parë) dhe 1.172.434,15 lekë (pasuria e dytë), vlera të cilat janë llogaritur me 4.081 lekë/m² për truallin dhe 45.119 lekë/m² për ndërtesën. Bashkia e Elbasanit në përcaktimin e vlerave të pasurive ka bashkëpunuar me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan (për ndërtesën) dhe Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (për truallin). Të dyja këto institucione, në vjeshtën e vitit 2013, kanë deklaruar me shkrim çmimin për njësi për metër katror, me referencë të VKM-ja e Kriteve Teknike të Vlerësimit dhe VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013, si dhe mesataren e transaksioneve të vitit 2013. Nuk rezulton që vlerësimi paraprak i pasurive nga Bashkia e Elbasanit të jetë rishikuar nga Ministria e Brendshme, si institucioni kompetent për të ndjekur procedurën e shpronësimit, e cila ka propozuar për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave vendimin e shpronësimit, duke e konsideruar vlerësimin paraprak si përfundimtar. Në datën 14.5.2014, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM-në e Shpronësimit, duke caktuar shpërblimin e kërkuesve me 4.577.120 lekë (pasuria e parë) dhe 1.172.434,15 lekë (pasuria e dytë).

37. Megjithatë kërkuesit kanë paraqitur padi në gjykatë për masën e shpërblimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës në datën 28.1.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se kërkuesit nuk kanë sjellë asnjë provë që tregonte se vendimi i shpronësimit nuk ishte i mbështetur në ligj, ndërsa akti i

ekspertimit i shqyrtuar gjatë gjykimit nuk lidhej me provat e tjera shkresore dhe nuk ishte i besueshëm (*shih supra paragrafin 7*). Vendimi i saj është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit në datën 18.5.2017, e cila, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se kërkuesit ishin shpërblyer në përputhje me nenin 19 të Ligjit për Shpronësimet, sipas metodikës ligjore dhe se jo domosdoshmërisht shpërblimi i drejtë nënkupton vlerën e tregut të pasurisë (*shih supra paragrafin 8*).

38. Kërkuesit kanë paraqitur rekurs, duke ngritur, ndër të tjera, pretendimin se shpërblimi nga shpronësimi ishte i padrejtë dhe i gabuar, si dhe në kundërshtim me konceptin e “shpërblimit të drejtë”, të përcaktuar nga Kushtetuta, Kodi Civil dhe Ligji për Shpronësimet, ndaj shpërblimi i tyre duhej caktuar sipas përlogaritjeve të aktit të ekspertimit që ishin kryer në gjykatën e shkallës së parë. Pavarësisht këtij pretendimi, Gjykata e Lartë, në datën 22.10.2024, me arsyetim të kufizuar, ka vendosur mospranimin e rekursit, me fjalë të standardizuara se përfundimi i gjykatave të faktit ishte i bazuar në ligj, se gjykata e apelit kishte analizuar drejt Ligjin për Shpronësimet dhe se pretendimet që lidheshin me vlerësimin e provave dilnin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih supra paragrafin 9*).

39. Duke mbajtur në konsideratë faktin se Gjykata e Lartë është shprehur se gjykata e apelit ka analizuar drejt Ligjin për Shpronësimet, Gjykata çmon të vërë në dukje përmbajtjen e tij. Ligji në fjalë parashikon se shpronësimi bëhet vetëm për interes publik, kur interesi publik mbizotëron ndaj interesave privatë të pronarëve të tyre, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare (*neni 2*); parimet e transparencës, barazisë së qytetarëve dhe mbrojtjes të të drejtave dhe interesave pronësorë të tyre duhet të respektohen (*neni 3*); ai mund të bëhet për shkaqe të ndryshme, përfshirë realizimin e projekteve kombëtare ose vendore dhe investimeve në funksion të mjedisit, shëndetit etj., sikundër infrastrukturës në shërbimin dhe interesin e publikut (*neni 8*).

40. Për sa i takon së drejtës së pronës private në rastin e shpronësimit, Ligji për Shpronësimet parashikon tre garanci: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e ndërhyrjes minimale - shpronësimi



duhet të kufizohet vetëm në masën e domosdoshme për arritjen e qëllimit publik (*neni 2*); *garancia e dytë* ka të bëjë me shpërblimin e drejtë - ai llogaritet në masë të njëjtë me vlerën e plotë të vlerësimit përfundimtar të pasurisë së shpronësuar dhe është i menjëhershëm, pasi paguhet njëkohësisht me transferimin e pasurisë të shteti (*nenet 2, 4, 16 dhe 19*); *garancia e tretë* ka të bëjë me ankimin e të shpronësuarit në gjykatë për masën e shpërblimit (*neni 24*).

41. Ligji për Shpronësimet ka parashikuar edhe procedurën e caktimit të shpërblimit nga shpronësimi. Kërkuesi i shpronësimit, ku përfshihen edhe autoritetet bashkiake, kur aplikon te ministria kompetente, duhet të paraqesë një numër dokumentesh, midis të cilave edhe vlerësimin paraprak të objekteve të shpronësimit dhe masën e shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat (*neni 10, shërkronja "ç"*). Ndërkohë, ministri kompetent urdhëron ngritjen e një komisioni të posaçëm për të mbikëqyrur procedurën e shpronësimit, anëtarët e të cilit duhet të jenë me përvojë dhe kualifikim të posaçëm në fushën juridike, ekonomike dhe inxhinierike (*neni 11*). Me anë të këtij komisioni, ministria kompetente kryen një sërë veprimesh për verifikimin e ligjshmërisë së kërkesës për shpronësim dhe të dokumentacionit të saj (*nenet 12–15*). Në vijim, komisioni i posaçëm llogarit shumën e shpërblimit të pasurisë që shpronësohet, bazuar në vlerën fillestare, amortizimin, destinacionin, vendndodhjen, indekset e ndryshimit të çmimeve të tregut dhe të monedhës, si dhe kriteret e tjera teknike të miratuara nga Këshilli i Ministrave (*neni 17*). Ministri kompetent duhet më pas të paraqesë në Këshillin e Ministrave propozimin për shpronësim të shoqëruar me një numër dokumentesh, ku përfshihet edhe shuma e shpërblimit të propozuar (*neni 20*). Këshilli i Ministrave vendos për shpronësimin kur propozimi për shpronësim konsiderohet se është i bazuar në ligj dhe në fakt. Vendimi i shpronësimit duhet të përfshijë pasuritë private që shpronësohen dhe pronarët respektivë të tyre, shumën e shpërblimit që do të paguhet, si dhe afatin dhe mënyrën e pagesës (*neni 21*).

42. Mbi bazën e fakteve të përcaktuara nga gjykatat e faktit, Gjykata fillimisht vëren se, ndonëse shpronësimi u vendos në datën

14.5.2014, shpërblimi i kërkuesve përkon me vlerësimin paraprak të pasurive të kryer nga Bashkia e Elbasanit në vjeshtën e vitit 2013, bazuar në vlerat e përcaktuara nga VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013, e cila rezulton të jetë miratuar në datën 6.3.2013. Në këtë pikë evidentohet se: VKM-ja për Vlerën e Pronës 2013 hartohet sipas Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, që nënkupton një proces mbledhësh të dhënash për të gjithë territorin e Republikës – proces që zgjat në kohë, ndaj nuk duket i pabazë pretendimi i kërkuesve se vlerat e vitit 2013 *de facto* pasqyrojnë situatën e tregut në vitin 2012; VKM-ja e Vlerës së Pronës 2014 që dyfishoi vlerat e pronave, *de facto* pasqyron situatën e tregut në vitin 2013; shuma e shpërblimit nga shpronësimi, sipas kërkuesve, nuk mjafton të sigurojë as një apartament me sipërfaqe të vogël. Po kështu, nuk rezulton që gjykatat e faktit të kenë shqyrtuar nëse Ministria e Brendshme, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse, kishte bërë verifikimet nëpërmjet komisionit të posaçëm sipas kriterëve ligjore të nenit 17 të Ligjit për Shpronësimet, me qëllim vlerësimin përfundimtar të pronës. Për rrjedhojë, nuk konsiderohet e paarsyeshme që kërkuesit kishin pritshmëri për një vlerë më të lartë shpërblimi.

43. Në vijim, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë caktoi ekspert gjatë gjykimit, i cili konkludoi se vlera e tregut për m² për truallin ishte 24.000 lekë/m², ndërsa për ndërtesën ishte 56.000 lekë/m², vlera sipas të cilave shpërblimi i kërkuesve pothuajse trefishohej (*shih supra paragrafin 6*). Megjithatë, kjo provë nuk u vlerësua e besueshme nga gjykata e shkallës së parë, me fjalinë standarde që nuk përputhej me provat e tjera shkresore dhe se eksperti ishte teorik. Po kështu, gjykata e apelit nuk dha ndonjë arsye se përse konkluzioni i ekspertit nuk duhej marrë në konsideratë, edhe pse kërkuesit e kishin ngritur si shkak të veçantë në aktin e apelit. Për më tepër, ndonëse Ligji për Shpronësimet parashikon se vlerësimi paraprak i pronës llogaritet në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësim, ndërsa ministria përgjegjëse bën vlerësimin përfundimtar, i cili i propozohet Këshillit të Ministrave, gjykata e apelit u shpreh se shpërblimi përcaktohet në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësim, duke zhbërë një prej garancive ligjore të shpërblimit të drejtë, atë të përlllogaritjes së tij me



vlerën e pasurisë në kohën e shpronësimit. Në këtë mënyrë, gjykata e apelit dështoi t'u jepte kërkesve një përgjigje specifike për pretendimin kryesor të tyre, i cili ishte vendimtar për zgjidhjen e çështjes.

44. Megjithëse rekursi i kërkesve për mungesën e arsytimit nga gjykata e apelit për shpërblimin e drejtë nga shpronësimi kishte të bënte me një shkelje potenciale të të drejtave kushtetuese, të cilën gjykatat e zakonshme kanë detyrimin ta shqyrtojnë me kujdesin e duhur, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit pa i dhënë përgjigje të shprehur pretendimit për përlogaritjen e shpërblimit nga shpronësimi, i cili ishte edhe pretendimi vendimtar për zgjidhjen e çështjes. Në këtë pikë, Gjykata vëren se kërkesit kanë sjellë në vëmendje të saj edhe qëndrimin e ndryshëm që Gjykata e Lartë ka mbajtur në dy raste të ngjashme, në të cilat ajo ka pohuar se në funksion të realizimit efektiv të së drejtës kushtetuese për mbrojtjen e pronës, në rastet e kufizimit me ligj të saj, merr rëndësi identifikimi i vlerës së drejtë të shpërblimit, duke iu afruar, për sa është e mundur, vlerës së vërtetë të pasurisë së paluajtshme në kohën e shpronësimit, pa akorduar masë më të lartë dhe as një masë të ulët ose të papërfillshme (*shih vendimet nr. 00-2024-1495 (161), datë 16.4.2024 dhe nr. 00-2024-4901 (443), datë 29.10.2024, të Gjykatës së Lartë*). Në mbështetje të këtij qëndrimi, Gjykata rithekson se kur individ i shpronësohet nga pasuria private vetëm një shpërblim i drejtë garanton ekuilibrin midis interesit publik dhe shuarjes të së drejtës së pronës (*shih supra paragrafët 33–34*).

45. Për sa më lart, Gjykata çmon se kërkesve u janë cenuar të drejtat kushtetuese të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës i lidhur me nenin 41, pika 4, të saj nga vendimi i Gjykatës së Lartë.

46. Gjykata, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, rithekson rolin e pazëvendësueshëm të Gjykatës së Lartë, së cilës i përket detyra kushtetuese për të siguruar njësimin

dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ajo gjykatë nuk ka asnjë pengesë të zgjidhë vetë çështjen ose të orientojë zgjidhjen e saj nga gjykata më e ulët, duke njësuar e zhvilluar edhe praktikën gjyqësore në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato të GJEDNJ-së të trajtuara në këtë vendim.

47. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkesve janë të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4040, datë 22.10.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.12.2025.

Shpallur më 22.1.2026.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë

